39	12/04/17	-	-	-	Meeting in ARA (official letter n. 3482 of 26/04/2017)	<p>With the official letter No. 9342 dated 14.11.2016, the Client requested to the Consultant to share the implemented hydraulic analysis and suggested solutions before the Detailed Design's submission and get the Client's approval in advance.</p> <p>During the meeting, the Consultant described the improvement of the hydraulic investigation, starting from the review of hydrologic data, design discharge, hydrographs and a more accurate identification of the watercourses.</p> <p>A more detailed map of the catchments was presented, by distinguishing in minor and major basins according to the Albanian standards:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Major basins, larger than 2,5km²: designed for a discharge 100 years of return period. • Minor basins, smaller than 2,5km²: designed for a discharge 50 years of return period. <p>After accurate site investigations, a detailed list of the existing hydraulic structures was prepared and discussed in the meeting. There were identified the structures to be extended, where the analysis confirms that the dimensions are sufficient from a hydraulic point of view and finally there were presented the structures that resulted insufficient, to be removed and reconstructed with a higher hydraulic capacity.</p> <p>The Consultant underlined that the methodology took into account either the "not overtopping" of the motorway or other critical situations.</p> <p>The Consultant, according to the hydraulic calculations, identified the structures to be replaced, presented to the Client during the meeting.</p> <p>The methodology proposed by the Consultant in the resolution of these interferences was to avoid aggravation of existing flooding. The choice of new construction instead of widening of the existing structures is limited to hazardous situations in order to reduce the possible complicated technical solutions needed for the provisional structures, the construction timetable and the higher costs.</p> <p>For the side ditch, the Consultant refers that, according to the current standards, the design was performed for a return period of 50 years.</p> <p>There were presented to the Client also the detail design of the motorway</p>	-
----	----------	---	---	---	--	--	---

						draining system. In the last 10 km of the alignment, in Durres direction, interferred water bodies consist of a network of artificial channels, for whom no catchment basin can be identified. Structures in this area have been verified considering the higher discharge the incoming channels can convoy. All the calculations, analysis and detailed drawings of the drainage system will be included in the “Hydrologic and Hydraulic study”.	
40	17/07/17	5915	SPEA Engineering S.p.A	ARA	Submission of Draft Detailed Design Project		-
41	04/10/17				Technical Council Meeting of the Detailed Design		
42	11/10/2017	8082	ARA	Spea Engineering S.p.A	Technical Council’s Decision about the widening of Tirane-Durres motorway	The meeting was held into ARA’s Offices	

Table 1 – Procesi i projektit – Dorezimet dhe aprovimet

2 IDENTIFIKIMI I PROJEKTIT

2.1 Hyrje

Superstrada Tirane – Durrës (e njohur ne vend qe prej vitit 1996 si Autostrada Tirane - Durres) fillon nga Mbikalimi i Kamzës deri tek Ura e Dajlanit, është një nga arteriet kryesore dhe më të rëndësishme të vendit, e cila lidh dy qendrat me te mëdha administrative, industriale, kulturore dhe turistike të Shqipërisë, si dhe korridoret Veri Jug dhe atë Lindje-Perëndim. Gjithashtu, një pjesë e kësaj rruge, segmenti Vorë - Durrës, është arteria kryesore e korridorit Durrës-Kukës-Morinë, i cili në rrjetin Evropian të rrugëve emërohet E851. Korridori Veri Jug lidhet me Autostradën në qytetin e Vorës nëpërmjet Segmentit E762.




Figure 3 – Harta e rajonit 1

Ndërsa Korridori Lindje-Perëndim fillon në Qafë-Thanë dhe vazhdon më pas në qytetet Librazhd, Elbasan, Tiranë (E852) dhe përfundon në qytetin e Durrësit, si me poshte:




Figure 4 – Harta e rajonit 2




Figure 5 – Rruga kryesore ekzistuese Tirane-Durres

2.2 Mbledhja e Dokumentacionit

- Konsulenti ka mbledhur dokumentacionin sipas listes se meposhtme, e cila lidhet me projektet ekzistuese, planifikimin e pergjithshem dhe standartet e projektimit:
- Strategjia Kombetare per Zhvillim dhe Integrim,
- Strategjia e Sektorit te Transportit, e miratuar nga Keshilli i Ministrave me vendimin Nr.1214 me 03.09.2009,
- Plani Kombetar i Transportit per Shqiperine, i hartuar nga Qeveria Shqiptare,
- Standartet Shqiptare per projektimin dhe implementimin e rrugeve,
- Standardet nderkombetare gjeresisht te perdorura ne Europe e ne Shqiperi si AASHTO, CNR, EN,DMRB,UROCODES etj.
- Studimi per permiresimin e sherbimit urban ne Tirane (teknike/trans – urbane) 2002,
- Planifikimi Urban i Tiranës 2009 (i rishikuar ne vitin 2012 dhe projekte te tjera vijuese),
- Studime te ndryshme te kryera me pare ne kete zone (me fokus te vecante ne studimin e Bypass-it te Tiranës),

Konsulenti, ne bashkepunim te ngushte me Klientin, identifikoi edhe dokumentacion tjetër shtese te vlefshem qe lidhet me kete projekt, me qellim qe te behet nje vleresim i shendoshe i zhvillimeve ne rrjetin e transportit, sikurse te identifikohen edhe pengesat e mundshme.

2.2.1 Lista e materialeve, referencave, projekteve dhe te dhenave te mbledhura te marra ne konsiderate

- Manuali shqiptar i projektimit te rrugeve (ARDM) 30/07/ 2015;
- Standartet shqiptare te Projektimit dhe Ndertimit te Rrugeve (ARDACS);

- Specifikimet shqiptare te ndertimit te rrugeve (ARCS)
- Plani Kombetar i Transportit ne Shqiperi (Pjesa I, II, III) – Qershor 2010
- Projektet kryesore te infrastruktures ne Republiken e Shqiperise, te bazuara ne programin e Qeverise 2013 – 2017
- Studimi per Konkensionin e autostrades “Fushe Kruje – Ura e Gjoles – Tirane – Rrogozhine Konjat” – 2010
- Studimi i Fizibilitetit dhe projekti paraprak per ByPass-in e Tiranes – Dhjetor 2013
- Projekti i autostrades Milot – Fushe Kruje
- Studimi per rehabilitimin e shtresave asfaltike te autostrades Tirana-Durres _2008
- Vizatimet As built te Kryqezimit te ri te Vores
- Projekti i autostrades Vore-Fushe Kruje
- Rehabilitimi i segmentit te autostrades nga kryqezimi i Kamzes ne kryqezimin e Kashar
- Harta Vektoriale e Zones se Projektit
- Fotografimet Ajrore te zones
- Dokumentacion tjetër korrespondues

2.2.2 Te dhena nga Ministria e Transportit dhe Infrastruktures

<ol style="list-style-type: none"> 1. Investime ne infrastrukturen e Transportit 2. Investimet ne sektor 3. Investimet ne infrastrukturen Rrugore 4. Inventari i Rrugeve 5. Inventari i mjeteve 6. Inventari i mjeteve (ndare ne grupe) 7. Niveli i Motorizimit 8. Kontrolli Teknik i automjeteve 	<ol style="list-style-type: none"> 9. Statistikat e Aksidenteve Rrugore (5 vitet e fundit, si dhe detajime per vitin 2014) 10. Harta e Njollave te Zeza ne Rrjetin Rrugor Kombetar 11. Transporti i Pasagjereve ne pikat kufitare (5 vitet e fundit) 12. Rrjeti Hekurudhor (inventaret, volumet e punes se Transportit) 13. Rrjeti Hekurudhor (transporti kombetar dhe nderkombetar i mallrave) 14. Transporti Detar i automjeteve dhe kamionave (5 vitet e fundit) 15. Transporti Detar i Pasagjereve (5 vitet e fundit) 16. Transporti Detar i Pasagjereve per secilin Port (5 vitet e fundit) 17. Informacione mbi ngarkimin dhe shkarkimin e Konteniereve ne Porte (5 vitet e fundit).
---	---

2.2.3 Te dhena te tjera mikro/makro ekonomike (Burimi: Banka Boterore dhe INSTAT)

1. Norma e rritjes se PBB-se (Burimi: BB)
2. Struktura e rezultatit te PBB-se (Burimi: BB)
3. Statistika Demografike (Burimi: INSTAT)
4. Transporti Urban i Pasagjereve ne vite (Burimi: INSTAT)
5. Te dhenat mbi aktivitetin e Transportit Ajror (Burimi: INSTAT)
6. Buletini Statistikor i INSTAT – Tremujori i 4 i vitit 2014

2.2.4 Te dhenat mbi kostot e transportit rrugor:

1. Kostot operative te automjeteve
2. Cmimet e makinave te reja
3. Cmimet e Naftes dhe Benzines
4. Kostot e Materialeve dhe Pajisjeve
5. Te dhenat ekzistuese mbi AADT (trafiku mesatar ditor me baze vjetore)
6. Paga mesatare ne Shqiperi
7. Kostot e Aksidenteve Rrugore.

2.3 Vizita e detajuar ne terren

Ne 17 Shtator 2015, Konsulenti bashke me partnerin e tij lokal kryen viziten e pare te detajuar pergjate autostrades Tirane-Durres.

Konsulenti perdori fotokamera me GPS, te cilat mundesojne sigurimin e fotove dhe videove te gjeoreferuara. Pikat e kuqe ne figuren vijuese tregojne pozicionimin e fotove ne pika sinjifikative, te transferuara ne Google Earth.



Figure 6 – Harta e Vizites ne terren






Figure 7 – Imazhe te videove me gjeoreferimin perkates

2.4 Gjendja Ekzistuese

Punimet per ndertimin e Superstrades Tirane-Durres jane zhvilluar ne faza te ndryshme kohore, si dhe ne segmente pjesore te saj.

2.4.1 Seksioni Mbikalimi i Kamzës - Kryqëzimi i Ksharit

Punimet për ndërtimin e këtij segmenti rrugor (Kthesa e Kamzës-Qafë Kshar) filluan rreth viteve 1994-1995, me financim të buxhetit të shtetit. Punimet e ndërtimit u kryen nga Kompania "Euroteorema". Bazuar në termat e referencës ky segment u projektua sipas standardit Italian C.N.R. tipi 3, me seksion tërthor 2 x (2 x 3.5) m, me hapësirë qendrore me trafik - ndarës betoni (Tipi "New Jersey") me gjerësi 1.1 m dhe dy bankina te asfaltuara, pra gjithsej me një gjerësi te kurorës 18.6m.




Figure 8 – Seksioni Terthor ekzistues ne mbikalimin e Kamzes

Tre nga korsitë e këtij segmenti janë ndërtuar mbi bazamente të reja, ndërsa korsa e krahut të djathtë (drejtimi Tiranë-Durrës) është ndërtuar mbi gjurmën e rrugës se vjetër nacionale me 2 kalime Tiranë- Durrës.

Më pas ky segment rrugor është shoqëruar me rrugë paralele nga të dy anët deri në qytetin e Vorës, një ndërtim qe ka filluar ne vitet 2002 – 2003 dhe ka përfunduar ne vitin 2011. Gjithashtu më pas është ndërtuar Mbikalimi i Kamzës (viti 2008) dhe Kryqëzimi i Ksharit (viti 2004-2005) së bashku me rrugën e re Kryqëzim i Ksharit - Aeroporti Rinas. Përfundimisht, nderhyrja me e fundit ishte ndertimi i Mbikalimit te ri ne Vore ne 2012- 2013

Pavarësisht nga rehabilitimi i përgjithshëm i shtresave asfaltike te kryer ne vitin 2011, së fundmi (viti 2015) ky segment rrugor i është nënshtruar disa ndërhyrjeve për rehabilitimin e shtresës së sipërme asfaltike (asfalto-beton), asfaltimin

e bankinave anësore, me seksion tërthore 2 x (2 x 3.5) m, me hapësire qendrore me trafik - ndarës betoni me gjerësi 2.2 m dhe dy bankina nga 1.00 m te asfaltuara. Pra gjithsej me një gjerësi te kurorës 18.2m. Ai i eshte nenshtuar rehabilitimitte plotë të sistemit të ndriçimit, sistemimin e kanaleve drenazhuese (zhvendosjen e tyre në skajet anësore të Autostradës, në kufi me rrugët dytësore), ndryshimin e trafik-ndarësit ekzistues betoni (Tipi "New Jersey") në trafik-ndarës betoni me lartësi 60 cm, mbjelljen e pemëve (tip palma) anës Autostradës në të dy krahët, zëvendësimin e të gjitha mbikalimeve për këmbësorë me mbikalime të reja, si dhe vendosjen e sinjalistikës së re horizontale dhe vertikale. Për shkak të zhvendosjes së kanaleve anësore drenazhuese është kërkuar dhe zgjatim i tobinove (rrethore dhe katrore), zgjatim i cili, nga të dhënat e deritanishme, nga pikëpamja konstruktive janë llogaritur vetëm për përbalimin e ngarkesave të dherave mbi të dhe jo duke parashikuar ngarkesat e automjeteve.

Fillimi i këtij Segmenti përkon me fillimin e Projektit të Autostradës në km. 0+000, fillim i cili sipas termave të referencës ndodhet rreth 800 m nga mesi i Mbikalimit të Kamzës. Seksion tërthor i këtij segmenti 2 x (2 x 3.5) m, me hapësire qendrore me trafik - ndarës betoni me gjerësi 2.2 m dhe dy bankina nga 1.00 m te asfaltuara, pra gjithsej me një gjerësi te kurorës 18.2m. Shtresat asfaltike të sipërme, të rehabilituara së fundmi paraqiten në gjendje të mirë, pa deformime apo dëmtime të tjera të dukshme. Në këtë segment, kanalet anësor grumbullojnë ujërat e Autostradës, rrugëve dytësore paralele me të, si dhe ujërat e ardhura nga aktivitetet e Kompanive private.



Figure 9 – Pika e Fillimit te Projektit (km 0+000)




Figure 10 – Seksioni Tip Ekzistues i Autostradës me rrugët dytësore (Km. 0+000 - Km. 5+855)

Dimensionet e rruges ekzistuese duhen konsideruar si “te ndryshueshme” përgjatë gjurmës

Foto të gjendjes ekzistuese gjatë një vizite inspektimi:

Foto (Km 0+000 – km 5+855)



Gjendja e Përgjithshme:

- Rrugët dytësore janë prezente përgjatë të gjithë Autostradës në të dy anët e saj. Në segmentin nga km. 1+900 deri në km. 2+350, ana e majtë e Autostradës (drejtimi Tiranë-Durrës), rruga dytësore devijon duke kaluar në krahun e majtë të lumit Lanë, ndërsa Autostrada kalon në krahun e djathtë të tij. Në këtë segment, rruga dytësore është e papërfunduar, pa shtresa asfaltike. Në zonën midis Autostradës dhe lumit Lanë ushtrojnë aktivitetin e tyre tregtare disa kompani, hyrjet-daljet e të cilave lidhen direkt me Autostradën.
- Rrugët dytësore janë me dy kalime me seksion tërthorë 2x3m të asfaltuar, me trotuar (me gjerësi variabël) në njërin dhe me bankine të pa-asfaltuar (rreth 75cm) në krahun tjetër. Bazamenti i rrugëve është i padeformuar dhe duket në gjendje të mirë, ndërsa shtresa e sipërme asfaltike vende vende është e dëmtuar dhe kërkon mirëmbajtje.

Foto të rrugëve dytësore (Km 0+000 – Km 5+855):



Pergjate aksit Tirane-Durres, gjenden mbikalime metalike per kembesore. Ne 5 km e para, ato jane te reja dhe kane zevendesuar mbikalimet e vjetra, te cilat jane hequr. Hapësira e dritës midis këmbëve të mbikalimit është rreth 34.00m.



2.4.2 Lumi i Lanes - Km 2+259.73

- Ne km 2+259,73 Superstrada intersektohet nga Lumi i Lanes, duke kaluar permes 3 tombinove rrethore te brinjezuar. Rruget sekondare ekzistuese pershkrojne lumin e Lanes permes urave te perforcuara te betonit.



Strukturat (prej celiku dhe betoni te perforcuar) mbi lumin e Lanes prezantohen pergjithesisht ne nje gjendje te mire strukturore. Megjithese, mbetjet urbane te sjella nga lumi i Lanes here pas here dhe mungesa e nje mirembajtjeje te pershtatshme pothuajse bllokoi dy prej tre tombinove dhe ngushtoi hapësiren e rrjedhjes se lire te ujerave poshte urave ne rruget sekondare.

Gjithashtu, poshte ketyre urave ndodhen nje numer i konsiderueshem i rrjeteve inxhinierike te paleve te treta (tuba dhe kablllo) te cilat jane totalisht te ekspozuara dhe pa asnje mbrojtje ne pothuajse cdo pjese tombinoje te ketij seksioni rrugor ku eshte mjaft e dukshme mungesa e mirembajtjes.

3 STUDIMI TOPOGRAFIK

3.1 Prezantim

Punimet gjeodezike dhe topografike per projektimin e autostrades Tirane-Durres u kryen mbi bazen e kerkesave teknike te pergjitheshme dhe ato specifike te parashikuara nga Autoriteti Kontraktor.

Punimet topografike u kryen nga GEO-NORD Sh.p.k dhe Geosat Group Ltd.

GEO-NORD Sh.p.k beri matjet topografike te fazes se pare ne Shtator, Tetor 2015. Ne Janar 2016, beri vzhgimet topografike per rruget sekondare dhe ne bashkepunim me inxhinierin e strukturave, vazhduan meurvejimin e detajuar te te gjitha strukturave kryesore, me qellim qe te vazhdohej me projektin e detajuar te strukturave

Ndersa Geosat Group Ltd kreuurvejime shtese ne fazen e dyte te projektit ne Shtator 2016 qe perfshininurvejimet topografike te nevojshme per rruget sekondare dhe kryqezimet e projektit.

Ne Mars 2017, Konsulenti beri vzhgimin e fundit te detajuar topografik te te gjitha strukturave hidraulike. Rezultatet e ketij vzhgimi gjenden ne raportin hidrologjik-hidraulik te ketij projekti.

Perpara se te fillohej me punimet topografike, u siguruan te gjitha materialet hartografike, pajisjet dhe pajisjet gjeodezike te nevojshme.

Zona ne studim perfaqeson nje nga arteriet rrugore me kryesore ne vend, pasi mbledh volume te larta te trafikut.

3.2 Rrjeti i Vezhgimeve Topografike (Benchmarks)

3.2.1 Stacionet Poligonale

Proçesi topografik i ndermarre nga Konsulenti konsiston ne krijimin e nje harte dixhitale te gjithe gjatesise se segmentit rrugor, qe do te perdoret per qellime projektimi. Keto stacione (te vendosura pergjate te gjithe gjurmes) do te perdoren gjithashtu si reference gjate implementimit te punimeve te ndertimit.

Vezhgimi u realizua duke perdorur sistemin nderkombetar UTM, me elipsoid wgs84. Permes ketij sistemi, koordinatat gjeodezike mund te identifikohen lehtesisht per cdo pike interesi ne sipërfaqen e tokes bazuar ne te dhenat GPS.

Stacionet jane vendosur ne afersi te aksit rrugor te materializuar ne fushe prej celiku dhe betoni. Punet topografike konsistojne ne hapat e meposhtem:

- Ndertimi i mbi 85 stacioneve.
- Matja me GPS ne te gjithe stacionet.
- Rilevimi i detajuar gjate gjithe gjatesise se projektit (per nje gjeresi 100 m).
- Krijimi i hartes dixhitale.

3.2.2 Ndertimi i stacioneve

Stacionet jane ndertuar ne intervale rreth 300-500m njeri nga tjetri. Me vone ato u ndertuan duke perdorur shufra hekuri me gjatesi 70cm te vendosura ne spote me permasa 40x40cm, thellesi 60cm, dhe jane vendosur mbi ura, mure, tombino, etj. Ndertimi i tyre u be ne vende qe sigurojne jetegjatesi, me qellim qe te sherbejne per ndertimin e rruges se re.

Te gjitha stacionet jane shenuar me ngjyre te kuqe, per te qene qartesisht te shikueshem. Per cdo pike, eshte vizatuar vendndodhja precize, duke e identifikuar ate ne lidhje me objektet fikse dhe lidhur me dosjet dixhitale, te cilat perfaqesojne monografin e pikave polygonale.

3.2.3 Matja e stacioneve me GPS

Realizimi i matjeve me GPS eshte kryer per te gjitha stacionet, duke perdorur "GPS Dual Frequnce receivers". Per te arritur nje precizion te larte dhe matje sa me te sakta, eshte perdorur metoda e matjeve te mini-triangolacioneve. Ne matjen e stacioneve me GPS eshte perdorur menyra e matjeve "Faststatic". Matja e cdo pike me GPS eshte realizuar per 20-30min, duke marre parasysh numrin e sateliteve ne kohen e matjeve. Instrumentat e perdorur kane qene TRIMBLE R6 MODEL 3 GPS. Mbas matjeve eshte kryer perpunimi i te dhenave me programin Trimble Business Center. Rezultati i ketyre matjeve eshte i bashkangjitur raportit perkates topografik. Ky instrument perfaqeson disa nga teknologjite me te mira ne treg..

"TRIMBLE R6 MODEL 3"



TOPCON GPT 900 A



"TRIMBLE R6"



Nivela Digitale Leica DNA 03

Figure 11 – Teknologjia e perdorur per observimin GPS

3.3 Krijimi i hartes dixhitale

Te gjitha elementet dhe karakteristikat topografike jane regjistruar me kode te vecanta ne memorien e brendshme te instrumentave te perdorur nga Konsulenti.

Tek keto elemente perfshihen, por jo vetem, karexhata e rruges, bankina, mbushja e trupit te rruges, germimet, veprat e artit (urat, tombinot etj.), kanalet anesore, rrjedhat e ujit, punimet mbrojtese te skarpatave, kanalet ujites, strukturat ujites, punimet mbrojtese ndaj permbytjeve, mure mbajtes dhe akustike, guardrailet, linja elektrike, linja telefonike, ndertesa, hekurudha, peme, ujesjelles, kryqezime rruges etj.

Mbas punes ne terren eshte bere perpunimi i te dhenave te matura ne terren me anen e programit Sierrasoft Prost. Pikat e rlevuara jane hedhur ne AutoCAD ku eshte bere dhe lidhja e elementeve (bazuar tek kodet) e te gjitha zones duke krijuar nje vizatim unik.

Vizatimi eshte bere ne 3 dimensione, ne menyre qe mund te krijojme modelin e terrenit ne menyre dixhitale. Jane paraqitur te gjitha detajet e relievit si rruge, ura, tombino, perrenj, lumenj, mure, ndertesa, rrethime, linja elektrike, etj. ne layera te vecanta. Te gjitha stacionet jane paraqitur me shenje konvencionale ne vizatim.

Modeli dixhital i terrenit eshte paraqitur ne file dwg si me poshte

- Tre - dimensional (x,y,z), pika gjeodezike ne nje layer te vetem
- Tre - dimensional (x,y,z) linjat e nderprerjes se terrenit, si dhe elemente te tjere topografike te terrenit ne layera te ndryshem.

4 STUDIMI GJEOLOGJIK E GJEOTEKNIK

4.1 Qëllimi i Studimit

Për të vlerësuar kushtet gjeologjike, kushtet hidrogjeologjike dhe për të identifikuar fenomenet që lidhen me kushtet e projektimit të zonës ku aksi rrugor ekzistues do të zgjerohet, duke siguruar të dhëna dhe rekomandime për të ndihmuar dhe mbështetur sa më shumë në përzgjedhjen e masave inxhinierike gjatë projektimit.

Gjatë muajve Shtator dhe Tetor 2015 u krye studim i Gjeologu Inxhinierik me objekt “Studimi & Projektimi i zgjerimit të Superstradës Tiranë-Durrës”. Për këtë qëllim u përcaktuan llojet e punimeve që do të kryhen në terren, përpilimi i raportit Gjeologu-Inxhinierik si dhe afati i dorëzimit.

Hapat e studimit për raportin Gjeologu-Inxhinierik përqëndrohen në territorin që zë objekti dhe janë si më poshtë vijon:

- Studimi i materialeve arshivale dhe të literaturës së botuar
- Rilevimi kompleks gjeologu-inxhinierik
- Punimet zbuluese gjeologu-minerare
- Punimet eksperimentale
- Punimet laboratorike

Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i karakteristikave fizike dhe mekanike të dherave dhe shkëmbinjve që janë pjesë e korridorit ku lokalizohet rehabilitimi i rrugës ekzistuese Tirana-Durrës. Të dhënat ekzistuese janë adaptuar me të dhënat e reja të përfuara nga studimi i detajuar, të cilat përfshijnë të dhënat mbi rrugën ekzistuese, kushtet gjeologjike të zonave ku janë lokalizuar urat ekzistuese dhe mundësia për zgjerim, zonat e rreshqitjes dhe zonat problematike në lidhje me stabilitetin e rrugës, thellesia e ujerave tokësore, kryqezimi me zonat detare etj.

4.2 Përshkrimi i Studimit

Për arritjen e rezultatit të investigimeve, u ekzaminuan burimet e mëposhtme të informacionit:

- Përshkrimi vizual i gjendjes së aksit ekzistues
- Vlerësimi i sjelljes deformuese (defleksionit) të paketës rrugore ekzistuese nëpërmjet proves me Traun Benkelman.
- Punime zbuluese (gropa-Trial pit) për të vlerësuar trashësinë e shtresave të strukturës rrugore ekzistuese, materialet e ndërtimit, tipin litologjik të bazamentit natyral.
- Prova laboratorike për materialet e shtresave rrugore dhe bazamentin natyral mbikampionet e përfuara nga punimet zbuluese (granulometri, plasticitet, Proktor, CBR).
- Punime zbuluese (Sonda) në shpatullat e strukturave ekzistuese, marrje kampionesh me strukturë të prishur dhe monolite për analiza laboratorike të vetive fiziko-mekanike të shtresave të vecuara, prova SPT (Standart Penetration Test).
- Gjykimi i vecorive dhe kushteve sipërfaqësore dhe nëntokësore të terrenit.
- Prova laboratorike mbi kampionet me strukturë të pa prishur (monolite) për vlerësimin e vetive mekanike të sjelljes nën ngarkesë (Edometer, Preje Plane-Shear test).
- Prodhimi i një raporti mbi investigimin dhe testimet Gjeoteknike dhe Gjeologjike.
- VS: Shpejtesia e vales sizmike

4.3 Historiku Gjeologjik i Makrozonës, Gjeomorfologjia & Gjeodinamika

Në këtë kapitull, është përshkruar zona në të cilën përfshihet vendndodhja e rrugës ekzistuese Tiranë -Durrës, krijimi, forma e hershme dhe e vonë, kushtet gjeologjike të formimit të saj. Gjithashtu paraqiten dhe fenomene gjeodinamike dhe gjeologjike të kësaj zone.

4.3.1 Proceset gjeologjike dhe gjeodinamike

Për trajtimin e fenomeneve apo dukurive gjeologjike dhe gjeodinamike kemi bazuar në studime të mëparshme si dhe në punimet e kryera në këtë fazë studimi. Në gjithë vijën lineare të superstrades do të veçojmë si fenomen ose proces kryesor atë të konsolidimit të depozitimeve aluvialo-lagunore dhe fenomenin e lëngëzimit të rërave detare.




Figure 12 – Harta Gjeologjike-gjeoteknike e zones se projektit

4.3.2 Konsolidimi i depozitimeve aluvialo-lagunore

Këto depozitime përfaqësohen nga argjila, suargjila, rëra dhe pjesërisht zhavore. Shkalla e konsolidimit të tyre është e ndryshme dhe varet nga mënyra e depozitimit, përzierja e depozitimeve detare-lagunore me ato tëprurjeve lumore, nga prania e lëndëve organike, nga granulometria e tyre, nga gjendja plastike dhe sasia e lagështirës etj. Në zonën e studuar bazuar në materialin faktik të shpimeve rezulton se konsolidimi i depozitimeve është i ndryshëm në shtresa të ndryshme apo në thellësi të ndryshme. Keto ndryshime do të jepen në pjesën e vlerësimit gjeologo-inxhinierik të këtij raporti. Mund të themi se në zonën e studiuar ka depozitime me shkallë konsolidimi të ulët dhe në këto raste do të japim rekomandime për mos vendosjen e themeleve të urave në këto shtresa.

4.3.3 Konsolidimi i depozitimeve aluvialo-lagunore

Këto depozitime përfaqësohen nga argjila, suargjila, rëra dhe pjesërisht zhavore. Shkalla e konsolidimit të tyre është e ndryshme dhe varet nga mënyra e depozitimit, përzierja e depozitimeve detare-lagunore me ato tëprurjeve lumore, nga prania e lëndëve organike, nga granulometria e tyre, nga gjendja plastike dhe sasia e lagështirës etj. Në zonën e studuar bazuar në materialin faktik të shpimeve rezulton se konsolidimi i depozitimeve është i ndryshëm në shtresa të ndryshme apo në thellësi të ndryshme. Keto ndryshime do të jepen në pjesën e vlerësimit gjeologo-inxhinierik të këtij

raporti. Mund të themi se në zonën e studiuar ka depozitime me shkallë konsolidimi të ulët dhe në këto raste do të japim rekomandime për mos vendosjen e themeleve të urave në këto shtresa.

4.3.4 Historiku Gjeomorfologjisë së Makrozonës

Ultësira perëndimore përfshin terrenet e Ultësires paramalore e cila ka pasur një tendence zhytje të përgjithshme gjatë etapës neotektonike dhe vetëm në mbarim të kësaj etape dhe fillimit të kuaternarit, ajo del nga uji e i nënshtrohet ngritjes. Ultësira sot ka tendence ngritje dhe këtë e dëshmon zhvendosja e vijës bregdetare për nga Perëndimi, por në të ka dhe sektore të veçantë me tendence zhytje. Mbas tektogjenezes si rezultat i zhytjes së pjesës Adriatike nën Orogjenin ndërmjet tërhoreve Shkodër-Pejë e Vlorë-Tepelenë u formua Ultësira Paramalore (nga Tortoniani). Në këtë Ultësirë deti vërshoi nga Veri-Veriperëndimi në Lindje-Juglindje duke vendosur mbi pjesën Jonike dhe sektorët verior të Zonës Kruja. Në sektorët perëndimorë të ultësirës pellgu është mjaft i thellë dhe në të u depozituan sediment argjilore me trashësi rreth 3000m me foraminifere planktonik. Në sektorët lindorë në drejtim të bregut sedimentet terrigjene janë depozituar në zona të cekta pranëbregdetare dhe kanë material trashaman me foraminifere bentosik. Ardhjet e materialit kanëqënë kryesisht nga Lindja. Lidhja e pellgjeve të ultësirës paramalore është kryer kryesisht nëpërmjet vërshimit të detit. Gjatë Mesinianit në Ultësirën Paramalore deti tërhiqet dhe vërehet rritja e kripshmërisë nga Lindja në drejtim të Perëndimit dhe në një det të mbyllur të të gjithë trevës mesdhetare u krijuan kushtet për formimin e evaporiteve. Në Pliocenin e poshtëm vërehet përsëri një fazë rudhosje që formon strukturat e Ultësirës Paramalore dhe që ndjehet në zonat e brendshme. Si të gjithë trevat mesdhetare dhe Ultësira Paramalore në Pliocen të Poshtëm pëson zhytje dhe deti shtrihet drejt Lindjes. Sedimentet në sektorët lindor janë pranëbregdetar, kryesisht konglomerato-ranorë dhe drejt perëndimit pelagjike me material alevrolitik e argjilor dhe foraminifere planktonik. Në fund të Pliocenit në Ultësirën Paramalore mbizotërojnë seri regresive që karakterizohen me pakësimin e foraminifereve planktonikë dhe mbizotërimin e gjinisë Ammonia. Pellgu detar Adriatiko-Jonik u krijua në Pliocen-Kuaternar si pasojë e zhytjeve që ndodhen në këtë pjesë kur pjesa tjetër më në lindje u kthye në kontinent.

Depozitimet Kuaternare kanë përhapje relativisht të madhe në vendin tonë, ato mbulojnë pjesërisht si zonat tektonike të brendshme, ashtu dhe ato të jashtme. Kryesisht mbulojnë pjesën e ulët bregdetare. Stratigrafia e pjesës Kuaternare në Shqipëri është akoma jo e studiuar mirë. Depozitimet kuaternare janë ndarë vetëm nga pikepamja morfogjenike duke dalluar vec depozitimeve pliocenike kuaternare dhe depozitimet aluviale, proluviale, kolumviale, deluviale akullnajore, kënetore, liqenore dhe detare. Në disa raste janë të ndërthurura me njëra tjetrën dhe formojnë tipe gjenetike të përziera si aluviale-proluviale, liqenore-proluviale, detaro-kënetore (lagunore), aluviale-kënetore, etj.

Përshkrimi i këtyre depozitimeve jepet si me poshte vijon:

- a) Depozitimet të pliocenit të sipërm-kuaternarit të vjetër (N2-Q1).
- b) Depozitimet e kuaternarit të poshtëm të mesëm dhe të sipërm të pandara (Q1-3)

4.4 Mikrozona - Aksi rrugor Tiranë - Durrës

Kushtet gjeologjike dhe hidro-gjeologjike te mikro zones.

Rajoni Tiranë-Durrës ku kalon edhe superstrada ka ndërtim gjeologjik të thjeshtë pasi përfaqësohet nga depozitime relativisht të reja gjeologjike, ato të Neogjenit (N) dhe të Kuaternarit (Q).

4.4.1 Erozioni

Fenomeni i erozionit është i dukshëm në zonën kodrave përreth aksit rrugor. Në periudhat e reshjeve me dendësi të lartë, ujërat sipërfaqësore në sasi të konsiderueshme nëpërmjet veprimtarisë së tyre eroduese dëmtojnë jo vetëm gjeografinë e zonës, por bëjnë transportim të materialit të gërryer duke e depozituar atë në nivele me të ulëta, deri pranë aksit të rrugës ekzistuese, në disa raste dhe shkaktuar mos funksionim të rregullt të strukturave. Dukuria e Erozionit është më intensive në formacionet shkëmbore të buta të tilla si flishi argjiloro-alevrolitik dhe në një masë më të vogël në ranore.

Rekomandime

Për arsyet e përmendura me sipër, rekomandojmë shmangien e depozitimit të sasive të ujërave sipërfaqësore ose të reshjeve së bashku me materialin shoqërues në të dyja anët e rrugës me anë të kanaleve të hapura me prerje tërthore

me përmasa $\geq 2 \text{ m}^2$, të cilat do të kryejnë zhvendosjen e sasisë së ujit në struktura të tjera hidraulike. Per te shmangur depozitimin e materialeve te ngurta te krijuara nga erozioni i ujerave siperfaqesore, duhet llogaritur perqindja e pjerresise se projektit per ndertimin e knalit te hapur.

Kanali sugjerohet i veshur me beton.

4.4.2 Rreziku Sizmik

Vleresimi i sizmicitetit është kryer në bazë të dokumentacionit zyrtar, që përfaqësohet nga dy dokumente:

Harta e Zonimit Sizmik të Republikës së Shqipërisë hartuar nga Instituti i Sizmologjisë-Tiranë

Normat Sizmike të Projektimit KPT-No2-89 botuar në 1989 nga Instituti i Sizmologjisë-Tiranë dhe Ministria e Ndërtimit.

Referuar hartës së zonimit sizmik, e cila sipas klasifikimit MKS ndan territorin në tre (3) zona, aksi në studim bën pjesë në zonën Joniko-Adriatike me Intensitet maksimal sizmik 8 balle.

Në Normat Sizmike të projektimit KPT-No2-89 përcaktohen tre (3) kategori trojesh lidhur me ndikimin që kushtet lokale të truallit kanë në aktivitetin sizmik:

Kategoria I Të gjitha llojet e shkëmbinjve (përfshirë shkëmbinj të përajruar)

Zhavorr i ngjeshur

Argjilite (jo të përajruara)

Kategoria II Shkëmbinj të përajruar dhe argjilite

Zhavorre me rërë, rëra kokërr trasha-kokërr mesme të ngjeshura dhe gjysëm të ngjeshura

Rëra kokërr imta të ngjeshura

Argjila me rërë dhe rëra argjilore të ngjeshura, gjysëm të ngjeshura dhe plastike të ngjeshura

Argjila plastike të ngjeshura

Kategoria III Rëra kokërr imta të ngjeshura

Rëra pluhurore të ngjeshura deri gjysëm të ngjeshura

Rëra argjilore deri argjila rërore nga mesatarisht të ngjeshura deri në plastike të buta

Argjila nga mesatarisht të ngjeshura në plastike të buta




Figure 13 – Harta e Zonave Sizmike të Republikës së Shqipërisë

Sipas kesaj Norme, referuar tipologjisë së dherave që rezultojne nga ky studim, aksi rrugor Tiranë-Durrës përfshihet në kategorine III.

Përsa i takon llogaritjeve në qëndrueshmeri të strukturave, bazuar në studimet e Institutit të Sizmologjisë, rekomandohet një vlere maksimale në projektim e akseleracionit të dheut $a=0.2g$.

4.5 Investigimet

4.5.1 Vleresimi bazuar ne vzhgimet vizuale

Ne fillim të ketij kapitulli shohim të nevojshme të bejme një historik të shkurtër të objektit që nga fillimi i ndërtimit deri sot. Ndërtimi i ketij segmenti daton në vitin 1995 me investime të Buxhetit të Shtetit në pjesën nga kthesa e Kamzes-Kashar me gjatësi 5.5 Km dhe me vone po nga Buxheti i Shtetit pjesa tjetër deri në Vorë. Të dy segmentet janë ndërtuar nga kompania EUROTEOREMA. Tre karexhatat e superstrades nga kthesa e Kamzes-Useku Kasharit janë në bazamente të reja, ndërsa karexhata anesore e krahut të djathtë (drejtimi Durrës-Tiranë), është ndërtuar mbi gjurmen ekzistuese. Me tej deri në Vorë segmenti rrugor shtrihet në një gjurme të re. Segmenti i dytështë ai Vorë-Sukth, i ndërtuar në gjurme të re nga ITALSTRADA. Segmenti i tretë Sukth-Ura e Dajlanit, është ndërtuar në gjurme të re nga firma ndërtuese RUSKALA, punimet e së ciles kanë përfunduar në vitin 2002.

Që në momentet e para të venies në shfrytëzim u shfaqen shenja të deformimeve sidomos në korsine e ndërtuar mbi shtresën ekzistuese të skarifikuar tërrugës ekzistuese. Me kalimin e viteve degradimet filluan të shfaqen progresivisht. Në vitin 2008 kemi studimin e pare të kryer për vleresimin e gjendjes së degraduar të trasesë rrugore si dhe propozimet përpërmiresimin e gjendjes së superstrades Tiranë-Durrës (“Studim-Projektim përpërmiresimin e shtresës së superstrades Tiranë-Durrës dhe sistemimin e kanaleve anesore”) me autor ing. Sokol Agaraj dhe ing. Besnik Halilaj. Autoret bazuar në vleresimin vizual të defekteve, analizes së materialeve të shtresave rrugore, bazamentit natyral, trafikut etj, arrijne në konkluzionin se integriteti strukturor i shtresave tërrugës ka denigruar si pasoje e ngarkesave të përsëritura dhe ka nevojë të forcohet. Përsa sipër ata propozojne tre alternativa:

- Rikonstrukcion i plotë i strukturës së shtresave
- Riveshje e sipërfaqes sërrugës
- Riciklim në vend.

Shtresat e asfaltit rezultojne të “lodhura”. Aplikimi i një veshje me asfalt nuk do të ripërtërinte integritetin strukturor, në qoftë se nuk do të kryhej një rikonstrukcion i thelle i strukturës. Në qoftë se bejme vetëm një riveshje, do të kemi vetëm një reflektim besnik të të gjitha të carave në ketështresëtë re pas pak kohe.

Ne vitin 2011, DPRR realizoi alternativën e riveshjes së superstrades me dy shtresa asfalti (tapet, binder) në të gjithë gjatësinë e saj. Pas një periudhe rreth 4 vjecare, sikundër do analizojme me poshtë, rruga ekzistuese ka filluar të shfaqë tënjëjtën tipologji defektesh.

4.5.2 Gropat

Gropat janë një element i rëndësishëm për realizimin e qëllimit të studimit. Ato japin të dhena lidhur me natyrën e shtresave rrugore, trashesinë e tyre si dhe krijojne mundesine e përfutimit të materialeve për kryerjen e provave laboratorike. Më poshtë jepen progresivet e kryerjes së gropave, pozicioni i tyre në planimetri, fotografi si dhe seksionet skematike të shtresave të strukturës rrugore. Kolonat stratigrafike të ketyre punimeve me trashesinë e shtresave rrugore si dhe rezultatet e provave laboratorike (përberja kokrrizore, kufijte e plasticitetit, Proctor I modifikuar, CBR), jepen në anekset 2 dhe 3 të ketij raporti.



TP-13	0+910
TP-14	0+220

Figure 14 – Pozicionimi ne harte i sondave

4.5.3 Vlerësimi Gjeologo-Inxhinierik i zonës ku kalon Aksi rrugor Tiranë- Durrës në bazë të shpimeve gjeoteknike

Për njohjen e ndërtimit gjeologo-inxhinierik dhe konditave inxhinjero-gjeologjike të truallit të strukturave ekzistuese të këtij aksi rrugor, u kryen 16 shpime me thellesi 20-30 meter. Procedura e shpimeve është ajo me rrotullim, me diameter 110mm dhe tubo rrethimi 127mm, për mbrojtjen e faqeve të pusit. Në intervalet e shtresave të vecuara, janë marre kampione për analiza laboratike, për njohjen e vetive fiziko-mekanike të tyre. Gjithashtu për shtresat e vecuara, në puse, është kryer prova dinamike e penetrimit standart (SPT), e cila sidomos për dherat me strukturë të palidhur (rëra), jep mundësinë e gjykimit të ngjeshmerisë (Dr- dendesisë relative), si dhe shfrytëzim të literatures përsa i takon parametrave kryesore të rezistencës në prerje. Mbi bazën e të dhenave të këtyre punimeve, analizave laboratorike si dhe punimeve të mepareshme të kryera përgjate këtij aksi rrugor, janë vecuar një sërë shtresash, vetitë fiziko-mekanike të të cilave jepen në kapitullin perkates te raportit specifik. Në ndarjen e shtresave krahas kriterit themelor (vetitë fiziko-mekanike), është përdorur dhe ai i origjines së formimit. Keshtu shpjegohet fakti i dy shtresave të rërës, etj.




Figure 15 – Lokalizimi ne harte i testeve ne vend

TIRANË-DURRËS HIGHWAY						
Nr	Name	Nord	East	X	Y	Chainage
1	Br.01	41° 21' 14.19"	19° 44' 37.92"	394924	4578810	2+261.584

Tabele 2 – Tabela e puneve ne terren

Përfundime

Nga sa trajtojme në këtë kapitull rezulton se aksi rrugor Tiranë-Durrës në gjatesine e tij karakterizohet nga një ndërtim gjeologjiko-litologjik heterogjen si përse i takon llojit të depozitime ashtu dhe karakteristikave inxhinjero-gjeologjike të shtresave që e kompozojnë. Ky heterogjenitet shfaqet si në hapsire ashtu dhe kohe, dukuri kjo karakteristike për origjinën e ketyre depozitimeve.

Pergjithesisht vetite fizike – mekanike te dheut gjate aksit te rruges rezultuan te ishin ndermjet intervalit te gjendjes nga te varfer ne te pranueshme, por duke konsideruar rastet e skenareve me te keqin ne situatat e permytjeve, per qellim te studimit, duhen marre ne konsiderate karakteristika te reduktuara te parametrave te dheut.

Rekomandohet qe shtresat e rruges ekzistuese te perforcohen ne menyre te tille qe rruga te perballoje ngarkesen e parashikuar te trafikut dhe gjendjen reale te tokes (nuk do te merret parasysh situata aktuale e tokes). Në pjesët ekzistuese rruga do të zgjerohet, është e domosdoshme të aplikohet zëvendësimi i terrenit ekzistues me anë të aplikimit të një shtrese të përshtatshme mbulimi në përputhje me lartësinë e argjinaturës, parametrat e matur dhe të rrjedhshëm (CBR dhe Elastic Modulus).

Gjithashtu per shkak te kapacitet mbajtes te ulet dhe ngjeshjes ne disa zona ku mbushjet jane shume te larta duhet te behet nje analize e uljeve te trupit te rruges dhe te merren masa per konsolidimin e terrenit si dhe masa te bdryshme nga metodat e zevenbdesimit. Ne raste te tilla per te shmangur uljet diferenciale te ndryshme metoda e zevensim-vibrimit. Nje metode vibro-zevensimi nepermjet pilave te zhavorrit nen mbushjet e medha ose mureve ne toka te kompresueshem mund te ishte relativisht nje zgjidhje efektive per te shmangur uljet diferenciale te ndryshme ne raste te tilla.

4.5.4 Testi i Penetrimit te Konit Statik

Testet u kryen në përputhje me Referencën Ndërkombëtare të Proçedurës së Testit për CPT dhe CPTU (ISSMGE). Thellësitë finale u përcaktuan nga arritja e thellësisë specifike të testit ose kur u arrit kapaciteti maksimal i sigurisë së pajisjes. Në Shtojcën 3 perketes paraqitet një program i testeve të kryera, i cili është përpiluar nga raporti ditorë i inxhinierëve në vend. Të dhënat janë transmetuar nga një CPTU dixhitale, përmes një kabllit lidhës, i cili kalon nëpër shufrat që shtyhen në tokë deri në sistemin e marrjes së të dhënave. Shkalla e penetrimit mbahet konstante në vlerën 2cm/s $\pm 10\%$, me përjashtim të rasteve kur penetrohet në shtresa shumë të dendur ose të forta. Rezultatet janë paraqitur menjëherë në ekranin e kompjuterit të loguar. Rezultatet janë regjistruar në hard diskun e kompjuterit. Para kryerjes së secilit test janë marrë vlerat e leximeve zero të konit për të kontrolluar nëse ai është i kalibruar. Në fund të çdo testi, merren sërisht vlerat zero për të parë nëse ka pasur ndonjë devijim gjatë testit. Këto vlera shqyrtohen në fazën pas proçesimit. Të gjitha pozicionet janë përcaktuar nga Klienti në vend dhe vëzhguar nga T.T.SOIL & EARTHQUAKE Consulting sh.p.k me anë të një sistemi GPS të lëvizshëm.

4.5.5 Shenuesit e uljeve ose ekstensometri

Shenuesi i uljeve perdoret per te zbuluar uljet, fundosjet dhe deformimet e argjinaturave artificiale, si gjate fazes se ndertimit ashtu dhe gjate fazes se administrimit. Thjeshtesia e instalimit dhe leximit, saktësia e matjes dhe kostoja shume e ulet, e bejne kete nje mjet shume popullor per monitorimin gjeoteknik dhe strukturor ne te gjithe llojet e argjinaturave. Instrumenti mund te lexohet manualisht ose nepermjet nje "stadia", ose i automatizuar nepermjet sensoreve elektrike dhe i lexueshem ne distance ne aparatit qe mbahet ne dore.

Ekstensometrat perdoren ne monitorimin gjeoteknik per matje me precizion te levizjeve (ulje dhe deformime) te nje apo me shume pikave te sipërfaqes ne lidhje me pika te konsideruara te fiksuara, te vendosura ne thellesi te ndryshme te shkëmbit

4.6 Analizat gjeoteknike bazuar ne rezultatet e testeve

4.6.1 Analiza a Probabilitetit te Lengezimit te Rerave

Testi i Penetrimit te Konit (CPT) dhe Testi i Penetrimit Standart (SPT) jane dy indikatorët te perdorur me gjerësisht per vleresimin e karakteristikave te lengezimit te reres. SPT eshte perdorur me pare per zhvillimin e korrelacionit te lengezimit, por CPT ka nje numer avantazhesh te cilat e kane bere ate mjetin primar te karakterizimit te terrenit ne disa percaktime gjeologjike. Matjet ne vend te shpejtesise se vales (Vs), Testi i Penetrimit Becker (BPT) dhe testimet e

penetrimeve te medha (LPT) perdoren ne situata te vecanta dhe prandaj perdoren me rralle se SPT dhe CPT ne vleresimin e lengezimit. Ne shumicen e situatave keto mjete te ndryshme te karakterizimit te terrenit kane role plotesuese dhe perdoren me efektivisht ne kombinim me njeri-tjetrin.

Ne raportin gjeologjik dhe gjeoteknik verifikimet jane dhene duke perdorur:

- a) Llogaritje e lengezimit te rerave bazuar ne rezultatet e testeve SPT
- b) Llogaritje e lengezimit te rerave bazuar ne rezultatet e testeve CPT

Konkluzione – Rekomandime

Sic e tregon dhe analiza e mesiperme ne kemi arritur ne perfundimin se dy struktura e autostrades Tirane-Durres, te quajtura mbikalimi i kryqezimit te Lalzit dhe mbikalimi I Shen Vlash-it ekziston nje potencial qe te ndodhi fenomeni I lengezimit ne shtresat e reres nr.4 dhe 5 ne thellesi te peraferta respektivisht 2.5 - 9 m per mbikalimin e Shen Vlash-it dhe 8.5 – 12 m per kryqezimin e Lalz-it. Pjesa tjeter e strukturave te vleresuara nuk kane treguar gjasa reale qe fenomeni mund te ndodhi. Ne kete situata bazuar ne statigrafine e tokes se zones dhe ne llojin dhe thellesine e themeleve te thella qe do te perdoren, ne rekomandojme qe nentoka ranore te trajtohet me konsolidim artificial ose me metodat e densifikimit si vibro-floatation. Kjo metode perfaqson perdorimin e nje vibratori te vecante elektrik I quajtur “Vibriflot”, I cili lidhet me tuba percjelles te lidhur ne seri (ne baze te thellesise se deshiruara). Kjo pajisje levizet me ane te nje vinci, si ilustruhet ne figuren e meposhtme.




Figure 31 - Component drawing (Vibro Services Gmbh Instruction manual 2008)

4.6.2 Zevendesimi i shtreses ekzistuese te tokes- Shtresa bonifikuese

Profili gjeologjik tregon per nje tipar konstant te nenshtresave te autostrades sone te re me pak perjashtime, pjesa me e madhe e shtrirjes rrugore shtrihet mbi shtresa argjile ose argjile pluhurore te buta, te ngjeshshme, me karakteristika pergjithesisht te dobeta e cila ne aspektin e fortetise mekanike qe na intereson per trotuarin e rruges mund te kategorizohet si me modul elasticiteti dhe kapacitet mbajtjes te ulet (Ev1 prej 5-10 MPA, CBR 3-5%) Me qellim

pergatitjen e nje themeli rruge te shendoshe dhe afatgjate ekziston nevoja per te ribere permiresimin e asaj ekzistuese me metoden e zevendesimit tradicional te germimit ne thellesi te ndryshme token e papershtatshme duke aplikuar ne shtresat kompakte nje material me drenazh te lire te njohur ndryshe si shtrese bonifikuese. Ky aktivitet ndodh pothuajse ne te gjitha shtrirjen e rruges pasi ky i fundit zhvillohet ne nje mbushje shume te ulet ne zonen e sheshte.

Neneshtresa e aksit rrugor Tirane-Durres ne shtrirje nga te dy krahet eshte ndertuar pothuajse e gjitha ne toke argjillore, e cila eshte vleresuar nga studimet laboratorike qe ka nje kapacitet mbajtes ngarkese $CBR=4.3\%$. Vlera CBR e nje materiali mund te varioje sipas balances se permbajtjes se lageshitise, keshtu qe projektuesi duhet te gjykoje vleren e CBR ne terma afatgjate. Permabjtja e lageshitese ne terma afatgjate varet nga nje numer faktoresh si:

- Tipi i dherave
- Niveli i ujrave nentokesor
- Drenazhi
- Kushtet e motit
- Historia e ndertimit etj.

Keta faktore ndikojne drejtperdrejt ne ekuilibrin e permbajtjes se lageshitise ne dherat koheziv duke i cuar ata ne ngopje, zvogelim te vleres se kapacitetit mbajtes deri ne $CBR=2\%$. Per kete vlere te CBR, sipas Rafirou M. (Essai d'étude-statistique des constantes élastique - Etude des Matériaux Routier-Revue générale des Routes et des Aérodomes, 1971) korespondon me nje vlere te modulit te ciklit te dyte (Ev_2) $Ev_2=6MPa$.

Nenshtresa me kete vlere te modulit nuk mund te luaje rolin e saj kryesore per te mbajtur ngarkesen e transmetuar nga shtresat e trotuarit pa pesuar deformime. Si me siper, eshte thelbesore permiresimi i kushteve te nenshtresave dhe permiresimi i saj nen kushte te pranueshme me nje modul te ciklit te pare te testit te pllakes te ngarkeses me nje diameter 300mm, $Ev_1=15MPa$ (vlere e rekomanduar nga standarti Italian)

Duke iu referuar "Manuali I projektimit per rruge dhe ura Vol. 4, Seksioni 1, Pjesa 1 HA44/91, Kapitulli 10-Tabela 1.10 – Trashesia e shtreses bonifikuese per nenshtresa dhe shtangesi te ndryshme " per $CBR=2\%$ rekomandohet nje zevendesim i terrenit ekzistues me nje trashesi 600mm.

Materiali i shtreses bonifikuese duhet te jete me granulometri te grupit A1-A2 (Klasifikimi HRB-AASHTO) ose 6F1-6F2 (Serite 600- standarti per autostradat) material i zgjedhur granular i holle ose i trashe. I vendosur mbi nje shtrese gjeotekstili i cili duhet te vendost ne te gjitha seksionin e germuar.

Pas ndertimit te shtreses bonifikuese (dy shtresa 0.3m kompakte me maksimumi 90% densitet te thate te marre nga prova e modifikuar Proctor) ne nivelin e perfunduar realizohet testi i ngarkimit te pllakes (me diameter 300mm)

Vlerat e modulit per ciklin e pare Ev_1 (0.05-0.15 MPa) sipas experiences ne keto lloj nderyrjesh ne nentoka te ngjashme ne Shqiperi (Autostrada Levan-Tepelene dhe Bypass-i i Vlores) do te jete me madhe se 15 MPa.

Mbi shtresen bonifikuese ne do te nderojme MBUSHJEN, e cila ne nivelin e perfunduar duhet te kete nje sjellje ne deformueshmeri qe garanton vleren e modulit te ciklit te pare te ngarkimit (0.15-0.25 Mpa) me e madhe se 60MPa

Nje vlere $Ev_1=65-70$ Mpa ne nivelin e perfunduar te mbushjes do te siguroje permbushjen e sjelljes se deformuar te kerkuar per shtresen nen-baze.

Permbushja e ketyre kerkesave percakton lartesine e mbushjes dhe tipin e materialit qe do perdoret. Per te zvogeluar lartesine e mbushjes faktori percaktues eshte lloji i materialit qe do te perdoret.

Perdorimi i materialeve te grupit A1-A3 (klasifikimi AASHTO) ne 0.90m lartesi te mbushjes, do te rekomandohej si nje zgjidhje shume cilesore. Kjo do te thote se nje material i mire pershtatur i mbushjes duke shtuar shtresen bonifikuese me nje trashesi te pergjithshme $0.9+0.6=1.5m$ eshte e mjaftueshme per te thither dhe shperndare ngarkesat e trafikut nga trotuari (zakonisht 0.8m ne autostrada) ne toke te bute me karakteristika fiziko-mekanike medioker.

Ne autostraden Tirane-Durres ne kemi zgjedhur te konsiderojme per qellim te percaktimit te nje shtrese bonifikuese te pershtatshme dhe te qendrueshme pergjate autostrades, skenari me l keq i tokes me nje $CBR 4.2 \%$ e cila ne kushte

te ngopura me uje (duke supozuar situaten e permbytjes) mund te mere edhe 2%. Natyrisht, sic tregojne rezultatet e studimit gjeologjik, jo e gjithë nentoka ka parametra te tille por per qellim te studimit ne do te bazojme vleresimin tone ne rastin me te keq duke zbatuar arsyetimin e mesiperm teknik.

4.6.3 Llogaritja e uljeve, kapacitetit mbjtes dhe llogaritja e stabilitet ne mbushjet e larta bazuar ne provat laboratorike

Sic eshte permendur me siper, uljet jane llogaritur bazuar ne te dhenat e testimave CPTU, duke marre ne konsiderate themelet katrore te ceket me nje gjeresi prej $B = 6.0$ m, thellesi e inkorporuar prej $D = 5.0$ dhe nje presion mbajtes pergjate bazamentit te themeleve $q = 150$ kPa. Ne te gjitha rastet e raportuara uljet totale jane me te medha se sa uljet e rekomanduara totale te lejuara. Vlera uljesh prej 78 cm mund te jene katastrofike per te gjitha strukturat. Duke konsideruar permasa te tjera te themeleve te ceketa do te rezultojne ne vlera te ndryshme te uljeve totale, por pritet qe uljet do te reduktohen nese permasat e bazes se themelit rriten dhe anasjelltas, uljet do te rriten nese permasat e bazes se themelit reduktohen.

Analizat e uljeve per mbushjet ne kohe u kryen duke perdorur programin kompjuterik GeoStructural Analysis v18 Settlement. Ky kod na lejon ne te studiojme problemet ne kushtet e deformimeve plane, duke stimuluar historine e gjendjes se sforcuar te tokes dhe strukturave te ndertuara me te

Matja e LOS ndryshon ne varesi te tipit te segmentit (segment baze, rampa hyrese/dalese, zona te bashkuara, nyje). Ne segmentet baze, LOS per raporte te ndryshme Volum/kapacitet (V/C) trafiku, percaktohet nga:

LOS	Traffic volume /Capacity Ratio
A	0.34
B	0.35-0.5
C	0.51-0.74
D	0.75-0.89
E	0.9-0.99
F	Demand exceeds capacity

Tabele 7 – Kriteret e LoS per segmentet baze te autostardes

LOS	Density (pc/km/ln)
A	<= 6
B	> 6-12
C	> 12-17
D	> 17-22
E	> 22
F	Demand exceeds capacity

Tabele 8 – Kriteret e LoS per segmentet e devijimit dhe freeway merge

LOS	AVERAGE DELAY (sec)
A	<= 10
B	> 10-20
C	> 20-35
D	> 35-55
E	> 55 - 80
F	Demand exceeds capacity and delay >80

Tabele 9 – Kriteret e LoS per rrethrotullimet

LOS	AVERAGE DELAY (sec)
A	<= 10
B	> 10-15
C	> 15-25
D	> 25-35
E	> 35 - 50
F	Demand exceeds capacity and delay >50

Tabele 10 – Kriteret e LoS per nyjet prioritare

6.5.2 Rezultatet

Metodologjia HCM, e aplikuar ne secilen nga rampat hyrese dhe dalese, jep rezultatet e meposhtme:

Interchange	Ramp	Type	LOS - AM	LOS - PM
KASHAR	1	On Ramp	B	B
	2	Off Ramp	C	B
	3	On Ramp	B	B
	4	Off Ramp	C	B
VORE	1	On Ramp	C	D
	2	Off Ramp	C	D
	3	On Ramp	B	B
	4	Off Ramp	B	B
LALZIT	1	On Ramp	B	C
	2	Off Ramp	B	C
	3	On Ramp	B	A
	4	Off Ramp	B	A
SHKOZET	1	On Ramp	B	B
	2	Off Ramp	B	C
	3	On Ramp	A	A
	4	Off Ramp	B	B

Tabele 11 – Rezultatet e LoS

Per te gjitha rampat ka nje nivel te mire sherbimi, qe varion nga A ne C ne shumicen e rasteve. Vetem per Voren ne pikun e mbremjes, niveli arrin nivelin D, qe gjithsesi konsiderohet i kenaqshem.

6.6 Perfundime

Analiza e trafikut kerkohet ne faza te ndryshme te projekteve per te siguruar informacion sasior ne projektimin e elementeve infrastrukturore te ndryshem te superstrades (rampat, zonat ne zhvillim, nenkalimet dhe mbikalimet) ne nje periudhe parashikimi prej 20 vjetesh dhe inputin themelor per CBA.

Analiza e trafikut ka matur volume te ndryshme trafiku ne segmente te ndryshme te autostrades Tirane – Durres dhe rruget e sherbimit dhe lidhjet. Analiza e trafikut eshte bazuar ne te dhenat direkte te trafikut, te mbledhura permes vezhgimeve te projektuara enkas per projektin dhe te gjitha te dhenat historike te meparshme dhe informacionin prezent ne projekte te tjera (Thumane – Vore) ose dokumenta planifikues (ANTP-2, Tiranë by Pass).

Horizontet e parashikimit 2020 dhe 2040 u vendosen per te mbuluar CBA. Skenari i fundit 2040 u perdor gjithashtu edhe per verifikimin e LOS per te gjithe elementet ne infrastrukture.

Ne kuadrin e modelimit dhe parashikimit te trafikut, gjurma e autostrades u konsiderua si nje variant dhe skenare alternative u testuan me qellimin kryesor per te vleresuar planimetrine e kryqezimit per kryqezimin e Shkozetit.

Analiza e rezultateve (ne termat e LOS dhe kapacitetit) con ne perfundimet e meposhtme:

- Rritja e numrit te korsive (nga 2 ne 3 per drejtim) nevojitet [er segmentin e pare te autostrades (nga Tirane ne Vore), sidomos ne mungese te Tiranë By Pass;

- Projektimi i rampave hyrese dhe dalese pergjate autostrades tregon projektin dhe konfigurimin korrekt, duke lejuar LOS te mira ne shumicen e rasteve (nga A ne C) dhe vetem per kryqezimin e Vores nivelin D per nje drejtim;
- Nderlidhjet ndermjet rrugëve urbane dhe rrugëve te sherbimit permes rreth rrotullimeve dhe nyjeve kryesore tregojne performancat me te keqija ne dy raste:
 - Kryqezimi SHKOZET: projekti aktual pothuajse ka integruar te gjitha masat e mundhsme lehtesuese. Rrethrotullimi verior eshte zgjeruar me maksimumin e gjeometrise qe lejon ndertimi. Intersektimi ne jug eshte rikonfiguruar duke fshire cdo manover ne kthesen e majte. ne projektin final eshte sygjjeruar vleresimi i nje rampe pershejtuese ne vend te nje nyjeve kryesore;
 - Kryqezimi VORE: sistemi i rrethrotullimit vuan mungesen e kapacitetit per rrethrotullimet e lokalizuara ne Fushe side. Propozohet nje vleresim i metejshe dhe permiresim ne fazen e projektit te detajuar.
- Konfigurimi me i mire per kryqezimin e Shkozetit eshte provuar te jete sistemi me rampa hyrese dhe dalese. Ne krahasim me konfigurimin e giethes se terfilit me 4 flete, ai sjell me pak mbingarkese ne te gjitha rampat dhe ne mbikalim.

7 PROJEKTI I RRUGES

7.1 Klasifikimi Rrugor

Standarti i projektimit te rruges, i perdorur nga Konsulenti si referencë për te gjitha çështjet qe lidhen me parametrat gjeometrike dhe përcaktimin e gjurmes se propozuar te autostrades se re, eshte Manuali i Ri i Projektimit te Rrugeve ne Shqiperi, date 30. 07.2015. Sipas përvojës ndërkombëtare të Konsulentit, duke përdorur rregulloren e sipër përmendur, Autostrada e ardhshme do te permbushe standartet me te larta persa i perket:

- Sigurise;
- Kapacitetit;
- Sjelljes se Përdoruesve te Rrugës;
- Shpejtësise se pranuar te Projektimit.

Persa i perket funksionit kryesor qe do te kryeje kjo autostradë ne te ardhmen, ajo i perket Kategorisë A - Autostrade.

Kategoria A perbehet nga dy karrexhata te pavarura te ndara nga nje barriere sigurie e pakalueshme, secila me te pakten dy korsi, bankine te shtruar ne te majte dhe korsi emergjence ne te djathte, pa kryqezime ne nivel, dhe me kontroll strikt te aksesit.

Rruga do te jete e mbrojtur (me guardrail) dhe e pajisur me sisteme emergjence pergjate te gjithe gjatesise se saj. Ne autostrade do te lejohet hyrja vetem e disa kategorive te caktuara te trafikut te motorizuar, duke vendosur sinjalistikën perkatese ne fillimet dhe fundet e saj. Jane parashikuar zona ndalimi dhe sherbimi, duke siguruar akses te pershtatshem nepermjet korsive te pershpjtitimit dhe ngadalesimit.

Kategorite e mjeteve qe do te lejohet te perdorin rrugen e re jane:

- Autovetura
- Autobuse;
- Kamione;
- Mjete te artikuluar transporti.

Kuadri ligjor referues eshte VKM Nr.628 date 15.07.2015, "Per miratimin e Rregullave Teknike te Projektimit dhe Ndertimit te Rrugeve", Rregullat Teknike per Projektimin e Rrugeve, Volume 2 - Projektimi Gjeometrik.

Volumet e Trafikut per Autostrade te kategorise "A" jane mesatarisht mes 24.000 – 67.000 AADT.

Të dhëna kryesore:

- Shpejtësia minimale e projektimit $V_p=90$ km/orë,
- Shpejtësia maksimale e projektimit $V_p=140$ km/orë,
- Zgjidhja bazë me 3+3 korsi kalimi, dhe korsi emergjence nga të dyja anët,
- TDMV = 24000 - 67000 mjete/24orë

7.2 Elementet gjeometrike të projektimit të rrugës në plan

7.2.1 Shpejtesia e Projektuar

Sipas kategorise rrugore eshte specifikuar se shpejtesa e projektuar do te perfshihet ne intervalin 90km/hr – 140 km/hr. Zgjerimi I nje Superstrate ekzistuese do te thote se parametrat kryesore gjeometrike jane tashme te vendosur dhe ato do te perdoren kryesisht ne zhvillimin e projektit. Keshtu, ne disa raste analiza e shikueshmerise drejton rezultatin perfundimtar te diagrams se Shpejtesise. Analiza e vizibilitetit do te vazhdoje ne paragrafin pasardhes..

Sipas kategorise se rruges, specifikohet qe shpejtesia e projektuar do te varioje nga 90km/h - 140km/hr. zgjerimi i nje autostrate ekzistuese do te thote qe parametrat kryesore gjeometrike jane vendosur tashme dhe do te perdoren gjate zhvillimit te projektit. Keshtu qe, ne kete rast, analizat e vizibilitetit udheheqin rezultatet finale te diagrames se shpejtesise se projektit. Analiza e vizibilitetit do te vazhdoje ne paragrafin pasardhes

Persa I perket diagrams se shpejtesise se projektuar, rezultatet kryesore jane:

E gjithë superstrada është përfshirë në standartin e rangut të shpejtësisë 90 – 141 km/ hr duke përjashtuar pjesën e fundit të projektit (Ura e Dajlan it) pasi nuk është e mundur të mbahet distanca e kërkuar e shikueshmerise per ndalim ne zonen e ures duke ri-perdorur strukturen ekzistuese.

Per shkak te profilit gjatesor, ne disa zona redukimi I kufizimeve te shpejtesise Administrative eshte I nevojshem. Rezultatet paraqiten me poshte si nje liste, si nje skeme diagrame dhe si shperndarje perqindjeje pergjate te gjithë rruges

From Ch.	To Ch.	Lenght (m)	Design Speed km/h
0+000	10+000	10.000	140

Tabele 12 – Shpejtesia e projektuar (ne format tabele)




Figure 35 – Diagrama e shpejtësisë




Figure 36 –Shperndarja pergjate autostrades e shpejtesise se projektit

Megjithese shpejtesia e projektuar vendos graden maksimale te kurbatures dhe distancen maksimale te shikueshmerise per operim te sigurt, nuk duhet te kete kufizime ne perdorimin e lakoreve horizontale te sheshta ose distancave me te medha te shikimit, ku permiresime te tilla mund te sigurohen si pjese e projektimit ekonomik.

Megjithate, nese kthesat e sheshta ose seksione tangente do te inkuajonin shoferet te operonin ne shpejtesi me te medha, atehere projektimi i kthesave do te marre ne konsiderate shpejtesine maksimale (140 km/hr).

Te gjithë karakteristikat gjeometrike, vecanerisht distancat e shikimit ne kreshten e kthesave vertikale duhet te lidhet me te. Pergjate te gjithë superstrades, rreth 70% e rruges permban maksimumin e shpejtesise prej 140km/hr.

7.2.2 Gjurma Horizontale

Gjurma horizontale duhet te siguroje per operim te sigurt dhe te vazhdueshem ne nje shpejtesi projektimi uniforme per gjatesite substancialte te superstrades. Standartet aplikohen ne kthesa ne te dyja karrexhatat teke dhe karrexhatat dyshe, pervecse kur cilesohet ndryshe. Keto standarte aplikohen gjithashtu edhe ne kryqezime dhe pjese te rrugeve lokale.

Karakteristikat me kryesore ne projektimin e gjurmes horizontale jane siguria, profili, tipi i facilitetit, shpejtesia e projektuar, karakteristikat gjeoteknike, topografia, kostot e ndertimit dhe shpronosit. Ne projektim, siguria konsiderohet gjithmone , qofte direkt ose indirekt. Shpejtesia e projektuar, ne kthese, kontrollon distancen e shikimit, por distanca e shikimit duhet marre ne konsiderate bashke me topografine sepse shpesh ajo kerkon nje rreze me te madhe se shpejtesia e projektuar. Te gjithë keta faktore duhet te balancohen per te perftuar nje gjurme qe optimizon permbushjen e objektivave te ndryshem si siguria, kostp, harmonia me konturin natyror te tokes, dhe ne te njejten kohe te pershtatshme per klasifikimin e projektit te rruges.

Gjurma horizontale duhet te siguroje te pakten minimumin e distances se shikueshmerise per ndalim per shpejtesine e zgjedhur te projektit ne te gjitha pikat e rruges.

7.2.3 Vijat e drejta

Autostrada Tirane - Durres ka nje gjatesi totale prej 30+785 km, dhe nr total i kthesave eshte 22. Te gjithë elementet gjeometrike te gjurmes horizontale jane ne perputhje me kodin Shqiptar (ju lutem referojuni dokumentit gjeometria e autostrades/nyjeve ne disnivel).

Megjithate, seksionet e gjata te drejta me pjerresi konstante mund te kene disa disavantazhe. Vecanerisht ato mundet:

- Te motivojne shoferin te ngase me shpejt
- Te rrisin rrezikshmerine e verbimit nga ana e kundert e mjeteve gjate nates
- Te shkaktojne lodhje ne pjesen me te madhe te perdoruesve te rruges

Formula e meposhtme perdoret per te llogaritur gjatesine minimale te segmentit te drejte lidhur me shpejtesine e projektuar $Lr=22*VD[m]$

VD (km/hr)	40	50	60	70	80	90	100	110	120	130	140
Lmin (m)	30	40	50	65	90	115	150	190	250	300	360

Tabele 13 –Gjatesia minimale e vijes se drejte

Projekti per zgjerimin e autostrades Tiranë-Durrës ka disa zona te limituara ku gjatesia minimale e gjurmes horizontale nuk eshte verifikuar, meqe jemi ne kushtet e nje gjurme ekzistuese, dmth te sforcuar per tu pershtatur sa me shume qe eshte e mundur me gjeometrine ekzistuese.

7.2.4 Kthesat Rrethore

Për lakimet rrethore rrezet duhet të përzgjidhen aq të mëdha sa të jetë e mundur sipas topografisë, në mënyrë që të arrihet: distancë shikimi për parakalim të mjaftueshem; ruajtjen e njëtrajshmërisë gjatë drejtimit. Per kete projekt duhet te marrim ne konsiderate gjeometrine ekzistuese, keshtu qe lakoret e reja rrethore jane shume te kondicionuara nga lakoret rrethore ekzistuese.

Ndërmjet dy kthesave rrethore në të njëjtin ose në krah të kundërt, rrezja e këtyre kthesave duhet të jetë rezultat i një raporti të balancuar me sigurinë e trafikut. Kur projektohen autostradat (A) dhe rrugët rurale parësore (B), sekuenca e rrezeve duhet të jetë brenda zonës së mirë.

Ndërmjet nje segmenti të drejtë me gjatësi Lr dhe lakores rrethore me rreze minimale duhet të respektohet raporti i meposhtëm:

$R > LR$ për $LR < 300m$ $R \geq 400m$ për $LR \geq 300m$




Figure 37 – Distanca e nevojshme per ndalim ne autostrade

Rrezja minimale R në varësi të shpejtësisë së projektimit dhe të seksionit tërthor paraqitet në tabelën e mëposhtme::

VD (km/h)	min R (m)	min L (m)
50	80	30
60	120	35
70	180	40
80	250	45
90	340	50
100	450	55
120	720	65

Tabele 14 –Rrezja minimale dhe gjatesia minimale e nje kthese rrethore

Per shpejtesi projektimi me pak se 50 km/h, ne mungese te standarteve shqiptare, eshte marre ne konsiderate Standarti Italian i Projektimit.

Për shpejtësi projektimi 140km/hr nuk eshte e përcaktuar në këtë tabelë rrezja minimale por është e përcaktuar me anë të formulës se rrezja minimale për këtë shpejtësi projektimi është 1100m.

Meqenese mbikalimi i ri eshte ndertuar se fundmi (2012-2013) ne linjen e zgjerimit te mundshem ne te ardhmen te autostrades TR-DR (ai ka seksion me 3x3 kors), do te jete vecanerisht e veshtire ne drejtim te kostos, dhe nuk priten perfitime te medha nga zgjerimi i tij per te siguruar seksionin terthor sipas standartit te projektit te ri. Gjithsesi konsulenti ka propozuar disa ndërhyrje apo përmirësime për këtë rrugë në mënyrë që shpejtësia e projektimit në gjithë segmentin e projektit në fjalë të jetë në kufijtë e 90 ÷ 140 km/h..

7.2.5 Kthesat Horizontale (me gjatesi spirale)

Per te siguruar nje kalim gradual nga segmenti vijedrejte ne ate rrethor te planimetrise, duke siguruar keshtu nje ndryshim uniform te shpejtesise si dhe nje ndryshim te nxitimit centrifugal i cili perputhet me dinamiken e levizjes se mjetit, perdorimi i një distancë për tranzicionin e nje pjerresie gjatesore te lejuar per linjen e ekstremiteve te platformes, ben te mundur rezultimin në një planimetri optikisht te saktë. Përdorimi i lakoreve me rreze te ndryshueshme kërkohet për të gjitha kategoritë e rrugëve. Per rakordin horizontal te pjeseve vijedrejta dhe te harqeve rrethore te aksit te rruges, perdoret klotoida e cila eshte ajo lakore qe ndryshon lakoreturen nga vija e drejte ne hark rrethor. Teorikisht klotoida përkufizohet si më poshtë:

$r * sn = An+1.$

VD (km/h)	min A (m)
40	80
50	120
80	180
100	250
120	340
140	450

Tabele 15 – Vlerat minimale te parametrin A per “Gjatesine Spirale”

Në llogaritje e bëra parametrin të klotoidës është marre në konsideratë ekuacioni i meposhtem:

Kushti dinamik $A \geq 0.17 \times vV3$

Ku V - është shpejtësia e projektit

Kushti optik $R/3 \leq A \leq R$

Ku R eshte rrezja e harkut rrethor

Kushti i pjerresive $A \geq VR \times B \times i / 2 k$

Ku R - eshte rrezja e harkut rrethor ne [m];

B - eshte gjeresia e shtreses rrugore ne [m];

i - eshte pjerresia perpendikulare e shtreses rrugore;

k- eshte pjerresia gjatesore e vijes se jashtme drejtuese; A – parametri i klothoides [m].

Ky ekuacion në të gjitha rrezet ku janë aplikuar klotoidat plotësohet dhe është konform normës së projektimit.

Përfundim bën kthesa e parë e cila duke konsideruar se këndi i kthesë ka një ndryshim këndor prej 10° nuk janë realizuar klotoidat dhe si rregull i plotësuar në normë është aplikuar gjatësia e lakores rrethor është sa dyfishi i shpejtësisë së projektimit.

Parametri A i klotoidave të përdorura në projekt është specifikuar te lakoret rrethore në tabelën e mësipërme me vlerat përkatëse dhe i plotëson të gjitha kërkesat e normës së projektimit.

Përfundim nga normat bëjnë parametrat në kthes me numër 16, 17, 20, 21, 23 po ku devijim nuk përbën një problem apo përkeqësim të sigurisë rrugore.

7.2.6 Distanca e shikimit

Për të ofruar një siguri trafiku dhe nivel shërbimi të duhur, kërkohen distanca minimale shikimi. Distanca e shikimit është gjatësia në vazhdim e rrugës përpara e shikueshme nga drejtuesi i automjetit..

7.2.7 Distanca e shikimit e kërkuar për ndalim

Distanca e shikimit e kërkuar për ndalim është ajo distancë që një drejtues i cili udhëton me shpejtësinë e projektimit i nevojitet për të ndaluar automjetin e tij përpara se të godasë një pengesë të papritur. Ajo përbëhet nga distanca që përshkon një automjet gjatë kohës së reagimit të drejtuesit dhe distancës për vetëfrenim.




Figure 38 – Distanca e shikimit e kërkuar për ndalim në autostrada

Distanca e shikueshmerise per ndalim do te matet nga nje lartesi minimale e syrit te shoferit 1.10m, drejt nje objekti me lartesi 0.10m te dyja te matura mbi lartesine e siperfaqes se rruges, sic tregohet ne figuren e meposhtme. Do te kontrollohet ne te dy planet horizontale dhe vertikale, ndermjet cdo dy pikave ne qender te korsise ne anen e brendshme te kthesa (per cdo karrexhate ne rast te karrexhates dyshe).




Figure 39 –Distanca e nevojshme e shikueshmerise per ndalim

Nga llogaritjet e kryera për pamshmerinë e rrugës rezulton se disa kthesa duhet të përmirësohen duke bërë zgjerimet e duhura dhe duke ritur pamshmërinë e tyre. Në këto kthesa është bërë kjo ndërhyrje dhe këto zgjerime si më poshtë:




Figure 40 – Shembull i planimetrisë se zgjerimit per te siguruar distancen e shikueshmerise per ndalim

7.2.8 Gjurma Vertikale

Gjurma vertikale është një vijë orientimi me anë të së cilës përcaktohet trashësia e shtresave dhe e elementeve të tjerë të rrugës. Ajo diktohet kryesisht prej topografisë, llojit të rrugës, planimetrisë, dhe performancës së automjeteve të rënda, kostove për shpronësim, siguri, distancës së shikimit, kostove të ndërtimit, zhvillimit kulturor, drenazhimit, dhe pamjes së këndshme. Duke konsideruar se projekti në fjalë ka për qëllim kryesor zgjerimin e superstradës Tiranë – Durrës, përvijimi vertikal I propozuar është afër kuotë ekzistuese për të shmangur impaktet në kushtet e përmendura më lart. Megjithatë, gjurma e re vertikale e projektuar paraqet përmirësime në seksione të ndryshme krahasuar me ato ekzistuese.

Kuota e projektit në strukturat ekzistuese propozohet në të njëjtin nivel me ato të tokës ekzistuese. Në disa pika janë bërë disa korrigjime për të mundësuar realizimin e një gjurme të re vertikale sipas kodeve të reja të projektimit.

Në progresivën 12+027.08 Në vepren ekzistuese në Vorë, structure e ndërtuar së fundmi nga ARSh kuota e projektit është ruajtur kuota ekzistuese. Në fillim (prog 11+600 ÷ 11+950 dhe në fund të kthesës (prog 12+100 ÷ 12+625) është

propozuar një mbushje në madhësinë maksimale prej 1.5m. Kjo mbushje është krijuar për të realizuar një profil gjatësor në përputhje me normat në fuqi.

Sic eshte permendur me siper, per te vendosur nje gjurme korrekte nga ana gjeometrike altimetrike ne disa raste nje diference ne ngritjen ndermjet projektiit te rid he siperfaqes ekzistuese do te sigurohet. Sipas zbatimit te punimeve dhe fazave ne nje rang prej 40 cm ne diference ngritjeje nuk ka nevojte per kerkese special pasi ato do te rregullohen lehtesisht nga kontraktoret. Ne rast se diferencat do te jene me shume se 40 cm, vemendje special dhe kerkese provizore do te implementohen gjate ndertimit..

Per te paraqitur nje pamje te asaj zone, referojuni tabelës se meposhtme. Do te kete 16 zona qe do te prezantojne diferencat te medha ne ngritje me nje gjatesi totale prej 4+050 km.

From Ch.	To Ch.	Type C (Cut) F (Fill)	Lenght (m)	H/Depth Max (cm)
2+300	2+500	F	200	60

Tabele 16 –Ndryshimi i kuotes se autostrades

Pjerrësitë gjatësore maksimale të dhëna në Tabele nuk duhet të tejkalohen, për arsye të sigurisë së trafikut.

Road Classification	Maximal Longitudinal Slope i(%)
Motorway “A”	5
Principal interurban/rural Road “B”	6
Secondary interurban/rural Road “C”	7

Tabele 17 – Pjerrësia gjatësore maksimale

Pjerrësitë e forta ndikojnë shpejtësitë e MRM dhe kapacitetin e përgjithshëm.

Në aksin e propozuar të autostradës nuk kemi asnjë segment në të cilin nuk respektohet rregulli i pjerrësisë gjatësore maksimale.

Lakoret vertikale duhet te projektohen në mënyrën e duhur, per të ofruar distancën e nevojshme të shikimit, siguri, komoditet ne drejtimin e automjetit, drenim të mirë, dhe pamje të këndshme. Ne profilin gjatesor te rruges zakonisht si mjet rakordimi përdoren lakoret parabolike por eshte krejtësisht e pranueshme qe te perdoren edhe harqet e thjeshta rrethor me rreze >1500m.

Gjatësia e lakores vertikale llogaritet duke përdorur ekuacionin e meposhtëm

$$L = Rv \frac{\Delta i}{100}$$

Δi - variacioni i pjerrësive

Rv – Rreze vertikale

VD (km/h)	min RVS (m) for concave	min RV (m) for crest
50	500	1400
60	750	2400
70	1000	3150
80	1300	4400
90	2400	5700
100	3800	8300
120	8800	16000

Tabele 18 - Rrezet minimale të lakoreve vertikale

Per shpejtesi me te vogel se 50 km/h, ne mungese te te dhenave ne Standartin Shqiptar te Projektimit, jane marre ne konsiderate vlerat e prezantuar ne Standartin Italian te Projektimit.

Për diferencat algjebrike të pjerrësive gjatësore prej 2% dhe më të mëdha, dhe për shpejtësi te projektimit të barabarta ose më të mëdha se 60 km/h, gjatësia minimale e lakores vertikale në metra duhet të jetë e barabartë me 2V, ku V = shpejtësia projektuese.

Për diferencat algjebrike të pjerrësive me më pak se 2% ose shpejtësi projektimi më të vogla se 60 km/h, gjatësia e lakores vertikale duhet të jetë minimalisht 60 m.

Te gjitha lakoret vertikale te projektit jane ne perputhje me standartet e reja shqiptare te projektimit te rrugeve.

Toleranca vertikale ne rastin e nenkalimeve ose urave do te jete minimumi >5.00 m.




Figure 41 – Distanca vertikale e lejuar

7.3 Autostrada

Sipas ToR të realizuara për objektin, si edhe duke iu referuar standarteve shqiptare në fuqi, rruga e re do te kete parametrat e autostrades se kategorise "A". seksioni tip per kete kategori rruge paraqitet ne paragrafin e meposhtem.

7.3.1 Seksioni Terthor Tip

Sekioni tërthor i përdorur në projekt është i përbërë me tre vija kalimi. Gjërësia totale e rrugës është 35.50m. Në këtë gjërësi do kemi pjesën qendrore në të cilën do jenë pozicionuar dy trafik ndarës dhe dy bankina të veshura në secilën anë, 2x (3x3.75) korsi te asfaltuara, dy korsi emergjence në dy anët e secilit drejtim dhe dy bankina të paveshura 2x1.30m.

Gjerësia e korsisë

Gjerësia e korsisë së kalimit për këtë kategori rrugë është 3.75m dhe korsa e emergjencës është konform normave dhe seksionit tip për këtë kategori, 3.0m

Gjerësia e bankinës së pashtuar (anesore)

Bankina është pjesë e seksionit të rrugës që shërben si element kalimtar ndërmjet bankinës së asfaltuar dhe skarpates, si dhe si vend për vendosjen e barrierave, sinjaleve rrugore dhe pajisjeve të tjera të rrugës.

Gjerësia e bankinës së paveshur për rrugën e kategorisë “A” të projektit të propozuar është marrë 1.30m, kjo për të patur mundësi për të vendosur guard rail apo rrethimin e autostradës.




Figure 42 – Rastet e dimensioneve të bankinës anesore

Skaji në seksionin e rrugës parashikohet të jetë konstant përgjatë gjatësisë së rrugës $b=1.30m$.

Mbingritja e trasesë së rrugës

Mbingritja e trasesë së rrugës është marrë 7%, në pjesën lakore të kthesës. Në pjesën e lakoreve me rreze të ndryshueshme mbilartësimi është gradual dhe është shfrytëzuar gjithë gjatësisë së saj.

Pjerrësia tërthore minimale dhe standarte e segmenteve të drejta për largimin e ujrave për të gjitha kategoritë e rrugëve është $i_c = 2.5\%$.

Elementet e kullimit janë normalisht jashtë karrexhatës. Në dy anët e seksionit të rrugës janë parashikuar dy kanale anësore për kullimin dhe largimin e ujrave sipërfaqësore të rrugës dhe rrugës sekondare.

Ujërat e ndotura të bizneseve apo ambjenteve të tjera përreth autostradës nuk do shkarkojnë në kanalet e hapura por do të bëhet një kolektor i ri në anën e trotuarit të rrugës sekondare, km 0+000 ÷ km 4+000.

Bankina e veshur

Bankina e veshur është pjesë e rrugës e lirë nga çdo pengesë (sinjalistikë vertikale, barrierat, etj.) sipërfaqja e së cilës gjendet midis anës së karrexhatës dhe elementit gjatësor më të afërt si më poshtë:

Kemi 2 tipe të bankinës së veshur:

- Bankinë e veshur e jashtme – ka funksionin e hapësirës së lirë. Në rastin e autostradës kjo pjesë e seksionit është zëvendësuar nga korsa e emergjencës.
- Gjithashtu bankinë e veshur e brendshme që ka funksionin e hapësirës së lirë. Dimensioi i bankinës së veshur të brendshme duhet konsideruar si “e ndryshueshme” përgjatë gjurmës në kthesë, për shkak të zgjerimit për distancën e shikueshmërisë.

Gjerësia e trafik-ndarësit.

Gjerësia e trafik ndarësit është 2.6m distanca ku do vendosen dy trafik ndarësit prej betoni me një hapësirë bosh midis tyre dhe dy shirita prej 0.7m në secilen anë duke e bërë gjerësinë totale të trafik ndarësit 4.0m.




Figure 43 – Seksioni terthor tip i autostrades (0+000 deri ne Kashar Interchange)




Figure 44 – Seksioni terthor tip ne vije te drejte-mbushje i autostrades me H<5.00.




Figure 45 –Seksioni terthor tip ne zgjerim-mbushje i autostrades ne kthese




Figure 46 – Seksioni tip terthor ne germim i autostrades

Dimensionet e bankines se brendshme duhen konsideruar si te "ndryshueshme" pergjate gjurmes ne kthese, per shkak te zgjerimit per distancen e shikimit.

7.3.2 Skarpata anësore

Projektimi i skarpatave në mbushje ose gjermim është një kompromis midis estetikës, sigurisë, stabilitetit dhe ekonomisë.

After the calculated geotechnical stability of the slope, the side slopes in our project are 3H:2V which

Në zonat ku kemi skarpata në gjermime apo mbushje të mëdha qe kane impakt të madh në zonat përreth, ato do të realizohen mure mbajtës.

Po ashtu dhe në segmentet ku kemi banesa afër kuotes se projektit dhe ngjitur me autostraden do të ndërtohet mur mbajtës (te pajisur me barriera sigurie aty ku eshte e nevojshme).

7.3.3 Vendqendrimet anësore në rrugë

Një vendqëndrim anësor në rrugë është sipërfaqja e rrugës përkrah karrexhatës e caktuar për ndalimin e automjeteve.

Vendqendrimet i sherbejne sigurise rrugore pasi ato sigurojne nje vend te sigurte qe shoferet te ndalojne ne rast se ata deshirojne thjesht te shplodhen, kontrollojne drejtimet, te bejne nje telefonate ose nese mjete i tyre ka pesuar difekt.

Keto vendqendrimet ne ane te rruges kanë dimensione te njejta ose me te medha se ato te paraqitura me poshte. Ato duhet te vendosen ne intervale te tilla ne menyre qe te sigurojne qarkullim te sigurtë te trafikut afërsisht 1 km nga secili kah.




Figure 47 –Plani lay by i perdorur ne projekt




Figure 48 – Seksioni terthor tip ne perputhje me lay by e projektit

Sinjalizimi ne avance i mundeson shoferëve ne momentin e duhur qe te ndalojne ose jo ne nje vendqendrim, duke shmangur keshtu ndryshimet e menjehershme te drejtimit dhe shpejtesise. Ne mungese te sinjalistikës paraprake, rritet risku per marrjen e vendimit me vonese dhe hyrjen ne vendqendrim shume shpejt.

Nese sigurohen telefonatat e mergjences, duhen vendosur bordura me vijezim per te ndihmuar shoferet me nje paaftesi dhe faciliteti duhet te perputhet me Levizjen Gjitheperfishrese.

Kompanite telefonike duhen ftuar te instalojne kabina me telefona publike ne vendqendrimet ne rrugët qe anashkalojne qytetet dhe fshatrat dhe ne lokalitetet e largeta ku nuk ekzistojne facilitete alternative. Ne kendveshtrimin e minimizimit te kostove te kanaleve, ato duhet te vendosen ne te njejten kohe me ndertimin e vendqendrimëve ne menyre qe te shmangen punimet e kushtueshme ne nje faze te mevonshme. Aty ku jane vendosur telefonat dhe ka vendqendrimet ne dy anet e rruges afer njeri – tjetrit, ato duhen instaluar ne te dy vendqendrimet, keshtu qe shoferet nuk kane nevoje te kapercejne rrugen per te arritur te njeri.

n.	Durres Direction		Tirane Direction	
	Start chainage	End chainage	Start chainage	End chainage
1	1+000.00	1+065.00	1+065.00	1+000.00
2	2+000.00	2+065.00	-	-
3	3+000.00	3+065.00	3+065.00	3+000.00

Table 19 – Lista e zonave Lay BY

7.4 Permbledhje e kritereve kryesore

Elementet e Projektimit	Karakteristikat kryesore
Shpejtesia e Projektimit [km/h]	90 – 140
Rrezja minimale ne plan [m]	340
Pjerresia vertikale maksimale [%]	5.00
Numri i korsive	3 X 3
Gjeresia e korsise [m]	3.75
Tipi i trafik ndaresit qendror	Ndarese betoni me dy linja barrierash
Gjeresia e trafik-ndaresit qendror [m]	2.60
Gjeresia e bankines se brendshme (Dimensioni i bankines se brendshme duhet te konsiderohet si “variabel” ne gjurmen ne kthese, per shkak te zgjerimit te distances se pamshmerise [m])	0.70
Gjeresia e korsise se emergjences [m]	3.00
Gjeresia e pragut [m]	1.30
Pjerresi transversale [%]	2.50
Mbilartesimi maksimal [%]	7
Lartesia maksimale e mbilartesimit pa muret mbajtese [m]	5.00
Pjerresia e mbushjes	2V:3H

Table 20 – Kriteret kryesore te projektimit

7.5 Rruget kryesore sekondare dhe rruget sekondare

7.5.1 Te pergjithshme

Per te minimizuar sa me shume qe eshte e mundur ndikimin negativ social qe mund te kete zgjerimi i autostrades Tirane-Durres, konsulenti ka studiuar me kujdes rrjetin ekzistues te te gjitha rrugeve qe nderpriten nga autostrada e re. Bazuar ne gjendjen ekzistuese te rrjetit rrugor ekzistues ne zonen qe kryqezohet nga zgjerimi i gjurmes, standartet e reja shqiptare ne projektimin e rrugeve nacionale (VKM Nr. 628, date 15.07.20150), Standartin KTP 2001 per rruget bujqesore dhe gjithashtu ne eksperiencen e tij, Konsulenti beri ndarjen e rrugeve qe nderpriten nga autostrada e re:

Në projektin e propozuar Konsulenti ka parashikuar gjithashtu disa rruge sekondare per te asistuar nderhyrjet e propozuara ne terma te funksionalitetit te trafikut dhe levizjes se pergjithshme te perdoruesve rrugore ne zonat e prekura, per ato nuk jane vete pjese e nderhyrjes.

Pjesa me e madhe e rrugeve sekondare të propozuara për tu realizuar në segmente të caktuara janë klasifikuar si rrugë të kategorisë F2. Shpejtësia e projektimit e konsideruar në këtë fazë të projekt idesë jane konsideruar:

- 40-60 km/h per seksionet urbane
- 25-100 km/h per seksionet interurbane

7.5.2 Lista e Rrugeve kryesore sekondare dhe sekondare

N.	WBS	Description	Direction	Start Chainage	End Chainage	Length (m)	Typical Cross Section
LOT 1							
1	MS01	Main Secondary Road near Kastrati Gas Station	Tirane	1+850	2+375	520,00	-

Tabele 21 – Lista e Rrugeve kryesore sekondare dhe sekondare

7.5.3 Rruga sekondare e Kastratit , MS01

Ndermjet progresives 1+850 dhe 2+375, prane pikes se karburantit Kastrati, ne drejtim te Tiranes propozohet rehabilitimi i rruges sekondare qe do te sherbeje si akses per shtepite e banimit dhe bizneset, prezente ne kete pjese te rruges.

Seksioni terthor tip i kesaj rruge sekondare nuk mund te jete sipas standarteve, per faktin se pas zgjerimit te rruges Tirane-Durres, mbetet vetem nje hapesire e limituar ne dispozicion me gjeresi 6,00m per korsite dhe 0.50m per bankinen e djathte.

Kjo rruge sekondare do te lidhet si ne fillim ashtu edhe ne fund me rrugen sekondare ekzistuese, te perfunduar me sinjalistiken e nevojshme rrugore.




Figure 49 – Plan i rruges sekondare MS01 (drejtimi Tirane) km 2+100

Shpejtesia e projektuar per kete aks eshte 40 km/ore. Gjatesia totale e kesaj nderhyrje eshte L=520 m




Figure 50– Seksioni terthor tip i rruges sekondare MS01

8 SHITESAT RRUGORE

8.1 Objekti

Qëllimi i këtij relacioni është llogaritja e paketës së shtresave rrugore (dyshemese) në përputhje me metodat llogaritëse të njohura e të percaktuara në standartet e miratuara të projektimit të rrugëve, si dhe në funksion të rezultateve të studimit gjeologjik dhe të dhënave të perspektives së trafikut mbi këtë aks.

Për të përmirësuar projektin e zgjerimit, janë vlerësuar gjithashtu kushtet e gjendjes ekzistuese të shtresave të rruges Tirane-Durres, duke marrë në konsideratë sforcimet dhe parregullsitë në percaktimin e detajeve të ndërtimit të shtresave.

Projektimi i shtresave rrugore do të jetë procesi i zhvillimit të kombinimit më ekonomik të shtresave të dyshemesë rrugore, në funksion të trashësisë dhe llojit të materialit, për të mbrojtur themelin e dheut nga ngarkesa akumuluese të qarkullimit që pritet të mbahet gjatë periudhës për të cilën projektohet rruga.

Objektivat e procesit të projektimit të dyshemëve janë të ofrojë:

- Shtresa të cilat janë të afta të mbartin ngarkesa trafiku me konsumim fizik sa më të vogël
- Siguri sa më të lartë
- Një drejtim mjeti sa më të rehatshëm.

8.2 Vlerësimi i gjendjes së shtresave ekzistuese

Ky seksion ekzaminon gjendjen fizike të autostrades Tirane – Durres, lidhur me gjendjen e sipërfaqes dhe masën e tjera.

Normat e gjendjes së shtresave të prezantuara në këtë seksion janë nxjerre nga Indeksi Nderkombëtar I Ashpersise (IRI). Vlerat e IRI janë bazuar në masat objektive të ashpersise së shtresave dhe devijimet kumulative nga sipërfaqet e lemuara.

Indeksi Nderkombëtar i Ashpersise është:

- Një shkallë e pranuar ndërkombëtarisht për ashpersinë
- E vendosur nëpërmjet sigurimit të një mase të saktë të profilit të rruges, që procesohet nëpërmjet një algoritmi që simulon mënyrën sesi një mjet referencë do të përgjigjej inputeve të ashpersise dhe akumulimit të ndërprerjes së udhëtimit.
- Përcaktohet si pjesë e profilit të vertetë dhe mund të matet me një profiler të vlefshëm
- Korrelohet nëpërmjet tre variabla të mjetit: përgjigja e metrit rrugor, ngarkesës së gomave, përsheptimit vertikal të pasagjerëve.

IRI është reagimi i llogaritës i një mjeti ndaj profilit të rruges. Ai reflekton levizjen e shasisë dhe konsideron efektet e defekteve të mjeteve, të cilat mund të zbusin levizjen vertikale të rrotave, ose në disa raste mund të amplifikojnë levizjet.

Qe nga prezantimi i tij ne vitin 1986, standarti IRI eshte perdorur gjeresisht ne bote per vleresimin dhe menaxhimin e sistemeve rrugore. Megjithate, matja e ashpersise rrugore eshte perdorur qe ne vitet 1900 per shprehjen e kushteve te rruges dhe cilesise se saj.

Bazuar ne filmimet HD te xhiruara ne te gjithe segmentet e autostrades me referenca te pastra ne progresiva (cdo 0,50km), gjendja aktuale e shtresave eshte vleresuar vizualisht. Kjo analize eshte realizuar cdo 100m nen-seksione te grupuara me pas mesatarisht ne 0,50km segmente per te vleresuar nevojat potenciale te REPEX. Kjo metodologji na ka lejuar neve te vleresojme kushtet e gatishmerise aktuale te korsive te trafikut, duke na siguruar me pas me gjykime te krahasueshme te IRI te cilet konsiderojne te gjithe elementet qr prekin nivelin e sherbimeve te ofruara nga shtresat; vibrimet e regjistruara ne survejimin e mjeteve, prezencen/zgjatjen e mbushjeve te gropave, te carave, deformimeve etj.

Eshte interesante te theksohet fakti, se nga kjo metodologji eshte e mundur te percaktohet me nje nivel te pranueshem besueshmerie vlera operative e mbetur e shtresave, duke marre ne konsiderate kombinimin e forcave qe ushtrohen mbi rruge, frekuencen dhe zgjatjen e tyre, moshen e shtresave, aktivitetet e meparshme te mirembajtjes, ngarkesat e trafikut (trendet e meparshme dhe te ardhshme) etj.

Pas kesaj, gjendja aktuale e shtresave eshte vleresuar, ndersa sjellja e tyre e mundshme ne te ardhmen eshte simuluar duke siguruar cikle te ndryshme mirembajtjeje dhe lloje te ndryshme nderhyrjeje per korsite e trafikut me shpejtesi te ulet dhe te larte si edhe rampa te kryqezimit (te ndara per nyjet dhe kryqezimet e superstrades). Per ta realizuar kete, karakteristikat e flukseve te trafikut (bazuar ne AADT dhe pjesen qe zene mjetet e renda) jane marre parasysh se bashku me efektet (ne kendveshtrimin e zgjatjes se jetes operative) te cdo lloj nderhyrjeje.

Per analizen eshte zgjedhur propozimi i Materialit Teknik te Bankes Boterore Nr. 46 „Udhezime per Ndertimin dhe Kalibrimin e Matjeve te Ashpersise se Rruges“

Ne lidhje me funksionalitetin dhe nivelin e sherbimit te shtresave, ashpersia perfaqeson nje faktor te rendesishem por duhet shoqeruar me vleresim strukturor. Per kete arsye, per te vleresuar vlerat e uljes se shtresave nga ngarkesta e trafikut jane prezantuar rezultatet e testeve me traun Benkelman.

8.3 Gjendja e Asetit Rrugor

Ekspozimi i vazhdueshem ndaj kushteve mjedisore luan nje rol domethenes ne amortizimin e vazhdueshem te shtresave. Volumet e larta te trafikut dhe rritjet e vazhdueshme ne volume e mjeteve te rend ate trafikut kontribuojne gjithashtu ne amortizimin e shtresave.

Ky seksion ekzaminon gjendjen fizike te autostrades Tirane – Durres, lidhur me gjendjen e siperfaqes dhe masa te tjera.

Normat e gjendjes se shtresave te prezantuara ne kete seksion jane nxjerre nga Indeksi Nderkombetar I Ashpersise (IRI). Vlerat e IRI jane bazuar ne masat objective te ashpersise se shtresave dhe devijimet kumulative nga siperfaqet e lemuara.

Indeksi Nderkombetar i Ashpersise eshte:

- Nje shkalle e pranuar nderkombetarisht per ashpersine
- E vendosur nepermjet sigurimit te nje mase te sakte te profilit te rruges, qe procesohet nepermjet nje algoritmi qe simulon menyren sesi nje mjet reference do ti pergjigjej inputeve te ashpersise dhe akumulimit te nderprerjes se udhetimit.
- Percaktohet si pjese e profilit te vertete dhe mund te matet me nje profiler te vlefshem
- Korrelohet nepermjet tre variablave te mjetit: pergjigjja e metrit rrugore, ngarkeses se gomave, persheptimit vertical te pasagjereve.

IRI eshte reagimi i llogaritur i nje mjetei ndaj profilit te rruges. Ai reflekton levizjen e shasisë dhe konsideron efektet e defekteve te mjeteve, te cilet mund te zbusin levizjen vertikale te rrotave, ose ne disa raste mund te amplifikojne levizjet.

Qe nga prezantimi i tij ne vitin 1986, standarti IRI eshte perdorur gjeresisht ne bote per vleresimin dhe menaxhimin e sistemeve rrugore. Megjithate, matja e ashpersise rrugore eshte perdorur qe ne vitet 1900 per shprehjen e kushteve te rruges dhe cilesise se saj.

Nje vleresim i plote dhe i detajuar i kushteve aktuale te te gjitha shtresave eshte bere nga Konsulenti ne 17 Shtator 2015 per korsine e ngadalesimit gjate gjithe gjatesise se saj (ne te dy drejtimet) per te gjithe rrjetin ne studim.

Bazuar ne filmimet HD te xhiruara ne te gjithe segmentet e autostrades me referenca te pastra ne progresiva (cdo 0,50km), gjendja aktuale e shtresave eshte vleresuar vizualisht. Kjo analize eshte realizuar cdo 100m nen-seksione te grupuara me pas mesatarisht ne 0,50km segmente per te vleresuar nevojat potenciale te REPEX. Kjo metodologji na ka lejuar neve te vleresojme kushtet e gatishmerise aktuale te korsive te trafikut, duke na siguruar me pas me gjykime te krahasueshme te IRI te cilet konsiderojne te gjithe elementet qe prekin nivelin e sherbimeve te ofruara nga shtresat; vibrimet e regjistruara ne survejimin e mjeteve, prezencen/zgjatjen e mbushjeve te gropave, te carave, deformimeve etj.

Eshte interesante te theksohet fakti, se nga kjo metodologji eshte e mundur te percaktohet me nje nivel te pranueshem besueshmerie vlera operative e mbetur e shtresave, duke marre ne konsiderate kombinimin e forcave qe ushtrohen mbi rruge, frekuencen dhe zgjatjen e tyre, moshen e shtresave, aktivitetet e meparshme te mirembajtjes, ngarkesat e trafikut (trendet e meparshme dhe te ardhshme) etj.

Pas kesaj, gjendja aktuale e shtresave eshte vleresuar, ndersa sjellja e tyre e mundshme ne te ardhmen eshte simuluar duke siguruar cikle te ndryshme mirembajtjeje dhe lloje te ndryshme nderhyrjeje per korsite e trafikut me shpejtesi te ulet dhe te larte si edhe rampa te kryqezimit (te ndara per nyjet dhe kryqezimet e superstrades). Per ta realizuar kete, karakteristikat e flukseve te trafikut (bazuar ne AADT dhe pjesen qe zene mjetet e renda) jane marre parasysh se bashku me efektet (ne kendveshtrimin e zgjatjes se jetes operative) te cdo lloj nderhyrjeje.

Per analizen eshte zgjedhur propozimi i Materialit Teknik te Bankes Boterore Nr. 46 „Udhetime per Ndertimin dhe Kalibrimin e Matjeve te Ashpersise se Rruges“

Ne lidhje me funksionalitetin dhe nivelin e sherbimit te shtresave, ashpersia perfaqeson nje faktor te rendesishem por duhet shoqeruar me vleresim strukturor. Per kete arsye, per te vleresuar vlerat e uljes se shtresave nga ngarkesta e trafikut jane prezantuar rezultatet e testeve me traun Benkelman.

8.3.1 Vleresimi i amortizimit




Nepermjet vleresimit dhe kombinimit te forcave qe ushtrohen mbi rrugen (atyre siperfaqesore qe prekin me se shumti gatishmerine, rehatine dhe aderimin si edhe atyre te thella qe ndikojne me se shumti ne forcen strukturore dhe jeten operative te mbetur) u be e mundur te vleresohej niveli aktual i prishjes se shtresave ne nje korsi specifike ne nen-segmentitn specifik, si edhe jeta e mbetur dhe plani sipas llojit te nderhyrjes.

Llojet	carje	deformime	gropa	riparimet dhe mirembajtjet e meparshme
Shtirija Cilesore	gjeresia	thellesia	diameter	siperfaqja
Frekuenca Cilesore	Zona %	gjatesia	n°/km	n°/km

Tabele 22 – Vleresimi i amortizimit

Jane marre ne konsiderate 3 nivele demi per te siguruar nje pamje te gjendes se shtresave per sa i perket demeve strukturore dhe rregullsise se siperfaqes si ne shembullin e paraqitur ne tabelen e meposhtme.

**Komponenti i prekur : Rregullsia e Siperfaqes
Lloji I amortizimit: Deformimi**

	<p>Niveli I Demit:</p> <p style="text-align: right;">-</p> <p style="text-align: center;">↓</p> <p>Gjendja e Shtreses:</p> <p style="text-align: right;">-</p>
	<p>Niveli I Demit:</p> <p style="text-align: center;">Shkaterrim I Mesem-</p> <p style="text-align: center;">↓</p> <p>Gjendja e Shtreses:</p> <p style="text-align: center;">Gjendje e Varfer-</p>
	<p>Niveli I Demit:</p> <p style="text-align: center;">Shkaterrim I Ulet-</p> <p style="text-align: center;">↓</p> <p>Gjendja e Shtreses:</p> <p style="text-align: center;">Gjendje e Mire-</p>


(Burimi: Databaza e Konsulentit)

Tabele 23- Shembull i katalogut te amortizimeve

Nepermjet vleresimit dhe kombinimit te forcave qe ushtrohen mbi rrugen (atyre siperfaqesore qe prekin me se shumti gatishmerine, rehatine dhe aderimin si edhe atyre te thella qe ndikojne me se shumti ne forcen strukurore dhe jeten operative te mbetur) u be e mundur te vleresohej niveli aktual I prishjes se shtresave ne nje korsi specifike ne nen-segmentitn specifik, si edhe jeta e mbetur dhe plani sipas llojit te nderhyrjes

Ky lloj gjykimi mund te lidhet me nje interval indikativ te IRI ne momentin qe studion llojet e amortizimit qe prekin rregullsin e siperfaqes psh (deformime, prishje e siperfaqes, te cara etj).

- Gjendje e Keqe → IRI ≥ 5
- Gjendje e Varfer → 4 < IRI < 5
- Gjendje e Mire → 3 < IRI < 4



(Source: Consultant's site survey picture)

Figure 51 – Carjet ne pjesen kaluese te gomave qartesisht te zbuluara ne kushtet e siperfaqes se lagur –




Table 24 – Diagrama e perqesimit ne perputhje gjithashtu me ate te Bankes Boterore

Pas kryerjes se inspektimeve vizuale si dhe perdorimit te pajisjeve rlevuese per regjistrimin e IRI, te dhenat e mbledhura u perpunuan ne perputhje me nivelet e Bankes Boterore. Me kete proces, Konsulenti ishte ne gjendje te vleresonte sasine e demeve te shtresave ekzistuese.

Tabela e meposhtme paraqet rezultatet e analizave.

Project Ch.	Ti-Du	Du-Ti
0-500	3,5	3,5
500-1,000	3,5	3,5
1,000-1,500	3,5	3,5
1,500-2,000	3,5	3,5
2,000-2,500	3,5	3,5
2,500-3,000	3,5	3,5
3,000-3,500	3,5	3,5

Table 25 – Rezultatet e analizave

3.0 - 4.0	4.0 - 5.0	≥5
low	mid	high





Table 26 - Rezultatet e vleresimit statistikor te gjendjes ekzistuese te shtresave ne autostraden Tirane-Durres (drejtimi Durres)



Tabele 27 – Rezultatet e vleresimit statistikor te gjendjes ekzistuese te shtresave ne autostraden Tirane-Durres (drejtimi Tirane)

8.3.2 Vezhgimi Vizual

Inspektimi vizual ka për qëllim vlerësimin e gjendjes fizike të sipërfaqes asfaltike, nëpërmjet evidentimit të defekteve sipërfaqësore, pozicionimit dhe tipologjisë e tyre. Gjatë inspektimit vizual defektet në sipërfaqen asfaltike sipas tipologjisë grupohen në dy grupe kryesore:

- 1-Çarje gjtësore e tërthore në formen e rretës së merimanges apo lekures së krokodilit
- 2-Kanaleta (ulluqe) përgjatë gjurmes së gomave të automjeteve

Konkluzionet e arritura lidhur me origjinën e shkaqeve të defekteve për çdo tipologji (2.1, 2.2), janë rezultat i ndërthurjes së inspektimit vizual me provat jo-destruktive (Trau Benkelman), gropave (test-pits) si dhe analizave laboratorike të kryera mbi kampionet e mara nga keto punime për shtresat rrugore dhe bazamentin natyral.

Kujtojmë se keto tipologji të defekte sipërfaqësore janë hasur dhe në vitin 2008 nga grupi i punës për hartimin e projektit për përmirësimin e gjendjes së Superstrades Tiranë-Durrës.

Bazuar në tipologji e defekteve lartpërmendur, arrijme në përfundimin:

- Struktura rrugore paraqitet e “lodhur” dhe në disa raste ka humbur aftësinë e saj mbajtëse si rezultat i ngarkesave të trafikut;
- Shtresa e nënthemelit (rërë-shtuf) me parametrat e saj të Modulit të deformimit dhe kapacitetit mbajtës e vendosur shume afer me sipërfaqen (vetem 55-65 cm nga shtresa fleksibel) nuk mund të përballoje ngarkesën e trafikut;

Rishfaqja e së njëjtës tipologji defektesh dhe pas riveshjes së superstrades, tregon se kjo menyre ndërhyrje nuk ripërtërin integritetin strukturor të paketës rrugore.

Aksi rrugor Tiranë-Durrës me problematiken analizuar me sipër, mendojmë se ka nevojë për një ndërhyrje strukturale, e cila do të ishte zgjidhja me e drejtë dhe afatgjatë.

8.3.3 Testi Benkelman

Defleksioni i matur nëpërmjet provës jo-destruktive me traun Benkelman jep mundësinë e vlerësimit të gjëndjes së strukturës rrugore, pasi vlerat e defleksionit të matur në sipërfaqen e rrugës janë përgjigja, që struktura rrugore me parametrat e saj i bën ngarkesës së trafikut.

Procedura e ketij testi ben matjen e deformimit te shtresave te asfaltit nen nje ngarkese dhe presion standart te gomave, me ose pa matje te temperatures.

Referuar literaturës si dhe specifikimeve teknike të kontratave të ndryshme për rrugët nacionale, një vlerë deri në 500 µm (0.5 mm) e defleksionit në sipërfaqen e një rruge të përfunduar, e klasifikon atë si një përgjigje pozitive, që struktura e paketës rrugore i paraqet ngarkesës së trafikut.

Vlerat e defleksionit të matura në këtë drejtim karakterizohen nga një luhatje e konsiderueshme e madhësisë së vlerave sikundër pasqyrohen në tabelën më poshtë.

Vlerat e defleksionit (µm)	Përqindja kundrejt totalit të matjeve (%)
500 - 600	13
600 – 800	24.1
800 – 1000	27.6
>1000	34.5

Tabele 28 – Uljet e matura – drejtimi Durres

Referuar tabelës vërehet se struktura rrugore paraqet një trend luhatjesh domethënëse të vetive të saj mekanike. Në zonat ku vlerat e defleksionit luhaten nga 600 – 800 µm gjëndja e strukturës konsiderohet me një ecuri të saj drejt lodhjes, ndersa në zonat ku defleksioni është më i madh se 800 µm, struktura tashmë është tejte e lodhur dhe ka humbur integritetin e saj struktural (87% e rezultateve kanë vlerë defleksioni më të madh se 600 µm)

Në këtë drejtim të karrexhatës nuk vërehet ndonjë luhatje e theksuar e vlerave të defleksionit.

Deflection value (μm)	Percentage to the total value (%)
<500	41
500 – 600	45.4
>600	13.6

Tabele 29 – Uljet e matura – drejtimi Tirane

Vlerat e defleksionit më të vogla se 500 μm flasin për një integritet pozitiv të strukturës rrugore. Vlerat e defleksionit mbi 500 μm tregojnë se struktura ka filluar të shfaqë lodhje, e cila reflektohet më qartë në ato progresivë ku vlera e defleksionit kalon kufijtë e 600 μm .

Nga sa më sipër, rezulton se kjo karrexhatë krahasuar me atë Tiranë - Durrës, paraqet një gjëndje më pozitive, por degradimi i integritetit të saj është çështje kohe.

8.4 Llogaritja e Paketës së Shtresave

8.4.1 Struktura e shtresave rrugore të autostrades

Struktura e propozuar e shtresave të autostrades ka një trashësi totale prej 84 cm dhe përbëhet nga

- tapet drenant me binder të modifikuar (4 cm);
- shtresa e binderit (5 cm);
- shtresa e bazës asfaltike (20 cm);
- shtresa e bazës prej cimento të lidhur (25 cm);
- shtresa e nen-bazës prej çakelli të palidhur (30 cm);




Figure 52 – Struktura e shtresave të autostrades

8.4.2 Te dhenat hyrese

Për të verifikuar strukturën e propozuar të shtresave me metodën racionale, nevojitet futja e të dhënave të mëposhtme:

- fortësia e bazamentit të dheut;
- karakteristikat mekanike të materialeve të përdorura në shtresat e rrugës;
- temperatura e ajrit në zonën e projektit;
- ngarkesat e pritshme të trafikut të rëndë gjatë plan veprimeve të projektit.

Ne tabelen e meposhtme jane permbledhur te dhenat e perdorura ne analizen e shtresave.

	Material	Thickness [cm]	E [Mpa]	v
Wearing course	HMA	4	var	0,35
Binder course	HMA	5	var	0,35
Base course	HMA	20	var	0,35
Base course	Cement bound	25	2700	0,25
Sub-base course	Granular	30	322	0,4
Subgrade	-	-	120	0,4

Number of axle loads	80 kN/month	226562
-----------------------------	----------------	--------

Tabele 30 – Futja e te dhenave per projektimin e shtresave

Lodhja e shtresave te asfaltit lidhet direkt me tendosjen zhvendosese ne tabanin e shtresave ndersa zgjerimi i vijave / brazdave lidhet me deformimin vertikal ne pjesen e sipërme te bazamentit te dheut. Realizimi i gjendjes perfundimtare te struktures se shtresave ne lidhje me demtimin ka te beje me 20% te sipërfaqes se zones se fraktuar dhe nje thellesi vije/brazde prej 1,27 cm.

Ligji i lodhjes se shtresave te asfaltit merr parasysh karakteristikat volumetrike te seciles perzierje; ajo con ne percaktimin e koeficienteve te ndryshem ne analizen e lodhjes.

Programi kompjuterik i perdorur per projektimin eshte KENLAYER 2.0 [8]. Trafiku, i shprehur si numer i perseritjeve te 80kN per aks, eshte prezantuar duke supozuar nje zone rrethore te gjurmes se gomes me rreze kontakti prej 8,92 cm dhe presion kontakti 800 kPa dhe nje distance terthore ndermjet 2 gomave prej 31,5 cm

Duke perdorur kriterin e demtimit te pershkruar me pare, ligji i Miner eshte perdorur per akumulimin e demit linear. Ligji shprehet si me poshte:

$$D = \sum_{i=1}^F \frac{n_i}{N_i}$$

ku:

n_i eshte numri i pasazheve i aksit ekuivalent gjate jetegjatesise se projektit

N_i eshte numri i perseritjes se ngarkeses ekuivalente qe shtresa e rruges mund te suportojte perpara se te demtohet
Rezultatet e analizes se shtresave jepet ne Shtojcen D.

Ne Tabelen 2 keto rezultate permbledhen si:

- **Demtimi elementar** ne secilin muaj te vitit;
- **Demtimi permbledhes**, i perftuar si shume algjebrike e demtimeve elementare;
- **Jetegjatesia e projektit**, qe korrespondon me numrin e viteve qe nevojiten per te ndodhur demtimi.

Month	i-th damage
1	8,03E-04
2	8,88E-04
3	1,13E-03
4	1,77E-03
5	3,36E-03
6	6,96E-03
7	1,26E-02

8	1,17E-02
9	5,69E-03
10	2,52E-03
11	1,40E-03
12	9,46E-04
Σ	0,04971
Design life	20,12

Tabele 31 – Rezultatet e analizës strukturore

Sipas rezultateve, struktura e propozuar e shtresave verifikohet qe jetegjatesia e priturb te jete me e larte se jetegjatesia e supozuar prej 20 vjetesh e projektit.

8.4.3 Projekti i shtresave rrugore ne rruget sekondare

Per rruget sekondare qe i sherbejne autostrades, jane propozuar dy struktura shtresash te ndryshme me synimin per te ndryshuar aftesine mbajtese te struktures sipas trafikut te pritshem

Struktura e propozuar e shtresave perbehet nga:

- Tapeti (4 cm);
- Shtresa e binderit (5 cm);
- Shtresa e bazes asfaltike (15 cm);
- shtresa e bazes prej cimento te lidhur (25 cm);
- Shtresa e nen-bazes granulare (20 cm).).




Figure 53 – Struktura e shtresave te rrugëve sekondare

Kjo zgjedhje lidhet me domosdoshmerine per te siguruar nje pakete shtresash qe eshte ne gjendje te siguroje nje aftesi mbajtese te pershtatshme kundrejt volumit te trafikut. Megjithese ne fakt, te dhenat e trafikut mungojne. Pritshmerite jane qe te gjithë automjetet e zonave te biznesit perreth te konvergjojne ne kete rrjet sekondar.

Per te kuptuar me mire numrin e perseritjes se ngarkeses qe eshte ne gjendje te mbaje struktura e propozuar e shtresave perpara se te arrije nivelin perfundimtar te sherbimit, eshte perdorur programi kompjuterik Kenlayer per llogaritjen e ngarkeses per aks (80 kN/muaj) qe i korespondon nje jetegjatesie 20 vjecare te projektit.

Karakteristikat e materialeve dhe fortesia e bazamentit te dheut, qe jane perdorur si te dhena per llogaritje, permblidhen ne tabelen e meposhtme.

	Material	Thickness [cm]	E [Mpa]	v
Wearing course	HMA	4	var	0,35
Binder course	HMA	5	var	0,35
Base course	HMA	15	var	0,35
Base course	Cement bound	25	3000	0,25
Sub-base course	Granular	20	178	0,4
Subgrade	-	-	80	0,4

Tabele 32 – Futja e te dhenave per projektimin e shtresave – rruget sekondare

Per nje numer te njejte te ngarkesave “standarde” (80 kN) per muaj prej 104.000, jetegjatesia e shtresave te propozuara eshte e barabarte me 20 vjet.

Kjo perseritje e ngarkeses per muaj korrespondon me ngarkese per aks ne 20 vjet te barabarte me 24.960.000.

Duke supozuar nje faktor ekuivalence prej 2,5 dhe koeficient reduktues te trafikut prej 50% ne korsine e projektuar, eshte e mundur te llogaritet trafiku mesatar ditor duke perdorur procesin e kundert te analizes se trafikut te pershkruar ne projektin e shtresave te autostrades.

Sic pershkruhet ne tabelen e meposhtme, trafiku mesatar ditor qe sigurohet nga struktura e propozuar e shtresave eshte 2773 auto/dite.

ESAL design life	80 kN	24960000
Number of axle loads	80 kN/month	104000
Equivalence factor		2,5
Reduction design direction	%	50%
Average daily traffic	veh/day	2773

Tabele 33 – Trafiku mesatar ditor i vleresuar – rruget sekondare

Struktura e pashtuar perbehet nga:

- Baza Granulare (20 cm);
- Nen-baza Granulare (30 cm).




Figure 54 – Struktura e shtresave te rrugeve sekondare

8.4.4 Struktura te tjera shtresash

8.4.5 Struktura e shtresave nen ndaresin e trafikut

Nen ndaresin e trafikut, shtresat e propozuara jane:

- Tapeti, open graded, me binder te modifikuar (4 cm);
- Shtresa e binderit (5 cm);
- Shtresa e bazes granulare (15 cm).




Figure 55 – Shtresat nen ndaresin e trafikut

8.4.6 Shtresat direkt mbi struktura

Per shtresat direkt mbi struktura (psh mbi viadukte, ura ose nenkalime), struktura perbehet si me poshte:

- Tapeti, open graded, me binder te modifikuar (4 cm);
- Shtresa e binderit asfaltik (5 cm).



Figure 56 – Shtresat ne ura dhe viadukte

8.5 Detajet e ndertimit

Ne perputhje me vleresimin e gjendjes se shtresave ekzistuese te cituar ne kapitullin e meparshem, ne disa raste aktivitetet ndertimore kane ndryshuar.

Ne figuren e meposhtme tregohen rastet e identifikuara dhe perskrimi perkates

PAVEMENT DETAILS		DESCRIPTION
CASE 1A-1B		<p>CASE 1A -CONSTRUCTION OF THE NEW PAVEMENT STRUCTURE (H=84cm)</p> <p>CASE 1B MILLING OF ALL THE EXISTING LAYERS AND RECONSTRUCTION OF THE NEW PAVEMENT STRUCTURE (H=84cm).</p>
		<p>CASE 2A -DEEP STRUCUTRAL INTERVENTION: 1. MILLING OF THE EXISTING HMA AND REMOVAL OF THE OTHER LAYERS UP TO THE REQUIRED HEIGHT. 2. CONSTRUCTION OF THE NEW PAVEMENT STRUCTURE (H=54cm)TILL THE CEMENT BOUND LAYER. THE CONSTRUCTION OF THE GRANULAR SUB-BASE BELOW IS RELATED TO THE LOAD CAPACITY OF THE UNDERLYING MATERIAL.</p>
CASE 2A		<p>CASE 2B -TRAFFIC SEPARATOR PAVEMENT PACKAGE: 1. MILLING OF THE EXISTING HMA 2. PREPARATION OF THE FOUNDATION WITH GRANULAR MATERIALS 3. CONSTRUCTION OF THE NEW PAVEMENT STRUCTURE (H=24cm)</p>
CASE 2B		<p>CASE 3 -MILLING OF THE EXISTING HMA -CONSTRUCTION OF THE NEW ASPHALT LAYERS (H=29 cm) -ASPHALT PADDING FOR CORRECTING PROFILE DEFICIENCIES IN THE EXISTING PAVEMENT</p>
CASE 3		<p>GRANULAR FILL FOR VARIABLE HEIGHT EMBANKMENT</p>

Figure 57 – Detajet e ndertimit

Rastet 1A dhe 1B lidhen me korsine e re te ngadalesimit ku pritet te kaloje gjithë trafiku i rende; rasti 2A lidhet me ish korsine e ngadalesimit ku eshte projektuar nje nderhyrje e thelle deri ne shtresen e cimentos se lidhur. Rasti 2B i referohet shtresave nen ndaresin e trafikut.

Rasti 3 aplikohet per korsine e parakalimit dhe perfshin bluarjen e shtreses asfaltike ekzistuese dhe mbushje me asfalt nese eshte e nevojshme.

Pikat e lidhjes ndermjet rasteve te ndryshme gjithashtu jane identifikuar dhe jane dhene detajet e ndertimit.




Figure 58 – Detajet e lidhjeve per ndertimin e shtresave

Per konfigurimin ne rruge te drejte dhe kthesa, jane cituar situata te ndryshme ne lidhje me ndryshimin ndermjet kuotes se projektit dhe lartesis se shtreses ekzistuese me qellim per te dhene nje pershkrim te sakte te ndertimit te shtresave. Alternativat e propozuara jane organizuar si me poshte:

- Alternative 1: Δ ngritje ndermjet projektit dhe shtreses ekzistuese $+9\text{cm} < < +29\text{cm}$;
- Alternative 2: Δ ngritje ndermjet projektit dhe shtreses ekzistuese $> 29\text{cm}$;
- Alternative 3: Δ ngritje ndermjet projektit dhe shtreses ekzistuese $< 9\text{cm}$;

Ne te dyja Alternativat 2 dhe 3, zgjidhja e propozuar eshte bluarja e struktures ekzistuese dhe rindertimi i paketes se re te shtresave, sic u prezantua me pare.

Vetem per Alternativen 1, aktivitetet e ndertimit ndryshojne nga korsa e parakalimit/korsa qendrore/korsa e kamioneve.

8.6 Riciklimi i RAE

Frezimi i shtresave ekzistuese të asfaltit në korsine e parakalimit dhe ne korsine ekzistuese të ngadaltë çon në krijimin e sasive të mëdha të materialeve asfaltike qe mund te ripërdoren në ndërtimin e shtresave rrugore në përqindje të ndryshme siç detajohet në S.T.

Procesi i frezimit eshte procesi i lidhur me skarifikimin e shtresave ekzistuese te rruges ,te cilat me pas hiqet dhe riciklohen per tu perdorur si agregat ne shtresat e reja rrugore.Per shtresat e asfaltit prodhimi i dale nga frezimi quhet riciklim i asfaltit ekzistues (RAE).

Riciklimit i asfaltit ekzistues (RAE) është një alternativë e dobishme për te siguruar materialet e duhura per pergatitjen e shtresave rrugore, sepse zvogëlon përdorimin e agregatit të pastër dhe sasinë e shtreses se binderit te kërkuar në prodhimin e HMA. Përdorimi i RAE-s gjithashtu ruan energjinë, siguron kosto të ulëta të transportit dhe ruan burimet.

RAE i prodhuar nga skarifikimi i shtresave ekzistuese të asfaltit, përpara ripërdorimit, duhet të grimsohet për të marrë përmasat e përshtatshme të agregateve duke marrë parasysh shpërndarjen granulometrike të kërkuar nga standardet teknike për prodhimin e përzierjes.

Përdorimi i RAE është i lejuar në shtresen e asfaltit drenant, në shtresen e binderit te konglomeratit dhe në shtresën e stabilizantit te lidhur me cemento, në përqindje të ndryshme:

Shtrese Asfalti → 20%;

Shtrese binderi →25%;

Shtrese konglomerati → 30%;

Stabilizanti i trajtuar me cemento → 50%.

Ripërdorimi i RAE nuk lejohet ne sipërfaqe te asfaltit drenant; nderkohe qe me një asfalt tradicional (jo drenant) lejohet perdorimi i një sasise deri ne prej 20%. Në këtë rast është e mundur të ripërdoren vetëm RAE-s që vjen nga skarifikimi i shtresave te asfaltit ekzistues (jo shtresat e binderit apo te bazes)

Me qëllim ripërdorimin maksimal të RAE-s, nga llogaritjet nxirren volumet e RAE të prodhuar nga shtresat ekzistuese (m3) dhe volumet e stabilizantit te trajtuar me cemento (m3). Analiza është e kufizuar në këtë shtresë me qëllim që të aplikohet përqindja më e lartë e lejuar (50%) e zëvendësimit të agregatit të pastër.

Në tabelën në vijim, të dhënat e disponueshme janë të organizuara dhe ndahen në sasite e Rruges Kryesore dhe ne sasite e Nyjeve ne Disnivel :

		LOTI 1	
		TR-DR	Nyje ne Disnivel
m ³	Frezim I shtresave ekzistuese te asfaltit	27138.75	1096.05
m ³	Stabilizant i trajtuar me cemento	76296,19	2439,05
m ³	Vlera totale RAE-s	28112,13	
m ³	Sasia e mundshme e RAE-s per Stabilizantin e trajtuar me cemento	38148,1	1219,525

Tabele 34 – Llogaritja e RAE

Siç përshkruhet në tabele, RAE në dispozicion është më i ulët sesa sasia e lejuar e zëvendësimit të agregatit në stabilizantin e trajtuar me cemento.

Për këtë arsye, rekomandohet që e gjithë sasia e derivuar nga RAE të përdoret vetëm në Rrugën Kryesore . Kjo korrespondon me një zëvendësim prej 37% të agregatëve virgjër në stabilizantin e trajtuar me cemento.

Per Nyjet ne Disnivel rekomandohet aplikimi i shtresave tradicionale te stabilizantit te trajtuar me cemento.

9 BARRIERAT E SIGURISE

9.1 Hyrje

Funksioni kryesor i barrieres se sigurise është të parandalojë depërtimin dhe të orientojë në mënyrë të sigurve një automjet të keq-drejtuar larg anës së rrugës ose rrezikut më të madh.

Barrierat e sigurisë dhe pajisjet e tjera kufizuese janë vendosur kryesisht për t'ju siguruar përdoruesve të rrugës si dhe të pranishmëve të mundshëm jashtë rrugë, kushte të pranueshme sigurie në lidhje me konfigurimin e rrugës, duke siguruar, brenda kufijve të caktuara, kontrollin e automjeteve që mund të tentojnë të dalin nga rruga.

Një element kyç i konceptit të një mjedisi miqësor në rrugë është krijimi i "zonave të pastra", në të cilin një drejtues mjeti mund të rikuperojë kontrollin e mjetit dhe ta kthejë atë përsëri në rrugë, ose së paku të arrijë ngadalësimin e duhur përpara goditjes së një objekti të caktuar. Kur pengesat fikse nuk mund të zhvendosen nga "zonat e pastra" ose të modifikohen në pjesë të shkëputura, duhet të merret në konsideratë mbrojtja e tyre, për të reduktuar peshën e ndikimit të tyre gjatë përplasjes së automjeteve me to.

Barrierat e sigurisë duhet të jenë të përshtatshme për të absorbuar një pjesë të energjisë gjatë lëvizjes së mjetit, duke siguruar njëkohësisht ndikimin e impaktit mbi pasagjerët.

Kostoja e përmirësimit të disa aspekteve shqetësuese të sigurisë rrugore mund të mos jetë e justifikuar nëse përfitimi i sjellë për sigurinë publike është i vogël. Barrierat e trafikut duhet të përdoren vetëm në rastet kur pasojat e përplasjes së mjetit me një objekt të caktuar ose pasojat e daljes nga rruga të mjetit do të jenë më të rënda se pasojat e goditjes me barrierën. Një faktor çelës për të vlerësuar se cilët elementë sigurie duhet të përmirësohen do të jetë historia e aksidenteve të ngjashëm të objektit të lidhur me objekte të tjera të ngjashëm.

Ka tre tipe kryesore të barrierave të sigurisë (por brenda këtyre tipeve ka sisteme të ndryshme të cilët kanë karakteristikat e veta specifike të performancës).

Barrierat fleksibel janë prej litarësh teli që mbahen përmes shtyllave të thyeshme. Barrierat fleksibel mund të jenë opsioni më i mirë për minimizimin e lëndimit të udhëtarëve në automjet. Megjithatë ato përbejnë rrezik për motorciklistet. Kjo barriera shmangen me shumë se tipet e tjera të barrierave dhe duhet të riparohen pas përplasjes për të mirëmbajtur aftësinë e tyre ri-drejtuese.

Barrierat gjysem të ngurta janë tipi që përdoret më gjerësisht në bote dhe zakonisht bëhen prej traversash ose binare celiku.

Kjo barriera punojnë nepermjet frenimit dhe ridrejtimin të automjeteve të dala jashtë kontrollit përmes kombinimit të perkuljes dhe tensionimit të traverses. Frenimi anësor sigurohet nga shtyllat. Ashtu si për të gjitha barrierat e sigurisë, gardhi mbrojtës kërkohej të kryejë rol të dyfishtë dhe ndryshues. Ai duhet të jetë në gjendje të ridrejtojë dhe/ose të frenojë një automjet që ka dalë jashtë kontrollit, nderkohe që në të njëjtën kohë, të mos imponojë forcë frenuese të patolerueshme mbi udhëtarët që gjenden në automjet.

Gardhi mbrojtës me traverse me profil W të bllokuar përbehet nga disa komponente, ku secili prej tyre luan një rol të rëndësishëm për funksionimin e suksesshëm të gardhit mbrojtës gjatë një përplasjeje.

Keto komponente janë:

- **Traversa me profil W:** kjo traverse hekuri duhet të jetë aq e fortë sa të përballojë tensionet elastike aksiale, si edhe tensionet perkuluese që zhvillohen ndërsa energjia kinetike e automjetit shpërndahet nepermjet shtremberimit dhe shkatërrimit të automjetit, traverses dhe dheut. Seksione të vecanta të traverses gjithashtu duhen lidhur në mënyrë të sigurve me pjesen tjetër dhe mbivendosur në drejtim të kundërt me lëvizjen e trafikut për të shmangur shkuljen.

- **Shtyllat** (dru ose hekur): i sigurojne qendrueshmeri te gjithe sistemit dhe mbajne traversen me profil W ne lartesine e duhur, si perpara ashtu edhe gjate perplasjes. Eshte jashtezakonisht e rendesishme qe shtyllat te jene vendosur ne largesine e duhur nga njera - tjetra dhe te kene lartesine e duhur, jo vetem mbi nivelin e tokes, por edhe nen toke gjithashtu.
- **Bllokuesit**: parandalojne shkuljen e shtyllave dhe ndihmojne per te shmangur rrokullisjen e makinave nepermjet forcave frenuese mbi qendren e gravitetit te automjetit.
- **Ankorimet**: jane esenciale per traversen me profil W per te treguar plotesisht forcen e saj elastike nepermjet dhenies se nje force frenuese ne te dyja anet.
- **Pjeset fundore**: inkorporojne traversat-W te prera, te cilat zhubrosen nese barriera eshte mberthyer ne fund, duke zvogeluar mundesine qe traversat te shpojne automjetin

Barrierat e ngurta behen zakonisht prej betoni dhe nuk shmangen. Barrierat e ngurta duhen perdorur vetem kur nuk mund te shmangen barrierat gjysem te ngurta dhe ato fleksibel.

Barrierat prej betoni qe derdhen ne vend ose ngulen ne shtresat e rruges dhe lidhen per te krijuar nje mur solid hyjne ne kategorine e barrierave te sigurise qe njihen si "te ngurta". Barrierat e ngurta nuk jane projektuar per tu prishur nga perplasia e nje automjeti te shkujdesur. Ato perdoren para se gjithash ne vendet ku levizja e barrierave mund te tolerohet pak ose aspak. (per shembull si barrierat mesore ne arteriet me ndarje te shpejtesise se larte). Disa barriera betoni te perkoheshme perdoren ne kantieret e ndertimit dhe keto mund te shmangen pak sepse jane te pafiksuara ne baze.

Barrierat e ngurta shpesh perdoren ne kantieret me volum te madh punimesh rrugore per te mbrojtur punetoret e rruges ose perdorues te tjere te rruges vecanerisht kur nje tip tjetere barriere do te riparohet. Aktualisht (ne varesi te lartesis se tyre dhe detajeve te tjera) keto sigurojne nivelin me te larte te kontrollit te automjeteve te renda. Ne shumicen e rasteve pas perplasjes keto barriera kerkojne pak ose aspak mirembajtje.

Ne projektin tone jane marre ne konsiderate barrierat gjysem te ngurta si mbrojtese ne ane te rruges dhe te ngurta si mbrojtese mesore.

Per me teper, tipi i ngurte do te perdoret per mbrojtjen e punimeve te kantierit gjate ndertimit.

Perfitimi me i madh nga perdorimi i barrierave vjen nga reduktimi i forces se perplasjes. Edhe pse perplasia ndodh, ajo ka te ngjare te kete pasoja me te lehta se perplasia me objektin qe mbrohet nga barriera.

Barrierat e sigurise jane te kushtueshme per tu instaluar dhe mirembajtur. Ato gjithashtu perbejne nje rrezik per automjetet e shkujdesur. Perdorimi dhe instalimi i tyre duhet te shqyrtohet gjithmone me kujdes dhe te kryhet sipas instruksioneve te prodhuesit.

9.2 Rregulla dhe Standarde

A1. Standardet e reja Shqiptare "Rregullorja e Re per Standardet e Projektimit/ Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve", VKM nr. 628, datë 15.07.2015

A2. "Kodi i Ri Rrugor" i Republikës së Shqipërisë 2017

Per shkak te mungeses se standarteve te vecanta shqiptare per projektin ne fjale, janë marrë në konsideratë standardet dhe rregulloret e meposhtme Italiane:

A3. Direktiva e Ministrisë Italiane të Infrastrukturës dhe Transportit, nr. 3065 të datës 25.08.2004 "Direktiva mbi kriteret e projektimit, instalimit, testimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve mbrojtëse gjatë ndërtimit të rrugëve".

- A4. D.M. e datës 21 Qershor 2004 (Fletorja Zyrtare, nr. 182, datë 05.08.04) "Përmirësimi I Instruksioneve teknike për projektimin, aprovimin dhe përdorimin e barrierave të sigurisë rrugore dhe specifikimeve teknike për testimin e barrierave të sigurisë rrugore".
- A5. D.M. e datës 18 Shkurt 1992, nr. 223. (Fletorja Zyrtare, nr. 63, datë 16.03.92) "Rregullat e Instruksioneve teknike për projektimin, aprovimin dhe përdorimin e barrierave të sigurisë rrugore".
- A6. D.P.R. nr. 495/92 e s.m.i. "Rregullat e zbatimit dhe implementimit të Kodit të Ri Rrugor".
- A7. Rregullore e Ministrisë së Transportit e datës 15.11.2007 "Skadimi I vlefshmërisë së rregulloreve të miratimit të barrierave të sigurisë para D.M. të datës 21.06.2004".
- A8. Udhëzim I Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, i datës 21.07.2010 "Njëjësimi I rregullave mbi projektimin, aprovimin dhe përdorimin e pajisjeve mbrojtëse gjatë ndërtimit të rrugëve".
- A9. Standardi UNI EN 1317 "Barrierat e Sigurisë Rrugore":
- UNI EN 1317-1:2010: " Sistemet Mbrojtëse Rrugore - Pjesa 1: Terminologjia dhe kriteret e përgjithshme për metodat e testimit";
 - UNI EN 1317-2:2010: " Sistemet Mbrojtëse Rrugore - Pjesa 2: Klasifikimi , kriteret e pranimit te testit të impaktit dhe metodat e testit për barrierat e sigurisë përfshirë parapetin e automjeteve";
 - UNI EN 1317-3:2010: " Sistemet Mbrojtëse Rrugore - Pjesa 3: Klasifikimi , kriteret e pranimit te testit të impaktit dhe metodat e testit për jastëkët e ajrit ";
 - UNI ENV 1317-4:2003 "Barrierat e Sigurisë Rrugore - Klasifikimi , kriteret e pranimit te testit të impaktit dhe metodat e testit për pjesët transitorë dhe fundore të barrierave të sigurisë";
 - UNI EN 1317-5:2012 "Sistemet Mbrojtëse Rrugore - Pjesa 5: Specifikimet e produktit dhe vlerësimi I konformitetit për sistemet elektronike të automjeteve".
- A10. DM 28.06.2011 (Fletorja Zyrtare,nr.233, datë 06.10.2011) "Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve mbrojtëse të rrugës".

EN 1317 është një Norme Europiane e hartuar në 1998 që përcakton procedurat e certifikimit dhe testimit të zakonshëm për sistemet kufizuese rrugore (barrierat e sigurisë). Përdorimi i markimit CE që vjen nga pjesa 5 e saj është detyrueshëm për çdo vend të BE nga Janari 2011.

Është e rëndësishme të theksohet se EN 1317 nuk përcakton cilat barrierat duhen përdorur në një situatë ose në një tjetër, por ajo përcakton se cilit test duhet të nënshtrohet një produkt për të qenë në një nivel të caktuar performancë dhe cilat janë nivelet e sigurisë (ASI, THIV, etc..) dhe ato të performancës (bazuar në parametra të ndryshëm).

EN 1317 përcakton nivelet e performancës. Çdo përdorues duhet të vlerësojë, çdo herë, se cilat karakteristika i nevojiten atij për të zgjedhur një barrierë sigurie.

Keto karakteristika përcaktohen nga rezultatet e testeve të përshkruara në këto norme dhe ato përfaqësojnë:

- Nivelin e performancës së produktit (tipi i automjetit të testuar & sipas cilave kushteve)
- "Niveli i sigurisë" i produktit ndaj përplasjes (nepërmjet indekseve bio-mekanike është e mundur të vlerësohet probabiliteti i lendimeve si rezultat i përplasjes me produktin).
- Hapesira e nevojshme për operimin pa probleme të tij (sa hapësirë merr ai gjatë përplasjes, madhësia e deformimit pas përplasjes).

Per cdo suate, pergjithesisht preferohet te perdoret nje sistem, gjeresia punuese e te cilit eshte me e vogel se hapësira ne dispozicion (per shembull ne ane te nje shkambi), ndersa ne te njejten kohe te garantoje karakteristikat e duhura te sigurise. Ne te njejten menyre, niveli i kontrollit u zgjodh ne varesi te tipit te automjetit qe qarkullon ne nje rruge te caktuar dhe sipas rrezeqeve aktuale (per shembull, renie nga ura, hyrja ne trotuaret e kembesoreve ose prekja e integritetit te ndertesave).

9.3 Tipet e Pajisjeve të Sigurisë

Barrierat anësore të rrugës përdoren për të mbrojtur trafikun nga pengesat ose rreziqet, të tilla si pjerrësi e tillë e skarpatës e cila mund të shkaktojë përmbysjen e automjetit, objekte të palëvizshme si këmbë te urave, dhe sipërfaqet ujore. Barrierat anësore mund të vendosen edhe në pjesën e mesit për të shmangur përplasje me pasoja të rrezikshme me objektet e mesit.

Barrierat trafikndarëse përdoren për të shmangur kalimin e automjeteve nga njëra karrexhatë në tjetrën dhe goditur makinat që vijnë nga drejtimi tjetër. Ndryshe nga barrierat anësore këto lloj barrierash duhet të projektohen për goditje nga të dy anët.

Barrierat e sigurisë në ura projektohen për të shmangur përplasjen e mjeteve me parrakët anësorë të urës dhe rënien e tyre nga lartësia në lumë, rrugë apo hekurudhë e cila kalon poshtë urës. Zakonisht ky tip barriere është më i lartë se barrierat e tjera, me qëllim shmangien e përmbysjes dhe kalimit të autobusëve, kamionëve, kalimtarëve dhe çiklistëve mbi zonat anësore të urës. Keto lloj barrierash përbëhen zakonisht prej disa barrierash tubo çeliku ose parapeti b/arme dhe barriera.

9.4 Niveli i kontrollit

Niveli i kontrollit tregon nivelin e kontrollit te sistemit. Cdo nivel kontrolli percaktohet nga testet e perplasjes qe barriera e sigurise duhet te perballoje. Cdo barriere e re sigurie duhet te testohet te pakten dy here, nje here me nje automjet te lehte me qellim zbulimin e forces se perplasjes mbi nje makine te madhesise se vogel dhe heren e dyte me nje automjet me te rende me qellim percaktimin e energjise maksimale te perplasjes qe sistemi mund te perballoje. Nivelet e kontrollit klasifikohen sipas rritjes se energjise nga perplasia me automjetin me te rende te testuar.

Nga rezultatet e ketyre testeve te perplasjes, llogariten te gjithë parametrat qe percaktojne performancen e sistemit. Sistemi i nje barriere sigurie per te kaluar testin e perplasjes duhet te plotesoje nje sere kerkesash:

- Barriera e sigurise do te mbaje dhe ridrejtoje mjetin pa thyerjen complete te elementeve kryesore gjatesore te sistemit te barrieres se sigurise.
- Elementet e barrieres se sigurise nuk do te penetrojne ne kabinen e pasagjerit te mjetit.
- Deformimet ose nderfutjet ne kabinen e pasagjerit qe mund te shkaktojne deme serioze nuk lejohen.
- Qendra e gravitetit e automjetit nuk do te kaperceje vijen qendrore te sistemit te deformuar.
- Automjeti nuk duhet te rrotullohet (perfshire rrotullimin anesor te automjetit) gjate ose pas perplasjes, edhe pse reniet rrotulluese & shmangiet nga kursi pranohen.
- Per testet me automjete te renda mallrash, jo me shume se 5% e ballastit duhet te shkeputet ose te ndahet gjate testit, derisa automjeti te ndaloje.
- Pas perplasjes ne barrieren e sigurise/parapet, automjeti kur te kerceje mbrapsht nuk lejohet te kaperceje vijen paralele me pamjen fillestare te trafikut

Containment Class	EN 1317 Containment Level
NORMAL	N1
	N2
HIGH	H1
	H2
	H3
VERY HIGH	H4a
	H4b

Tabele 35 – Klasifikimi i kontrollit sipas EN 1317

9.5 Gjeresia aktive dhe shmangia dinamike

Gjeresia aktive eshte matje e deformimit te barrieres nga perplasja. Zakonisht konsiderohet si parametri kryesor per te llogaritur hapësirën e nevojshme prapa barrieres me qellim qe sistemi te funksionojë sic duhet. Llogaritet si distanca maksimale midis faqes se barrieres nga trafikut dhe deformimit maksimal te komponenteve te saj kryesore gjate perplasjes se automjetit me te rende. Gjeresia aktive ndahet ne 8 klasa nga W1 deri te W8 sipas rritjes se deformimit te sistemit.

Livelli di larghezza operativa (W)	Livelli di larghezza operativa [m]
W1	$W \leq 0,6$
W2	$W \leq 0,8$
W3	$W \leq 1,0$
W4	$W \leq 1,3$
W5	$W \leq 1,7$
W6	$W \leq 2,1$
W7	$W \leq 2,5$
W8	$W \leq 3,5$

Tabele 36 – Klasat aktive dhe vlerat ekuivalente ne metra

Shmangia Dinamike eshte parametri i dyte per te vleresuar deformimin e sistemit te barrieres se sigurise ndaj perplasjes dhe llogaritet si distanca ndermjet pamjes se sistemit nga trafiku dhe gjendjes se tij fillestare dhe zhvendosjes se tij maksimale. Shmangia dinamike matet ne metra.

TYPICAL ROAD SAFETY BARRIER INSTALLATION




Figure 59 – Shmangiet e barrierave te sigurise dhe gjeresia aktive

Zonat e pastra, qe referohen gjithashtu si zona rigjenerimi, jane te kalueshme, zona pa pengesa ne ane te rruges pertej anes se rruges ku udhetohe, e disponueshme per tu perdorur ne menyre te sigurte nga automjetet e shkujdesura. Kjo zone mund te jete nje bankine, nje skarpate e riparueshme, nje skarpate e riparueshme, dhe/ose nje zone e paster dalese. Ajo duhet te jete e lire dhe e paster nga objektet e rrezikshme ose fikse. Gjeresia varet nga volumet e trafikut dhe shpejtesite dhe nga gjeometria e anes se rruges. Nese zonat e pastra nuk mund te garantohen, projektuesi duhet te garantoje barriera anesore per tu mbrojtur nga rreziqet. Zonat e pastra normalisht nuk perdoren ne mjediset e shpejtesive te uleta qe gjenden gjeresisht ne zonat urbane dhe suburbane.

Pengesat e lokalizuara brenda zones se paster duhet te hiqen, zhvendosen, riprojektuar ose te mbrohen me barriera trafiku ose jasteke kunder perplasjeve. Nese shenjat, ndricimi dhe/ose sinjalet e trafikut kerkohen brenda zones se rigjenerimit, duhet te sigurohen poste te shkeputura ose mjete sigurie.

9.6 Nderfutja e automjetit

Nderfutja (V_{lm}) e automjeteve te renda te mallrave (HGV) eshte maksimumi i pozicionit te tij dinamic lateral nga ana e padeformuar e barrieres se trafikut. Ai vleresohet nga fotografimi ose video regjistrimi i shpejtesise se larte, duke konsideruar qe nje ngarkese formale te kete gjeresine dhe gjatesine e platformes se automjetit dhe nje lartesi totale prej 4m. V_{lm} vleresohet duke matur pozicionin dhe kendin e platformes se automjetit dhe duke supozuar qe ngarkesa imagjinare te qendroje e padeformuar dhe drejtkendore me platformen e automjetit ose duke perdorur testimin e automjetit me ngarkese imagjinare




Figure 60 – Nderfutja e automjetit

9.7 Kriteret e përzgjedhjes se pajisjeve te sigurisë rrugore

Përgjatë gjurmës së rrugës është studiuar instalimi I pajisjeve mbrojtëse në përputhje me "Instruksionet teknike për projektimin, miratimin dhe përdorimin e barrierave të sigurisë dhe specifikimeve teknike për testet për Tipin e aprovuar" (DM nr. 223, të datës 18.02.1992 me shtesat dhe amendimet përkatëse)

Me qëllim identifikimin e mënyrës së testeve të impaktit dhe klasifikimit të barrierave të sigurisë dhe pajisjeve të tjera mbrojtëse, do të referohemi ekskluzivisht referencës UNI EN 1317, pjesëve 1, 2, 3 dhe 4.

Për përzgjedhjen e barrierave të sigurisë do të kihet në konsideratë destinacioni dhe pozicioni I tyre, në llojin e kondicioneve rrugore, si trafiku prej të cilit do të afektohen.

Parashikimi i trafikut do të karakterizohet bazuar në volumin dhe llojin e trafikut, të ndarë si më poshtë vijon:

Type of traffic	AADT	% Hevy vehicles (>3.5t)
I	≤ 1.000	All the percentages
I	> 1.000	≤ 5
II	> 1.000	≤ 5 - ≤ 15
III	> 1.000	> 15

Ku: AADT është Trafiku Ditor Mesatar Vjetor në të dy karrexhatat.

Në Projektin tonë të dhënat e parashikimit të trafikut janë shënuar në tabelën e mëposhtme:

Segment	Year 2040 Project															
	Light vehicles	Buses	LGV	HGV	Total	% of Buses and trucks	Light vehicles	Buses	LGV	HGV	Light vehicles	Buses	LGV	HGV		
1	91,621	2,304	2,787	5,542	102,254	8%	91,621	2,304	2,787	5,542	1,154.65	29.03	35.13	69.84		79
2	90,155	1,919	2,669	4,717	99,460	7%	180,310	3,839	5,337	9,433	2,172.11	46.24	64.30	113.64		83
3	64,052	1,741	1,497	4,425	71,716	9%	192,156	5,224	4,492	13,276	2,155.11	58.59	50.38	148.89		89
Total	245,828	5,964	6,953	14,683	273,429	8%	464,088	11,367	12,616	28,250	5,482	134	150	332		85

HGV: makina të rënda >3.5 t

Në përputhje me sa më lartë përcaktimi i klasës minimalë të barrierave të cilat do të vendosen në Projekt është parashikuar në përputhje me Standardet e reja të Projektimit "Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve", VKM nr. 628, datë 15.07.2015, referuar kategorisë së rrugës, klasës së trafikut dhe destinacionit të mbrojtjes. Në veçanti, infrastruktura në studim është një Autostradë në një kontekst urban e klasit A, me trafik klasa tipi II, dhe si skenar trafiku I projektuar është llogaritur si trafik I pritshëm I mjeteve të rënda 5% për Segmentin 1 dhe 2 dhe 6% për Segmentin 3, me me TGM në të dy drejtimet shumë më të lartë se 1000 mjete në ditë.

Fusha e zbatimit të standardeve që kanë të bëjnë me projektimin, miratimin dhe përdorimin e pajisjeve mbrojtëse në ndërtimin e rrugëve, projektet e zbatimit në lidhje me rrugët urbane dhe extraurbane të cilat kanë një shpejtësi më të madhe ose të barabartë me 70 km / orë.

Identifikimi i klasave minimale të pajisjeve që do të zbatohen, do të jetë sipas tabelës së mëposhtme:

Type of Road	Type of traffic	Median Safety Barriers	Roadside Safety Barriers	Bridge Safety Barriers (*1)
Highways (A) and major Suburban Roads (B)	I	H2	H1	H2
	II	H3	H2	H3
	III	H3-H4 (*2)	H2-H3 (*2)	H3-H4 (*2)
Rural Secondary Roads (C) and Urban Roads (D)	I	H1	N2	H2
	II	H2	H1	H2
	III	H2	H2	H3
Urban district Roads (E) and Local Roads (F)	I	N2	N1	H2
	II	H1	N2	H2
	III	H1	H1	H2

Table 37 - Identifikimi I Klasës minimale të Barrierave të Sigurisë

(*1) : Për Ura ose Viadukte janë konsideruar struktura me gjatësi trau $L > 10m$. Për gjatësi më të vogla do të përdoren barriera sigurie si në rrugë.

(*2) : Zgjidhjen midis dy klasave do ta bëjë projektuesi.

Mbrojtja do të mbulojë së paku:


- Skajet e të gjitha ndërtimeve të tilla si ura , viadukte , urave, mbikalimeve dhe muret e rrugë e mbajtur , pavarësisht nga shtrirjen e tyre gjatësore dhe lartësia nga niveli i tokës .
- Zonën e mesit

“barriera qendrore është një sistem gjatesor i përdorur për të parandaluar një automjet të hallakatur të kapërcejë korsinë e një autostrade me ndaresë, në krahun tjetër të levizjes”

Në shumë aspekte, barrierat mesore janë të ngjashme me barrierat anësore të rrugës, përveçse ato duhen projektuar për të përballuar impaktet nga të dy drejtimet e levizjes.

Gjatë 10 viteve të fundit, makinat e pasagjereve janë bërë me të vogla dhe përqindja e makinave me të vogla në trafik është rritur në mënyrë drastike, ndërsa kamionet janë bërë me të rënda dhe me të gjata. Barrierat mesore të tanishme të përdorura në rrugët nacionale mund të jenë të papërshtatshme dhe se ky fakt mund të çojë në lëndime dhe fatalitete të një shkalle me të rënda.

Kufiri anësor i rrugës, ku diferenca ndërmjet bankines dhe nivelit të tokës është $\geq 1,00m$. mbrojtja nevojitet për të gjitha skarpatat me pjerrësi me të madhe ose të barabartë me $2/3$. Në rastet kur pjerrësia është më pak se $2/3$, nevoja për mbrojtje varet nga kombinimi i pjerrësisë dhe lartësisë së skarpates, duke marrë parasysh situatat e rrezikut të mundshëm për zonën poshtë në krah të rrugës (prezenca e ndërtesave, rrugëve, hekurudhave, materialeve të rrezikshme ose depozitimeve të ngjashme...). Sipas Standarteve të reja Shqiptare, ky kombinim ndërmjet pjerrësisë së mbushjes dhe lartësisë së saj rregullohet nga grafiku i mëposhtëm



Funksionet e barrierave mesore

- ✓ Barrierat mesore mund te jene te dobishme dhe me kosto efektive ne eleminimin ose reduktimin e aksidenteve rrugore, sidomos perplasjeve koke me koke. Nder vite, jane projektuar, testuar, vleresuar dhe implementuar nje sere tipesh te barrierave mesore.
 - ✓ Ato duhet te parandalojne nje mjet qe ka dale jashte kontrollit nga kapercimi i rripit te mesit te nje autostrade me ndarese.
 - ✓ Ato duhet te ridrejtojne mjetin qe ka dale jashte kontrollit, duke mos lejuar qe mjeti te penetroje, te kaperceje ose te perplaset dhe pa krijuar rrezik per pjesen tjeter te trafikut.
 - ✓ Ato duhet te permbushin sa me siper, me nivele te pranueshme te forces se impaktit ndaj udhetareve te mjetit ne menyre qe te parandalohet lendimi serioz.
- **Pengesat** (para dhe pas) që mund të jenë një rrezik për përdoruesit e rrugës në rast të goditje. Per shembull, mbrojtja ndaj shenjave vertikale ose pengesave te tjera te lehta nuk kerkon ndryshim ne klasifikimin barrierave te sigurise, sepse pas perplasjes ato nuk perfaqesojne rrezik per perdoruesit. Eshte ndryshe rasti i paneleve sinjalizuese vertikale qe duhet te vendosen ne nje distance:
- Me shume se 1,5m nga ana e karrexhiates ne autostrade dhe 2,10m ne kryqezimet ne disnivel per panelet me mesazhe te ndryshueshme;
 - Me shume se 2,1m nga barriera e sigurise ne rastin e panelit sinjalizues vertikal, me mbrojtje te pershtatshme.

Gjithashtu per shtyllat e ndricimit kerkohet nje distance minimale prej 2,1m dhe instalimi i nje barrieri anesore H2. Ne rastin e shpatullave te viaduktit, distanca minimale eshte dhe nevojitet nje barriere anesore H3.

Kushtet e përcaktuar më lart janë konsideruar si kushtet minimale te lejuara nga standardi. Aty ku Projektuesi e gjykon te arsyeshme do të vendosen pajisje të një klase më të lartë.

Sidoqoftë kriteri i përzgjedhjes është rreziku aktual i ndodhjes së fenomeneve të mësipërme, duke qenë se goditja është gjithmonë një fenomen traumatik dhe për ta shmangur, nëse nuk është e nevojshme, nuk duhet te shtohen elementë të tjerë të rrezikshme.

Adoptimi i një klase më të lartë se minimumi I kërkuar nga Standardi, duhet të justifikohet në mënyrë të përshtatshme nga Projektuesi, bazuar në kushtet aktuale. Rritja e klasës së pajisjeve duhet të marr në konsideratë dhe nivelin e ashpërsisë së goditjes mbi drejtuesit e automjeteve të lehta, gjithashtu duke patur parasysh se jo detyrimisht rritja e klasës së pajisjeve do të garantojë një siguri shumë më të madhe.

Më poshtë do të pasqyrojmë një përmbledhje të pajisjeve mbrojtëse të cilat do të instalohen në pozicione të ndryshme: Zona e mesit (midis dy karrexhatave), pjesë anësore të strukturave.

Tipi i barrierave për tu instaluar në pjesët anësore të strukturave do të jetë një barriere metalike me tre rradhe trarësh metalike, e vazhduar me një barriere lidhëse me tipet e tjera të barrierave. Pajisjet duhet të kenë një nivel ashpërsie të klasit A.

Urat dhe barrierat e mesit preferohen të jenë te një nivel ashpërsie të klasit A. Ato do të adaptohen në barriera të një niveli ashpërsie të klasit B në rastet kur pajisjet nuk janë të disponueshme dhe klasa e materialit dhe karakteristikat e deformimit nuk përshtaten me gjerësinë e bordurave (psh distanca nga objektet fikse) në klasin A.

Referuar kategorisë së infrastrukturës së projektit, tipit dhe klasës së barrierës së përshkruar për pozicione të ndryshme, në zonën e mesit, zonat anësore të rrugës dhe në struktura, janë si më poshtë:

Për barrierat e mesit të cilat do të instalohen në Autostradë:

Barriera mesore prej betoni te klasit H3

Barrierat New Jersey eshte tipi i barrieres me te njohur. Muri i barrierave Jersey fillimisht u perdor per ndarjen e disa korsive ne nje autostrade dhe synonte te minimizonte demet dhe reduktonte mundesine e kapercimit te mjetit ne korsine tjeter ne rast perplasjeje.

Per goditjet anesore me te zakonshme, barriera Jersey ka per qellim te minimizojë demtimin e fletes metalike duke lejuar gomat e mjetit te ngrihet ne faqen e poshtme te pjerret. Per kende me te medha impakti, barriera Jersey eshte aktualisht barriere shume-shkalleshe. Parakopli perplaset me faqen e pjerret te siperme (te barrieres) dhe pastaj rreshqet lart. Ky nderveprim fillon ngritjen e automjetit. Nese parakopli eshte relativisht i dobët atehere pjesa perpara fillon te shtypet para se te filloje ngritja e automjetit.

Me pas, ndersa mjeti afrohet me teper paralel me barrieren, rrota prek faqen e poshtme te pjerret. Ngritja shtese e mjetit shkaktohet me shume nga shtypja e faqes se poshtme te pjerret me suspensionin ballor. Sidoqofte forcat anesore ne rrota japin nje ngritje sidomos nese faqja e barrieres eshte e ashper.

Per kete arsye, duhet te shmangen siperfaqe me zhavorr te ekspozuar dhe finitura te tjera te ashpra. Automjetet moderne kane distance relativisht te shkurter midis parakoplit dhe rrotes; si rezultat i kesaj kontakti me parakoplin ndiqet pothuajse menjehere nga kontakti me rroten. Mjafton qe vetem e ngrihet mjaftueshem automjati qe te reduktohet ferkimi i gomave me siperfaqen e asfaltuar. Kjo ndihmon ae automjeti te futet ne bankine dhe te ridrejtohet. Ne rast se automjeti eshte ngritur shume lart ne ajer, ai mund te lekundet ose rrotullohet, gje e cila shkakton qe automjeti te rrotullohet ne momentin qe rrotat bien ne kontakt perseri me token.

Preferohet qe barrierat e sigurise prej betoni te jene ngjitur me siperfaqen e shtruar keshtu qe rrotat nuk mund te germojne dheun dhe te bejne qe mjeti te kthehet.

Barriera e murit është vendosur me faqe në drejtim të impaktit të mundshëm të automjetit me një rend të veçantë me tre skarpata të ndryshme. Qëllimi i tyre është të zhvendosin gomën e cila godet barrierën në mënyrë të tillë që automjeti të ngjitet sipas formës së barrierës (duke u ngadalëuar) dhe pastaj kthehet përsëri në rrugë, brenda një kohë që varet nga këndi dhe shpejtësia e goditjes. Nëqse energjia e goditjes është e lartë, barriera pëson gjithashtu një zhvendosje e cila ul energjinë me anë të fërkmit. Zhvendosja e barrierës krijon një lak, pak a shumë të rëndësishëm, në vijën mbrojtëse. Ai i mundëson automjetit për të vazhduar përgjatë rrugës dhe jo të kthehet vertikalisht drej aksit të rrugës, sic ndodh në goditjet elastike, pa lëvizje.



Në të gjithë seksionin e projektit klasi H3 në barrierat e betonit në konfigurimin me dy rradhë (të vendosura në shtresat asfaltike).

- Për pjesët anësore të rrugës barriera metalike me tre valëzime me këmbë të fiksuara të klasit H2 dhe H3.
- Për strukturat si urat, viaduktet, nënkallimet me gjatësi më të madhe se 10 m, barriera metalike me tre radhe, klasi H3-H4.
- Për struktura me gjatësi më të vogël se 10, barriera metalike me tre radhe, klasi H2-H3.

Në lidhje me instalimin e barrierave në zonën e mesit, paisjet mbrojtëse duhet të karakterizohen nga një deformim i tillë që të sigurojë mbajtjen e paisjes gjatë goditjes brenda kufijëve të lejuar. Në lidhje me barrierat anësore, ato duhet të kenë karakteristika deformimi të përshtatshme me pozicionimin dhe funksionalitetin e elementëve të tjerë si barrierat antizhurme, shtyllat e ndricimit dhe sinjalistikën vertikale

9.8 Pjeset kalimtare

Seksionet kalimtare jane te nevojshme per te siguruar vazhdimesi dhe mbrojtje kur:

- Bashkohen dy barriera anesore te ndryshme,
- Nje barriere anesore lidhet me nje ssystem tjetër si parmaku i ures,

- Nje barriere bashkohet me nje objekt te paperkulshem.

Projektimi i pjeses kalimtare duhet te jete i tille qe te siguroje nje kalim gradual ne soliditet dhe sistemin e pergjithshem mbrojtës ne menyre qe te zvogelohet ose shmanget ne cdo pjese pergjate pjese kalimtare humbja ekuilibrit, perplasja apo ngecja ne barriere e automjetit..

Pjeset e kalimit ndermjet barrierave metalike te llojeve dhe kategorive te ndryshme behen me manikota te dhena nga ndertuesi ne menyre qe te sigurohet vazhdimesia ndermjet elementeve gjatesore qe perbejne barrierat e sigurise.

Pikat fundore te barrierave mund te jene te rrezikshme nese nuk projektohen, ndertohen dhe mirembahen sic duhet. Gjithashtu do te instalohen elemente speciale per nderprerjen ndermjet elementeve gjatesore qe perbejne barrierat. Ne vizatimet perkatese jane treguar detaje shtese

9.9 Pjeset fundore te barrierave

Projektimet e meparshme te barrierave te trafikut shpesh nuk i kushtojne vemendje fundeve te barrierave, dhe si rrjedhim barrierat ose perfundonin menjehere pa rakordime, ose nganjehere permbanin ulje te menjehershme te bordurave te barrieres nga ana qe perballej me trafikun. Automjetet qe perplaseshin me keto funde ne nje kend te caktuar mund te ndalonin shume papritur ose seksioni metalik i parmakut mund te hynte ne kabine, duke rezultuar ne demtime serioze ose fatalitete. Per kete arsye ne vitet 1960 u zhvillua nje tip i ri i fundeve te barrierave ku parmaket perkulen me kend 90 grade dhe i cojne fundet e barrieres poshte ne menyre qe te arrije nivelin e tokes. Ndersa ky inovacion parandalonte parmakun te hynte ne kabinen e automjetit, ai mund te shkaktonte ngritjen e automjetit ne ajer ose rrotullimin e tij, per arsye se perkulja e parmakut te barrieres ne toke krijon nje rampe. Keto perplasje shpesh shkaktojne ngritjen dhe flututimin e automjetit me shpejtesi te madhe mbi vete objektet te cilat keto barriera supozohej te mbronin.

Per te zgjidhur problemin e perplasjeve qe perfundonin ne ngritjen ne ajer dhe rrotullimin e automjetit u zhvilluan funde barrierash energji-absorbuese. Gjenerata e pare e pjeseve fundore te barrierave ne vitet ishin funde kabllore te shkeputura, ku hekuri rrotullohej rreth vetes dhe lidhet me nje kabell qe kalon permes shtylles se pare dhe te dyte (qe zakonisht jane shtylla te shkeputura). Gjenerata e dyte, ne vitet 1990 dhe 2000, perbehet nga nje koke hekuri e madhe qe ze kornizen ose parakolpin e automjetit. Pika e perplasjes drejtohet pergjate parmakut te barrieres, duke shperndare energjine kinetike te automjetit nepermjet perkuljes se celikut te seksionit te parmakut. Parmaku gjithashtu mund te perfundoje duke e kurbezuar mbrapsht deri ne ate pike ku do te ishte e pamundur te goditej, ose nese eshte e mundur duke futur fundin e parmakut ne koder apo ne pjerrsi terreni.

Nje alternative per pjeset fundore energji-absorbuese te barrierave jane zbutesit (amortizuesit) e perplasjes. Keto perdoren per aksidente te cilat nuk mund te mbrohen efektivisht nga barriera trafiku me nje ane..

Duke qenë se këto paisje janë të shtrenjta per tu instaluar dhe mirembajtur, duhet studiuar mundesia per te vendosur nese eshte i mundshem eliminimi i tyre ose rreziku potencial i mundshem mund te reduktohet ekonomikisht ne limite te tolerueshme permes masave te sigurise me pak drastike.

SPEED	Class of Crash Attenuators
≥ 130	100
≤ 90 ≥ 130	80
≤ 90	50

Tabele 38 – Identifikimi i klases minimale te amortizatorit te goditjes

Amortizatori i goditjes duhet të testohet sipas EN 1317-3. Këto paisje janë të ndara në ridrejtuese dhe jo-ridrejtuese. Në rastet e goditjeve këndore, përballë ose anash është i preferueshëm përdorimi i amortizatorëve jo-ridrejtues

9.10 Gardhet mbrojtës metalike

Per ura dhe objekte te tjera sensitive kerkohen gardhe metalike mbrojtës dhe kryesisht perdoren per te parandaluar renien nga ura.

Karakteristikat kryesore te gardheve parandaluese te renies ne ure jane: kontruksion kompakt, te qendrushme dhe te forta, kunder ngjitjes mbi gardh dhe tu japin njerezve nje ndjenje sigurie.

Kerkesat e pergjithshme jane permbledhur me poshte:

- Gardhi duhet te instalohet vetem kur cenohet siguria e kalimtareve ne kryqezim ne nivel;
- Gardhi duhet te instalohet ndermjet rruges se automjeteve dhe asaj te kalimtareve;
- Gjatesia e gardhit do te percaktohet sipas rrethanave. Ai do te shtrihet 100 metra ne ane te ures apo nenkalimit, vetem nese rrethanat nuk lejojne dicka te tille atehere mund te aplikohet nje gjatesi me e shkurter;

Vemendje e vecante duhet tu jepet lartesisë dhe vendosjes se gardhit si dhe materialeve qe do te perdoren. Ai nuk duhet te perngoje pamjen e drejtuesve te automjeteve dhe kalimtareve dhe duhet te ndertohet me materiale dhe ne menyre te tille qe te minimizojë potencialin per demtime te kalimtareve dhe pasagjereve ne automjete ne rast te aksidenteve.

10 SINJALISTIKA DHE VIJIZIMET RRUGORE

Projekti i autostrades Tirane-Durres eshte nje nga projektet me te rendesishme per momentin ne Shqiperi. Ai eshte 31 km i gjate me tre korsi dhe nje korsi emergjence per secilen karrexhate. Gjurma intersektohet me akse te tjere rrugore te rendesishem ne Shqiperi, dhe per kete arsye pritet qe trafiku te jete i dendur duke rritur mundesite per aksidente rrugore, te cilat fatkeqesisht shpesh jane fatalel.

Per te shmangur aksidentet dhe per te mundesuar nje drejtim te rehatshem te automjeteve, roli i shenjave dhe vijezimeve te rruges dhe masave te sigurise eshte shume i rendesishem ne kete projekt dhe eshte projektuar ne perputhje me standartin kombetar ARDM dhe gjithashtu me ndihmen e pervesjtes nderkombetare. Projekti i sigurise rrugore duhet te jete ne perputhje me politikat e rregulluara dhe miratuara per sigurine rrugore qe aplikohen ne Shqiperi nga qeveria Shqiptare, te tilla si:

- Strategjia Kombetare per Sigurine Rrugore 2011-2020
- Plan Veprimi per Sigurine Rrugore 20-11-2015
- Strategjia Kombetare e Transportit
- Plani i Rishikuar Kombetar I Transportit 2

Projekti bazohet ne Manualin Shqiptar te Projektimit te Rrugeve, Kapitulli Nr. 6, Shenjat dhe Vijezimet ne rruge. Bazuarne Manualin e Shenjave Rrugore te Republikes se Shqiperise dhe Kodin rrugor Shqiptar, segmenti rrugor Tirane-Durres klasifikohet si Klasa A, dmth si nje autostrade me standarte europiane. Per kete arsye, shenjat horizontale & vertikale se bashku me masat per sigurine rrugore duhet te jene ne perputhje me kete klasifikim. Autostradat e shpejtesise se larte, me shpejtesi te projektimit 140 km/h sic eshte edhe projekti yne, kane nevojte per nje implementim te sakte te rregulloreve te shenjave rrugore me qellim shmangien e aksidenteve rrugore gjate levizjes se mjeteve.

2. Sekuencen e aktiviteteve per tu performuar pergjate cdo Loti dhe nen – Loti..
3. Sistemi I menaxhimit te devijimit te trafikut ne perputhje me ndarjen e Loteve dhe nen-Loteve.
4. Ceshtjet mjedisore te krijuara nga ekzekutimi I punimeve.
5. Numri I kantierëve, dimensionin dhe vendndodhja, perfshire edhe rregullimet e brendshme.
6. Percaktimin brenda zones te te gjithë guroreve, Impianteve te copetimi, Fabrikave te prodhimit te perzierjes se Asfaltit dhe Betonit, duke perfshire numrin, vendndodhjen, kapacitetin prodhues dhe distancen nga Kantieri.

Te gjithë udhezimet e sugjeruara jane subjekt I Standarteve Kombetare dhe Kodeve te aplikuara per Projektimin e Puneve Publike dhe zbatimin e tyre brenda territorit Shqiptar.

Ligji Kombetar I Punes do te aplikohet ne te gjitha ceshtjet qe lidhen me fuqine punetore te perfshire per realizimin e Punimeve..

12.2 Devijimi i Trafikut gjate zbatimit te Punimeve – Kriteret Udhezuese

Duke marre ne konsderate numrin mesatar ditor te mjeteve qe pershkojne te dyja drejtimet pergjate superstrades Tirane – Durres (ndermjet 20.000 dhe 50.000 mjete/dite, ne te dyja drejtimet) menaxhimi I devijimit te trafikut gjate zbatimit te Punimeve do te jene kriteret udhezuese per nje realizim te suksesshem, ekonomik dhe ne kohe te te gjithë Punimeve..

Nje aspekt i rendesishem qe ndihmon ne menaxhimin e devijimit te trafikut eshte intervali i pershtatshem per kryerjen e nderhyrjeve te ndryshme, per shkak te impaktit shume te madh ne realizimin e nje planifikimi te rregullt te fluksit te trafikut.

Nje tjeter aspekt I rendesishem I lidhur me menaxhimin e devijimit te trafikut do te jete edhe mbrojtja e mjedisit nga ngarkesa e tepert me grimca te imta te demshme te motorrit me djegie, e krijuar nga nje sekuence e tejzgjatur e mjeteve qe ecin me shpejtesi te ulet.

Do te merret gjithashtu ne konsiderate shmangia e nje renieje dramatike ne shpejtesine mesatare te mjeteve komerciale, qe ndikojne ne eficensen e sistemit ekonomik me rajonin ne fjale

Normalisht, perdorimi I rrjetit ekzistues paralel te rrugeve nuk mund te akomodoje volumin e pergjithshem te trafikut per tu devijuar gjate punimeve te zgjerimit te Superstrades SH2, Loti 1, vecanerisht duke marre ne konsiderate 15% te trafikut te renduar qe mund te rezultojë vecanerisht I demshem per jeten e struktures se shtresave te rruges ekzistuese.

Per kete arsye, devijimi I trafikut duhet te jete subjekt I nje procesi perzgjedhes ne pikat e devijimit ne perputhje me kategorite e mjeteve, specifikuar si me poshte.

A –Mjetet e lehta (dy akse, vetem makina private) do te devijohen ne rrjetin ekzistues paralel rrugor.

B – Mjetet e renda (minibus, autobus, kamione, konteniere special transporti etj) do te devijohen ne korsite e Superstrades SH2 te cilat perkohesisht nuk jane te perfshira ne zbatimin e punimeve, me nje alternim ndermjet korsive jugore dhe veriore

Sistemi I propozuar do te parandaloje deme te medha ne rrjetin ekzistues lokal rrugor, duke zmadhuar njekohesisht shpejtesine mesatare te trafikut komercial.

Trafiku I gjeneruar nga punimet (kamion, eskavator, autogru, etj.) do te menaxhohet ne perputhje me kriteret e identifikuara ne piken e mesiperme B.

Me qellim, parandalimin e mbingarkimit te rrugeve ekzistuese lokale, gjate sezonit te veres dhe ne data speciale, nje pjese e trafikut te mjeteve te lehta, ne bashkepunim me policine e trafikut, mund te devijohet ne rrugen e rezervuar per trafikun e mjeteve te renda.

Klasifikimi i mjeteve te lehta mund te realizohet lehtesisht nepermjet perdorimit te numrit te targave.

Avantazhet e sistemit te propozuar jane te detajuara me poshte:

- a) Shmangie e konsumit te tokes bujqesore dhe e shpronetimeve
- b) Reduktim drastik I kostove shtese mbi buxhetin e alokuar per qellimin kryesor te Projektit.
- c) Reduktim I kohezgjatjes se pergjithshme te perfundimit te Projektit
- d) Reduktim drastik I nyjeve gjatesore pergjate struktures se shtresave dhe shtresave te asfaltit te Autostrades se zgjeruar SH2
- e) Mirembajtje e nje korridorit te asfaltuar operacional te emergjences
- f) Menaxhim I lehte ne klasifikimin e mjeteve sipas kategorive
- g) Zbutje e konsiderueshme e volumit te trafikut per te menaxhuar seksionet perkohesisht ne dispozicion te Autostrades Sh2
- h) Mundesi per posedim te kantierit nga Kontraktori I Punimeve te segmenteve te zgjatur te Autostrades SH2 per zgjerim
- i) Teknika me te thjeshta per implementimin e alternimit te trafikut pergjate korsive te Autostrades SH2
- j) Mirembajtje e shpejtese mesatare per te dyja klasat e mjeteve
- k) Reduktim I aksidenteve te trafikut
- l) Shmangie e ngarkesave te trafikut e shoqeruar me zbutje te ndotjes mjedisore

12.3 Sistemi i Menaxhimit te Devijimit te Trafikut

Loti do te ndahet ne nen-lote te gjatesive te ndryshme ne perputhje me mundesine e perdorimit te strukturave ekzistuese ose te planifikuara te tilla si nyje ne disnivel, rrethrotullime ose rampa aksesi qe kane per qellim realizimin e operacioneve te devijimit dhe zgjidhjen e kategorive te trafikut.

Parimi udheheqes per sistemin e menaxhimit te devijimit te trafikut do te specifikohet si me poshte:

1. Shmangie e plote e trafikut pergjate korsive ekzistuese te Autostrades, te identifikuara si ane veriore ose jugore, te perfshira ne procesin e zgjerimit. Ky kriter me qellim perzgjedhjen e Kontraktoreve, siguron per zbatimin e Punimeve, lirine maksimale ne organizim dhe shkaterrim, rindertim dhe ndertim te pjeseve te Autostrades Sh2 ne zgjerim

2. Sigurimi (aq sa te jete e mundur) i nje fluksi te qete te trafikut te Superstrades duke e thjeshtezuar ate ne hyrjen dhe daljen mjeteve te vetme per secilin Nen-lot te Punimeve
3. Maksimizimi I perdorimit te rruges ekzistuese alternative
4. Minimizimi I konsumit te rruges alternative ekzistuese
5. Parandalimi I tranzitit te trafikut te mjeteve te renda pergjate rruges alternative ekzistuese, duke pershkruar here pas here zona urbane ose gjysem-urbane.



Figure 86 – Devijimi i Trafikut

12.4 Ceshtjet Mjedisore

Probleme te ndryshme mjedisore do te kijohen nga zbatimi I punimeve per zgjerimin e superstrades SH2.

Problemet me te renda, sipas dimensionit te impaktit, jane listuar si me poshte:

- a) Depozitimi ose/dhe riperdorimi I materialit bituminoz
- b) Depozitimi ose/dhe riperdorimi I strukturave ekzistuese te perforcuara te betonit te pergatitura per shkaterrim
- c) Depozitimi dhe/ose riperdorimi I strukturave metalike (mbikalime kembesoresh)
- d) Ndertimi I rrugeve te devijimit
- e) Ndertimi I kantierëve
- f) Hapje/perdorime te reja te guroveve dhe karrierave
- g) Instalimi dhe perdorimi I impianteve te copetimit
- h) Instalimi dhe perdorimi I impianteve te prodhimit te betonit miks
- i) Instalimi dhe perdorimi I impianteve te prodhimit miks te asfaltit.

12.4.1 Masa te Mundshme Riparuese

a) Depozitimi dhe/ose riperdorimi I materialit bituminoz te hequr;

Ne perputhje me Raportin e Projektimit te Shtresave, nje sasi e konsiderueshme e materialit bituminoz do te mundesohet nga punimet e zgjerimit te Tirane – Durres.

Mbeshtetur ne keto rezultate, riperdorimi i RAP rekomandohet ne shtresen e cimentos se lidhur te autostrades (ne nje perqindje prej 50%) qe siguron zevendesimin me te larte te agregateve te paster. Ne kete menyre, nuk do te perdoret dhe nuk do te zhvendoset e gjithë sasia.

Per te vendosur sasine e tepert, duhet te negociohet dhe bihet dakort me Ministrine e Mjedisit per nje vend te pershtatshem depozitimi, ne nje distance te arsyeshme nga aktiviteti I punimeve, per depozitimin perfundimtar te materialit ndotes

Do te jete me nje rendesi shume te madhe, shmangia e krijimit te zonave te perkohshme te depozitimit qe mund te lihen per periudha te papercaktuara kohore gjate demobilizimit te Kontraktorit te Punimeve.

b) Depozitimi dhe/ose riperdorimi I strukturave ekzistuese prej beton te armuar, te destinuar per shkaterrim;

Meqe strukturat e perforcuara te betonit te pergatitura per shkaterrim jane Mbikalimet, do te merret ne konsiderate kompozimi specifik I strukturave te njejta, si psh:

1. Mbistrukturat e perfaqesuara nga trare te parapergatitur/paratensionuar
2. Nenstrukturat e perfaqesuara nga muret mbajtese, kolonat dhe themelet

Mbistrukturat mund te largohen nepermjet vincave, te transportohen dhe te perdoren si struktura te ngjashme nen ndertim pergjate rrugeve rurale ne te gjithë vendin.

Nenstrukturat mund te shkatërrohen nepermjet nje matrapiku, dhe materiali i thermuar nga nje pajisje e levizshme copetimi, ne nje dimension te pershtatshem per riperdorim te materialit aktivitet i menduar qe ne fazen e projektimit te shtresave, nese teknologjia e riciklimit do te lejoje nje operacion te tille..

c) Depozitimi dhe/ose ri-perdorimi I strukturave ekzistuese metalike

Strukturat metalike ne instaluar pergjate gjurmes se superstrades Sh2 mund te cmontohen lehtesisht dhe sipas nje modifikimi te pershtatshem, do te ri-instalohen ne vendndodhje te njejta/te ndryshme perkohesisht pergjate gjurmes se superstrades Sh2, ose diku tjeter ne brendesi te qyteteve te Tiranes dhe/ose Durresit ne kryqezimet e rendesishme ose ne rruget me trafik te renduar. Prandaj, komponentet e strukturave metalike, te numerizuara dhe identifikuar sipas Specifikimeve Teknike, do te depozitohen ne vendet e instruata nga Klienti.

d) Ndertimi I rrugeve te devijimit;

Ndertimi I rrugeve teresisht te reja te devijimit, sic eshte theksuar edhe ne kapitullin 2 do te perfshije pasojat e meposhtme negative:

- I. Procedura shume te gjata shpronesimi qe do te rezultojne edhe ne nje shtyrje te kohes se perfundimit te projektit
- II. Rritje e kostos se pergjithshme te Projektit
- III. Zhvleresim I vleres se prones bujqesore per feramat e prekura
- IV. Konsum I tokes bujqesore
- V. Interference me sistemin ekzistues te sistemeve drenazhuese dhe ujites
- VI. Perhapje e nje sasie me te madhe pluhuri pertej zones se punimeve per zgjerimin e SH2

Per te parandaluar efektet negative te listuara, do te jete e rekomandueshme perdorimi i rrugeve ekzistuese paralele.

e) Ndertimi I kantierëve;

Ndertimi I kantierëve te Kontraktorit te Punimeve do te perfaqesojne nje konsum te tokes bujqesore me riskun e shtuar te materialeve ndotese ne brendesi te rrjetit te ujerave sipërfaqesore, dherave dhe ajrit




Figure 87 – Kantieri i propozuar

Per kete arsye, kufizimi maksimal I zonave te zena dhe aktiviteteve te perfshira duhet te jete me rendesi te madhe.

Percaktojme kur verifikohen aftesi te pakta prodhimi per pajisjet ekzistuese, ne menyre te detajuar do te dekurajohen:

- I. Instalimi I nje impianti copertimi
- II. Instalimi I nje impiant I per prodhimin miks te betonit
- III. Instalimi I nje impianti per prodhimin miks te asfaltit
- IV. Instalimi i repartit mekanik kryesor
- V. Krijimi I zonave te perkohshme te depozitimit per materialin ndotes te copetuar

Nga ana tjeter do te jete e keshillueshme, qe te promovohet perdorimi I mjeteve ekzistues te licensuara dhe te kontrolluara te disponueshme brenda nje distance te arsyeshme nga vendndodhja e Punimeve ku produkti final do te transportohet ne zonen e aplikimit ose te sherbimeve te siguruar.

f) Hapje/Perdorime te reja te Guroreve dhe Karrierave;

Meqe jane te disponueshme brenda nje distance te arsyeshme nga punimet disa prej impianteve te licensuara dhe te aprovuara te klases se specifikuar me sipër, do te jete e keshillueshme inkurajimi I Kontraktoreve te vlefshem per te blere dhe transportuar mineralin e perzgjedhur dhe te perpunuar te konsideruar te nevojshem per zbatimin e punimeve direkt ne vendndodhjen e punimeve, duke shmangur ne kete menyre aktivitetet e ndermjetme ndotes ne Kantiere.

- a) Instalimi dhe drejtimi i impianteve te thyerjes
- b) Instalimi dhe drejtimi i impianteve te prodhimit miks te betonit
- c) Instalimi dhe drejtimi i impianteve miks te prodhimit te asfaltit

Meqe brenda distancave te arsyeshme nga kantieri i punimeve, disa nga impiantet e specifikuara me siper tashme te aprovuara dhe te licensuara jane te pranishme, do te ishte e keshillueshme qe te inkurajoheshin Kontraktoret qe te blejne dhe transportojne materialin e zgjedhur dhe te perpunuar te konsideruar te nevojshem per ekzekutimin e Punimeve drejtperdrejt ne vendndodhjen e punimeve, duke shmangur aktivitetet ndermjetese ndotese ne Kantiere.

12.5 Vendndodhja e Kantiereve

Duke qene se punimet e ndertimit per zgjerimin e superstrades Sh2 jane ndare ne 3 Lote, eshte studiuar vendndodhja e 3 Kantiereve te ndryshem nga ku mund te operoje Kontraktori I Punimeve dhe jane gjendur mundesite e meposhtme:

- km 5+100 Koordinatat: N41⁰22'00" E. 19⁰42'52"

Zona e Vleresuar: 35.000 m²

E ndodhur ne pjesen veriore te gjurmes se superstrades Sh2 pergjate rruges se Sherbimit ne anen veriore, rreth 700m perpara nyjes ne disnivel te Kasharit.

Kjo vendndodhje lidhet mjaft mire me rrjetin lokal te rrugeve

Verejtje: Perballe vendndodhjes se propozuar gjendet nje ifabrike e prodhimit miks te betonit.

Per ndertimin e kantiereve - u moren ne konsiderate facilitetet e meposhtme:

- a) Hapesire zyre per ekipin e Ekspertit te Supervizorit, perfshire tualetin dhe kuzhinen
- b) Hapesire zyre per stafin e Kontraktorit, perfshire tualetin dhe kuzhinen
- c) Hapesira e laboratorit te kantierit, te ndare ne departamentet e punimeve te dherave, punimeve te betonit dhe punimeve te asfaltit, duke perfshire edhe tualetin
- d) Oficina me hapesire per nje lavazh makinash, si edhe gropa per trajtimin e ujerave nentokesore
- e) Hapesire e magazines se mbuluar
- f) Dhome nderrimi per punetoret, tualete/dushe, mense
- g) Gropa septike nentokesore te ndara per zerat a), b), c) dhe f)
- h) Hapesire e hapur per material te ndryshme te mbetura stok
- i) Hapesira te ndara parkingu per mjetet e lehta dhe te renda
- j) Gardh rrethues
- k) Dy porta hyrese te ndara per mjetet e lehta dhe te renda
- l) Dy pika hyrjeje/daljeje

Per realizimin e zerave a), b), c) dhe f) do te jete e keshillueshme perdorimi I strukturave te levizshme te perkohshme, me qellim mundesimin e demobilizimit te kantierit.

Per te njejten arsye, do te jete e keshillueshme per oficina, lavazhi I makinave, si edhe hapesira e mbuluar per perdorimin e strukturave te perkohshme metalike.

Per me teper, disponueshmeria e nje numri variable te kantiereve, e perbere nga dy konteniere dhe nje numer I pershtatshem I tualeteve kimike te levizshem, do te merret ne konsiderate pergjate Lotit, perkohesisht te ndodhur ne zonat e strukturave te mobilizimit/demobilizimit.

Furnizimi me uje do te sigurohet nga depozite uji, te cilat do te rimbushen periodikisht, ndersa furnizimi me elektricitet do te sigurohet nga nje gjeneator ne rast se nje lidhjeje te perkohshme me rrjetin elektrik ekzistues rezulton I pamundur.

Sic eshte detajuar ne kapitullin 5 – Ceshtjet Mjedisore – paragrafet f), g), h) dhe i) Hapja/perdorimi I guroveve dhe gropave te testimit si instalimi I impiantet e copetimit, fabrikat e prodhimit miks te asfaltit dhe betonit nuk jane marre ne konsiderate ne brendesi te kushteve te disponueshme ne kantieret tipike.

Kater burimet e permendura te ashpersise dhe materialit te perpunuar jane te disponueshem brenda nje distance te arsyeshme nga vendndodhja e punimeve te zgjerimit te Superstrades Sh2, e specifikuar si me poshte:

N.	Location	Type of Plant	Type of Plant	Distance km
1	km 5+100 North side of SH2	Concrete mix production	63 m3/h	<1
2	km 11+300 North side of SH2	Aggregate production	36 m3/h	2
3	km 11+300 North side of SH2	Concrete mix production	100 m3/h	7
4	km 11+300 North side of SH2	Aggregate production	120-140 m3/h	13
5	km 11+300 North side of SH2	Aggregate production	120-140 m3/h	15
6	km 11+300 North side of SH2	Aggregate production	120 m3/h	16
7	km 11+300 North side of SH2	Asphalt mix production	60 t/h	15
8	km 12+800 South side of SH2	Concrete mix production	80 m3/h	<1
9	km 12+800 South side of SH2	Asphalt mix production	60 t/h	<1

Tabele 49 – Lista e Fabrikave te Prodhimit te Materialeve te Ndertimit

12.6 Procesi i Konsultimit me Publikun

Dimensionimi dhe kompleksiteti i punimeve per tu realizuar per zgjerimin e Superstrades Sh2 ne nje korsi te trete do te ndikojte direkt ne shkalle te ndryshme, ne kohe dhe ne jeten ne pergjithesi te nje numri te konsiderueshem perdoruesish dhe rezidentesh pergjate tokave te perfshira, te vleresuar ne rreth 400.000 individe. Nje numer shtese prej 1.500.000 individesh vleresohet te preket indirect pergjate rajonit Tirane – Durres.

Ky fakt do te kerkoje nje pergatitje te pershtatshme te publikut per pengesat e mundshme qe do te ndikojne per nje periudhe specifike kohore te udhetaret, bizneset dhe komuniteti lokal.

Shqetesimet kryesore te pritsme qe do i informohen paraprakisht publikut, jane listuar si me poshte:

1. Pamundesia e perdorimit te lire te Autostrades Sh2 ndermjet Tiranes dhe Durresit
2. Kufizimi I shpejtesise se trafikut pergjate segmenteve dhe nen-segmenteve nen punimet e zgjerimit
3. Limitime dhe kufizime te herepashershme ne rrethrotullimet, kryqezimet, nyjet ne nivel, mbikalimet dhe nenkalimet, e perfshira ne procesin e zgjerimit
4. Limitim I perdorimit te herepashershem te mbikalimeve te strukturave metalike te kembesoreve te perfshira ne procesin e zgjerimit, per shkak te shkaterrimit dhe rindertimit.
5. Devijim I trafikut te mjeteve te lehta ne rrugen ekzistuese paralele
6. Tranzit I trafikut te mjeteve te lehta permes zonave urbane dhe gjysem-urbane pergjate segmenteve te perzjedhura te devijimit
7. Kufizim I tranzitit te mjeteve te renda ne destinacion trafiku me nje kalim pergjate segmenteve nen zgjerim
8. Mundesi e pershtatjes se trafikut te mjeteve te lehta ne nje pike te Superstrades Sh2 me qellim menaxhimin e devijimit te trafikut
9. Proces I zgjeruar I shpronësimeve te pronave dhe aktiviteteteve tregetare qe prekin gjurmen e Superstrades Sh2.

Te gjithë shqetesimet e mesiperme do te informohen paraprakisht paleve te interesuara permes perdorimit te medias se pershtatshme (radio, TV, gazeta, website etj) dhe do te perditesohen cdo dite gjate periudhes se ndertimit nepermjet kijimit te nje buletini te dedikuar te transmetuar ne mengjes dhe mbremje, nepermjet radios dhe televizionit.

Do te jete me rendesi te vecante rritja e ndergjegjesimit te publikut te perfshire ne menyre te perditshme, si edhe me raste nga pikepamja e avantazheve qe do ti sjelle te gjithë komunitetit nje permiresim I Superstrades Sh2 ne nje Superstrate te klasit A1, ne menyre qe te parandalohen pakenaqesite e publikut dhe nderprerje te mundshme te aktivitetit te punimeve.

12.7 Kohezgjatja e Punimeve

Lot 1: Tiranë – Vorë, Faza 1

Programi i propozuar i Punimeve eshte bazuar ne 5 dite pune per jave dhe ne 8 ore pune per dite. Datat qe identifikojne kohezgjatjen e cdo aktiviteti jane thjesht treguese dhe do te rishikohen nga Kontraktori fitues ne perputhje me daten e Urdherit per Fillimin e Punimeve.

Eshte supozuar se procesi i shpronесimit te pronave dhe largimi i mbetjeve do te perfundoje paraprakisht perpara dates se nisjes se punimeve.

Me qellim lehtesimin e problemeve te menaxhimit te trafikut per cdo Lot, sugjerohet te shmangen datat e fillimit te punimeve per periudhen Korrik – Gusht, duke u kufizuar vetem me mobilizimin e Kontraktorit te perzgjedhur te punimeve.

13 VLERESIMI PARAPRAK I NDIKIMIT MJEDISOR

13.1 Te Pergjithshme

Mbrojtja e mjedisit në Shqipëri është sanksionuar me të parin institucion shtetëror për mbrojtjen e mjedisit, me Komitetin për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit, pranë Këshillit të Ministrave.

Në vitin 1992, ky institucion u bashkua me Ministrinë e Shëndetësisë, duke krijuar Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe vitin 1998 u krijua Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe në vitin 2001 Ministrinë e Mjedisit

Në vitin 2005, kjo ministri u fuqizua më tej, duke u shndërruar në Ministri të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MMPAU).

Parimet bazë të politikës për mbrojtjen e mjedisit u sanksionuan për herë të parë në ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit” (1993), të amenduar në vitin 1998 dhe së fundi në vitin 2008. Në vitin 2011 u aprovua Ligji Nr. 10431 "Për mbrojtjen e mjedisit" date 09/06/2011.

Në vitin 1998, u miratua gjithashtu Kushtetuta e re e Republikës së Shqipërisë. Neni 59 i saj thekson se në kuadër të kompetencave kushtetuese dhe mjeteve në dispozicion dhe në mënyrë që të realizojë iniciativën dhe përgjegjësitë private, shteti synon të sigurojë një mjedis ekologjikisht të shëndetshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm si dhe përdorimin racional të pyjeve, ujrave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore në bazë të parimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

MM në bazë të ligjit për mbrojtjen e mjedisit, harton dhe zbaton politikën e qeverisë për mbrojtjen e mjedisit, harton projekt – akte ligjore e nënligjore në funksion të menaxhimit të qëndrueshëm të mjedisit, bashkërendon aktivitetet e institucioneve të linjës për çështje të mjedisit, organizon dhe koordinon punën për monitorimin e mjedisit, përgatit projekt – marrëveshjet ndërkombëtare apo bilaterale për mbrojtjen e mjedisit, përgatit Raportin dyvjeçar “Për Gjendjen e Mjedisit”, shqyrton dhe jep lejet mjedisore për aktivitetet e ndryshme ekonomike, nxit informimin, ndërgjegjësimin dhe tërheqjen e publikut në diskutime të rëndësishme për mjedisin, etj. Një rëndësi e vecantë i kushtohet përafrimit të legjislacionit mjedisor me atë të Bashkimit Europian dhe zbatimit të standardeve mjedisore.

Ky studim merr parasysh të gjitha kërkesat e Akteve Ligjore Mjedisore në Shqipëri.

Studimi për Vleresimin paraprak të Ndikimit në Mjedis ju dorëzua Klientit në 02/08/2016 dhe me pas u zhvillua Konsultimi Publik në 30/08/16, me përfaqësuesit e mëposhtem:

1. Palet e interesuara
2. Përfaqësues të qeverisjes lokale
3. Autoritetet mjedisore
4. Autoritetet përgjegjëse për përdorimin e tokës: -Rregullorja e territorit – Planifikimi Urban
5. Përfaqësues nga OJQ
6. Përfaqësues nga organizatat e biznesit

13.2 Politikat, Kuadri Ligjor dhe Administrativ

13.2.1 Politikat

Gjatë dekadës së fundit qeveria ka filluar zhvillimin e një kuadri ligjor dhe ka ndermarre nisma të ndryshme për të ndryshuar degradimin mjedisor i cili ka ardhur si rezultat i industrializimeve të mëparshme gjatë sundimit komunist, i cili ka anashkaluar mbrojtjen e mjedisit pothuajse plotësisht. Menaxhimi dhe mbrojtja e mjedisit janë pjesë e Kushtetutës i cili kërkon nga Qeveria që: “të mirëmbajë një mjedis të përshtatshëm të shëndetshëm dhe ekologjik për brezat e sotëm dhe të ardhshëm”.

Për më tepër, Legjislacioni kërkon që burimet natyrore duhet të shfrytëzohen racionalisht në përputhje me principe të bazuara. Politikat e përpiluara për mjedisin janë pasqyruar në ligjin No 10431 të vitit 2011. Në Kreu IV “Mbrojtja e Mjedisit në procesin e planifikimit” përcakton politiken e qeverisë për:

- Politika shtetërore mjedisore – përcakton pozicionin e mjedisit në legjislacion, vendin e strategjive të sektoreve kombëtare dhe planet lokale si pjesë e politikës mjedisore dhe përcakton organizmat të cilët do të administrojnë këto politika.
- Strategjite dhe planet mjedisore – përcakton Ministrinë si organin përgjegjës për hartimin periodik të strategjive dhe planeve mjedisore për secilin nga përbërësit e mjedisit.
- Planet vendore të veprimit për mjedisin – kërkojnë nga qeverisja lokale të zhvillojnë vendore përgatitjen e planeve veprimi, vendore, për mjedisin në mënyrë periodike, në përputhje me strategjitë dhe planet e referuara në nenin 21 të këtij ligji. Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, në fillim të çdo viti, raportojnë në këshillin e qarkut për zbatimin e planeve vendore përkatëse për mjedisin, për vitin pararendës.
- Planet e zhvillimit - përfshijnë instrumentet e parashikuara në planifikimin kombëtar, vendor e ndërvendor, dhe planifikimin e integruar dhe kërkojnë nga autoriteti publik përkatës të mbajë parasysh veçanërisht ndjeshmërinë e mjedisit të një zone të caktuar gjatë hartimit dhe miratimit të planeve të zhvillimit.

Qeveria Shqiptare ka publikuar Planin e parë Kombëtar të Veprimit të Mjedisit (PKVM) në vitin 1993, i cili përcakton qëllimet mjedisore që synohen për një plan veprimi për vendin, strukturën e parë mjedisore është ngritur në vitin 1994.

13.2.2 Baza Legjislative

Legjislacioni që drejton mbrojtjen e mjedisit është fuqizuar relativisht me shpejtësi në Shqipëri. Ligji i parë për Mbrojtjen e Mjedisit doli në vitin 1993 dhe u amendua në vitin 1998, 2001 dhe 2008.

Ligji Nr. 10431 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i datës 09/06/2011 u shfuqizua Ligji nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar.

Në Krun III (Mbrojtja e Perberesve të Mjedisit) Neni 25 (Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis) të këtij ligji përcaktohet se:

“Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërkimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.”

Ligji Nr. 10431 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i datës 09/06/2011 përcakton se mbrojtja e mjedisit nga ndotja e dëmtimi përbën përparesi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë. Neni 28 kërkon që veprimtaritë, që shkaktojnë ndotje në mjedis, pajisen me lejen përkatëse të mjedisit, ku përcaktohen, me shkrim, kushtet e nevojshme për të garantuar se veprimtaria/instalimi do të përmbushë kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi.

Për sa i përket Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në Ligjin Nr. 10431 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i datës 09/06/2011 në Nenin 25 thuhet se:

- 1 Vlerësimi i ndikimit në mjedis i një projekti të propozuar zhvillimi është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme, të mundshme, të asaj veprimtarie në mjedis.
- 2 Gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhen identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur i ndikimit në mjedis të një veprimtarie, të referuar në pikën 1 të këtij neni, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre të ndërsjella.
- 3 Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit.
- 4 Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërkimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.

Gjithashtu ne Ligjin Nr. 10431 “ Për Mbrojtjen e Mjedisit” i dates 09/06/2011 Neni 13 thuhet se:

- Çdo person ka të drejtë t’i jepet në kohë informacion për gjendjen e mjedisit, ndotjen e tij dhe masat e marra, në përputhje me këtë ligj, me legjislacionin të cilit ai i referohet, si dhe me ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit në lidhje me dokumentet zyrtare”.
- Gjatë zgjidhjes institucionale të problemeve të mbrojtjes së mjedisit, autoritetet publike përkatëse sigurojnë që publiku dhe palët e interesuara të kenë mundësi reale për të marrë pjesë në procedurat për identifikimin e gjendjes së mjedisit, hartimin dhe miratimin e strategjive, planeve e të programeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe përbërësit e mjedisit, si dhe në hartimin dhe miratimin e rregulloreve e të akteve me karakter të përgjithshëm, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, vendimmarrjen për dhënien e lejeve përkatëse të mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me legjislacionin, të cilit ai i referohet.

Ligji Nr.10 440, datë 7.7. 2011 “PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS” synon që të sigurojë:

- a) një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;
- b) garantimin e një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur, si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.

Ligji mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis kërkon që informacionet e mëposhtme të përfshihen në VNM:

Neni 4

Kërkesat e përgjithshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis të një projekti

1. Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit.
2. Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekurnë kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit.
3. Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përgatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zonës nëgjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj. Vlerësimi përfshin, sipas rastit, sifunksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.
4. Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

13.2.3 Baza Ligjore

Ligj nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”,

Ligji nr.10440 date 07.07.2011 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” si dhe Ligjin Nr 12, date 26.02.2015 “Per disa ndryshime ne ligjin Nr. 10440 date 7 7 2011”.

Ligji nr.10448 date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”.

Ligji nr.8897, date 16.5.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja", amenduar me ligjin Nr.10 266, datë 15.4.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8897, datë 16.5.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja"

Ligji nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”. Në rastet e shpronësimeve për interesa publike nga ana e shtetit, Ministri kompetent (në këtë rast Ministri i MTI) cakton një komision special që të administrojë në menyrë të përshtatshme shpronësimet dhe të vendosë vlerën e pronësive për t’u shpronësuar. Vendimet e shpronësimit nga ana e Ministrisë i paraqiten KM për vendim dhe pronaret e pronave kanë të drejtë të apelojnë, por apelimi nuk duhet të vonojë shpronësimin

Ligji Nr. 9385, date 4.05.2005 “ Per pyjet dhe sherbimin pyjor” amenduar nga ligjet:Ligji nr. 9533, date 15.05.2006 “ Per disa ndryshime ne Ligjin nr. 9385, date 4.05.2005 “ Per pyjet dhe sherbimin pyjor”; Ligj nr.9791, datë 23.7.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar;

Ligji Nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore",

Ligji Nr.9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis",

Ligji Nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit ", amenduar me Ligjin Nr. 37\2013 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 9587, date 20.7.2006 "per Mbrojtjen e biodiversitetit" dhe ligjin Nr. 68/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar,

Ligji Nr. 8906 i dates 06.06.2002, "per Zonat e Mbrojtura" , (i amenduar me Ligjin nr. 9868, date 4.02.2008 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8906, date 6.06.2002 "Per zonat e mbrojtura"),

Ligj Nr. 10463, date 22.09.2011, "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve",

Ligji Nr. 9244 datë 17.06.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore",

Ligji nr.9108, date17.07.2003 "Per substancat dhe preparatet kimike",

Ligji Nr.10119, datë 23.04.2009. "Per planifikimin e territorit",

Ligji Nr.9048, date 7.4.2003 "Per trashegimine kulturore" amenduar me: Ligjin nr.9592, datë 27.07.2006;

Ligjin nr.9882, datë 28.02.2008; Ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009,

Ligji nr.9115, date 24.07.2003 "Per trajtimin mjedisor te ujerave te ndotura".

VKM Nr. 686, date 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (vnm) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".

VKM Nr. 247, datë 30.4.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhepërfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore"

VKM Nr.676 datë 20.12.2002 "Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare

VKM Nr. 177, date 31.03.2005 " Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjedisve ujore pritese,

VKM Nr. 502, date 13.07.2011 "Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit" i ndryshuar me: - VKM Nr.88, datë 07.02.2012 - VKM Nr. 139, datë 22.02.2012 - VKM Nr. 345, datë 09.05.2012 - VKM Nr. 314, datë 13.3.2013 - VKM Nr. 488, date 14.06.2013,

VKM Nr.435, date 12.09.2002 "Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer".

VKM Nr. 103, date 31.03.2002 "Per Monitorimin Mjedisor ne Republiken e Shqiperise:"

Udhëzim Nr.6527 datë 24.12.2004 "Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyrat e kontrollit të tyre"

Udhëzim Nr.8 datë 27.11.2007, i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe Ministrisë së Shëndetësisë "Mbi nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara"

Rregullore Nr.1 datë 15.03.2006 "Për parandalimin e ndikimeve negative në shëndet e në mjedis të veprimtarive ndërtimore"

Urdher Nr.1280 dt.20.11.2013, "Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes se eger".

13.2.4 Kuadri Institucional

Sipas Ligjit Nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”:

- 1 Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucion qendror publik në varësi të ministrit, që ushtron juridiksionin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes zyrës qendrore dhe degëve rajonale në qarqe, të cilave këtu e më poshtë do t’u referohemi si agjencitë rajonale të mjedisit.
- 2 Agjencia Kombëtare e Mjedisit financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burimet e veta.
- 3 Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka pavarësi në vendimmarrjen dhe kryerjen e funksioneve të saj, të parashikuara në këtë ligj.
- 4 Këshilli i Ministrave, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, miraton rregulla të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të agjencive rajonale të mjedisit, ndarjen dhe organizimin e punës, statusin e punonjësve dhe marrëdhëniet e saj me institucione të tjera.
- 5 Kryeministri, me propozimin e ministrit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, miraton strukturën dhe organikën e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të agjencive rajonale të mjedisit.

Gjithashtu sipas Neni 60 të këtij ligji, funksionet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit janë:

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti kompetent për përcaktimin e kushteve për lejet përkatëse të mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me legjislacionin për lejet e mjedisit dhe me dispozitat e ligjeve të tjera përkatëse dhe ka këto funksione:

- a) hartimin e Programit Kombëtar për Monitorimin e Mjedisit dhe monitorimin e gjendjes së mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- b) përgatitjen dhe publikimin e raporteve vjetore për gjendjen e mjedisit;
- c) kryerjen e shërbimeve të matjes së shkarkimeve në mjedis me kërkesë të ministrit;
- ç) këshillimin e organeve vendore për zbatimin e politikave mjedisore;
- d) krijimin dhe menaxhimin e sistemit të informacionit mjedisor;
- dh) krijimin dhe menaxhimin e Regjistrit të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve;
- e) sigurimin e informacionit mjedisor për publikun, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- ë) sigurimin e informacionit për publikun për procesin e vendimmarrjes për çështjet mjedisore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- f) sigurimin e zbatimit të parimit të përgjegjësisë mjedisore për çdo operator, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- g) menaxhimin e sistemit të të dhënave për pyjet.

2. Kjo agjenci kryen edhe funksione të tjera që i ngarkohen me legjislacion të posaçëm.

Si shtese e detyrave të vendosura direkt nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Administrimit të Organizatave të tjera shtetërore kanë një rol të rëndësishëm në monitorimin dhe mbrojtjen e florës dhe të faunës duke përfshirë:

- Institutin e Flores dhe Faunes
- Laboratorin e Akuakultures dhe Peshkimit

Megjithatë mori institutetsh përgjegjëse për monitorimin, aktualisht janë realizuar pak studime në këtë fushë në gjendjen e florës dhe të faunës në Shqipëri, që vjen kryesisht si rezultat i kufizimeve buxhetore.

Institucione të tjera që kanë një rol të rëndësishëm në mjedis janë:

- Ministria e Transportit dhe Infrastrukturas (MTI)
- Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI)
- Ministria e Shëndetësisë (MSH)
- Instituti i Shëndetit Publik – përgjegjës për monitorimin e cilesive të ujërave të pijshme dhe cilesive të ajrit

- Instituti i Energjise, Ujit dhe Mjedisit – grumbullimi it e dhenave meteorologjike dhe pergjegjesia per monitorimin e ujrave dhe cilesine e ajrit.
- Këshilli Kombetar i Territorit (KKT) – përgjegjes për lëshimin e lejeve të ndërtimit me kushte të cilat përfshijnë kërkesa për mbrojtjen e mjedisit.

13.3 Kuadri Kombetar per Ruajtjen e Natyres

Rrjeti i sotem i Zonave te Mbrojtura ne Shqiperi, mbulon nje siperfaqe prej 460, 060.9 hektare e barazvlefshme me 16 % te siperfaqes se pergjithshme te vendit. Sipas Strategjise Kombetare dhe Planit te Veprimit per Biodiversitetin, planifikohet qe deri me 2020, ZM-te te mbulojne 25 % te territorit shqiptar. Per kete qellim jane percaktuar dhe plane te vecanta

Ne nentor te vitit 1999 u botua Strategjia dhe Plani Kombetar i Veprimit per Biodiversitetin (NBSAP). Ky dokument jep kuadrin politik dhe planin e veprimit per biodiversitetin ne Shqiperi. Nje pjese e rendesishme e planit jane propozimet per zhvillimin Rrjetit Kombetar per Zonat e Mbrojtura, rrjet i cili do te sherbeje si baze per rrjetin ekologjik te vendit (shih Harte 1 per rrjetin e sotem dhe te propozuar te ZM-ve).

Ne vitin 2002, Parlamenti Shqiptar aprovoi dy ligje te rendesishem (Ligji Nr. 8934 i dates 05.09.2002 “Per Mbrojtjen e Mjedisit” dhe Ligji Nr. 8906 i dates 06.06.2002, “per Zonat e Mbrojtura” , (i amenduar me Ligjin nr. 9868, date 4.02.2008 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8906, date 6.06.2002 “Per zonat e mbrojtura”) qe se bashku krijuan nje strukture te re ligjore per Zonat e Mbrojtura. Ligji per Zonat e Mbrojtura vendos rregullat per krijimin, administrimin, menaxhimin dhe perdorimin e qendrueshem te ZM-ve dhe te burimeve biologjike dhe natyrore. Ligji jep gjithashtu parimet e zhvillimit te turizmit mjedisor, te perfitimeve te tjera ekonomike si dhe ato te percjelljes se informacionit dhe edukimit ne drejtim te publikut.

Konsulenti investigoi zonen e projektit dhe sic mund te shihet ne harten e meposhtme nuk preket asnje nga zonat e mbrojtura.

13.4 Aplikimi per Leje Mjedisore

Bazuar ne Ligjin Nr 12, date 26.02.2015 “Per disa ndryshime ne ligjin Nr. 10440 date 7 7 2011”:

Neni 3

“Zhvilluesi, për projektet me ndikim në mjedis, që janë subjekt i këtij ligji, paraqet pranë ministrisë, e cila ia përcjell AKM-së, dokumentacionin përkatës për procedurën e VNM-së, përfshirë:”.

Neni 4

“Vendimi i AKM-së për VNM-në paraprake i dërgohet ministrisë, i njoftohet palëve të përfshira në proces dhe publikohet në faqen elektronike të AKM-së dhe ministrisë. Ministria i dërgon zhvilluesit vendimin.”.

Neni 5

“Deklarata mjedisore i njoftohet palëve të përfshira në proces dhe publikohet në faqen elektronike të AKM-së dhe ministrisë. Ministria i dërgon zhvilluesit deklaratën mjedisore.”.

13.5 Të Drejtat e Qytetareve

Ligji nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, përcakton rolin dhe të drejtat e publikut në çështjet mjedisore. Kapitulli VII “Informacioni Mjedisor”

13.6 Trashëgimia Arkeologjike dhe Kulturore, Terreni dhe Peisazhi

13.6.1 Trashëgimia Arkeologjike dhe Kulturore

Monumentet e trashëgimise kulturore janë në një distancë të mjaftueshme nga rruga e propozuar dhe për këtë nuk kërkohet studim i veçantë.

13.6.2 Ndikimet në Trashëgimie Arkeologjike dhe Kulturore

Është e evidente nga studimet se rruga e propozuar nuk do të ketë asnjë impakt të rëndësishëm në terrenet historike kulturore apo arkeologjike për shkak të distancës ndërmjet rrugës së propozuar dhe terrenet me interesit arkeologjik, Monumentet e trashëgimise kulturore janë në një distancë të mjaftueshme nga rruga e propozuar dhe për këtë nuk kërkohen masa të veçanta mbrojtjeje.

13.6.3 Terreni, Peisazhi dhe Trashëgimia Kulturore

Ky seksion merret me mjedisin në kushtet aktuale (linja Baze). Një theks i veçantë duhet t’i jepet faktit që ambjenti ka një njësi të balancuar mirë që ndikohet shumë nga ndryshimet. Mjedisin duket të konsiderohet si tepër dinamik dhe vecanerisht i ndërprerë nga ndërhyrja njerëzore.

13.6.4 Ndikimi në terren dhe peisazh

Terreni dhe impaktet vizuale do të jenë me të dukshme gjatë fazës së ndërtimit dhe në një kohë të shkurtër pas përfundimit kur masat lehtësuese nuk zbatohen ose kanë efekt të limituar. Objektet e trashëgimise kulturore janë mjaft larg rrugës kështu që konteksti vizual i tyre nuk do të ndryshohet shumë nga projekti.

Në përgjithësi efektet negative do të vërehen tek ndërtesat në afërsi të rrugës. Gjithashtu ndërtesat që janë në afërsi të mund të përjetojnë pengesa vizuale

Impakti i përgjithshëm nga afatshkurter deri në afatmesëm në rrugën e propozuar të karakterit të terrenit është konsideruar të jetë në nivel të moderuar.

Impakti afatgjate i rruges ne peisazh gjithashtu konsiderohet te jete ne nivel te ulet meqe rruga eshte integruar ne peisazh nepermjet ngritjes dhe zhvillimit te zbutjes mjedisore.

13.6.5 Masat Lehtesuese per Peisazhin dhe aftesia vizuale

Rendesi i eshte kushtuar faktit qe te kete sa me pak impakte ne pronat private, tiparet topografike, pemet dhe kudo qe eshte pare si e mundur. Megjithate, si me cdo ndertim tjeter disa lloje impaktesh jane te pashmangshme dhe kudo qe ato do shfaqen jane propozuar masa te nevojshme per t'i zbutur ato.

Objektivat e punimeve te peisazhit ne lidhje me zgjerimin e rruges jane si me poshte:

- Te zhvillohet nje peisazh, karakteri i te cilit lidhet me llojet, shkallen dhe llojshmerine e pejsazhit ekzistues;
- Te zhvillohet nje strukture pejsazhi i cili integron fizikisht dhe vizualisht rrugen e propozuar me terrenin perreth.
- Te pakesohet efekti negativ i pengesave vizuale.
- Te mbrohet, ri-behet ose pasurohet pejsazhi ekzistues, i cili preket direkt ose indirekt nga rruga;
- Te lehtesohet krijimi i kushteve per rritjen e sigurise dhe kenaqesise se udhetimit, dhe
- Te rritet ne maksimum numri i pamjeve terheqese gjate udhetimit pa perkeqesuar pamjen nga pronat pergjate rruges.

1.1.1.1 Faza e Ndertimit

Kontratat do te lidhen ne menyre qe te sigurohet nje praktike sa me e mire pune si edhe qe te zvogelohen impaktet negative qe vijne si rezultat i ndertimit ne nivelin me te ulet te mundshem dhe qe sigurojne makinerite qe operojne brenda skemes ne zonen e ndertimit i zbatojne ato.

Zonat e depozitimit do te pozicionohen ne menyre qe te menjanohen impaktet e metejshme ne pronat private e banesat ekzistuese, pemet, gardhimet, dranazhimet etj. dhe si te tilla do te kene prioritet per tu ndertuar.

Natyra e perhershme e impakti do te ndikojte gjithashtu ne pronat e shtepive private perreth vetem ne ato seksione ku kjo prone eshte ne afersi te rruges se propozuar. Megjithate, masat lehtesuese jane marre per te minimizuar ne maksimum impakte te tilla te banoret.

13.7 Burimet Natyrore

13.7.1 Klima

Zona qe perfshin Tirana – Durres eshte pjese e nenzones klimatike mesdhetare te Ultesires Qendrore. Kjo nenzone karakterizohet nga dimra te bute me influence te forte detare dhe vera te nxehta.

Reshjet mesatare vjetore jane 950 – 1,200 mm. numri i diteve me shi me te dendur se 1.0 mm varion nga 85 ne 100 dite. Ne pergjithesi shirat nuk jane te rrembyeshem.

Reshjet e bores jane nje dukuri e rralle dhe nuk mund te flitet per nje shtrese te qendrushme te saj. Lartesia maksimale e bores arrin zakonisht nga 5 deri 10 cm dhe me rralle 15 – 17 cm.

Regjimi i temperaturave duket uniform. Temperatura mesatare vjetore varion nga 15 – 16°C. dimri eshte ne pergjithesi i bute. Keshtu qe temperatura mesatare ne Janar varion nga 6– 7°C. temperatura absolute minimale varion nga -3 to -5°C dhe vetem ne raste te rralla mund te verehen temperatura me te uleta.

Periudha me ngrica është e shkurtër dhe numri i ditëve me ngrica mund të arrijë deri 15-20 ne vit, gjatë të cilave temperatura minimale eshte ose zbret nën zero 0° C

Era fryn përgjithsisht nga dy drejtime. Gjatë stines së ftohtë mbizotëron era nga juglindja dhe veriu, dhe gjate stines se ngrohte mbizotëron era me drejtim nga veriperëndimi. Shpejtesia e eres ne superstraden Tirana–Vora ka vlera mesatare ndersa ne sektorin Sukth –Durres eshte nder me te lartat ne vend.

Studimi i detajuar i klimes bazohet ne datat nga stacionet metereologjike te Tiranes dhe Durresit.

1.1.1.1.1 Rrezatimi diellor dhe diellezimi

Rrezatimi diellor eshte burimi kryesor i energjise qe krijon motin dhe klimen. Transmetimi i energjise drejt Tokes ndodh permes rrezatimit, percueshmerise dhe konveksionit.

Per te dhenat e ketij treguesi, i jemi referuar vetem stacioneve te Tiranes dhe Durresit dhe jane analizuar te dhenat nga Atlasi Klimatik i Republikes se Shqiperise (Tirana 1988). Ne vlerat e treguesit, nje rol te rendesishem luan pozicioni topografik. Kohezgjatja aktuale e diellezimit si mesatare vjetore eshte 2,617 ore. Per Janarin 125 ore, 350 ore ne Korrik. Kohezgjatja relative e diellezimit eshte per Janarin (45%), per Korrikun (80%) dhe vjetorja 60%. (Referuar Atlasit Klimatik te Republikes se Shqiperise 1988 per periudhen 1956 – 1980).

Nga procesimi i te dhenave rezultoi nje vlere totale mesatare e rrezatimit diellor ditor prej 6,781kWh/m² ne Korrik per Tiranen dhe 6, 802 kWh/ m² per Durrësin.

13.7.2 Lehtesimi, Gjeomorfologjia, Gjeologjia dhe dherat

Kushtet e tokes pergjate skemes se propozuar jane bazuar ne studimin ne zyre te informacionit. Dherat dhe gjeologjia e zones jane nje kompozim i shume aspekteve te mjedisit perfshire floren dhe faunen, peisazhin, ujin dhe klimen. Ndikimet ne keto aspekte individuale jane adresuar ne seksionet perkatese te raportit mejdisor.

